ISSN 1857-6443

ZGJEDHJET

Kandidatët i japin "besën" njëri-tjetrit

Fq.4

BUJAR OSMANI

Në pritje të Raportit pozitiv

Fq.3

E shkuara ballkanike jeton

Fq.2

www.koha.mk

Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XIII · Numri 3623 · e hënë, 1 prill 2019 · 3°c | 23°c · 15 DEN

KOHA për sport

Fq.12-15

AKTUALE

Maqedonia e Veriut në flakë

Zjarret në Maqedoninë e Veriut assesi të shuhen. Përderisa shërbimet pranë Drejtorisë për Menaxhim me Kriza (DMK) e lokalizojnë një zjarr, banorët kryesisht ato të viseve malore, denoncojnë për raste të reja të zjarreve. Gjatë vikendit, ekipe të DMK-së dhe Njësive të zjarrfikëseve të Qytetit të Shkupit kanë intervenuar në rajonin e fshatit...

Fq.5

SPECIALE

Kukësi, qyteti më i varfër në Europë

Fq.18

SPECIALE

Evolucioni i udhëheqësve me dorë të fortë

Fq.19

RAJON

Shqipëria, shteti i krimit

Fq.16

MBIPOPULLIMI NË KOMUNËN URBANE SHQIPTARE TË SHKUPIT

ÇAIRI, "STAMBOLLI" I MAQEDONISË SË VERIUT

Çairi aktualisht ka dendësinë më të madhe të popullatës jo vetëm në Maqedoninë e Veriut dhe Ballkan, por edhe në Evropë. Në një kilometër katrorë jetojnë 18.401 banorë. Po të krahasohet me Butelin, Gazi Babën dhe Gjorçe Petrovin, që kanë nga 650 banorë në një kilometër katror, Çairi ka 30 herë më shumë banorë në një kilometër katrorë, apo tre herë më shumë se sa Komuna Qendër që ka 6039 banorë një kilometër katrorë

Fq.8

Bulevardi që po bllokon Tetovën

Tetovë, 31 mars - Qytetarët janë të lodhur me premtimet e vazhdueshme për fillimin e punëve për hapjen e bulevardit "Bllagoja Toska" në Tetovë. Ata shprehen të zhgënjyer me premtimet e njëpasnjëshme ndër vite se ky bulevard shpejtë do të fillojë të ndërtohet.

Sipas banorëve, tashmë në këtë pjesë ka shumë pluhur, ka shumë baltë, krijohet kaos me parkimin e veturave dhe kjo situatë tashmë po përsëritet vite me radhë. "Nuk e kanë ndërmend me e rregullu, çdo ditë kalojmë këtu, ka pluhur, ka makina të parkuara, është vërtetë gjendje e mjerueshme. Apelojmë si banorë të lagjes të ndërtohet ky bulevard dhe të lirohet kjo pjesë e qytetit nga ngufatja", thonë disa banorë të kësaj lagje. Ata janë të revoltuar se pse nuk fillojnë punët dhe stërzgjatet fillimi i një nga projekteve të cilësuara si më...

Fq.9



ANALIZË

E SHKUARA BALLKANIKE JETON

Nga Christian SCHWARZ-SCHILLING

Vendimi përfundimtar i Tribunalit të Hagës për krime lufte e shpalli përfundimisht fajtor udhëheqësin e serbëve Radovan Karaxhiq për krime të njerëzimit në Bosnje-Hercegovinë dhe veçanërisht për gjenocidin në Srebrenicë. Dënimi i tij i gjatë u shndërrua në burgim të përjetshëm. Për krimet veçanërisht të rënda, vrasjen e planifikuar të disa mijëra njerëzve të pafajshëm as nuk mund të mendohej një masë tjetër dënimi. Prandaj është edhe më e çuditshme, që politikanë që mbajnë përgjegjësi sot në Bosnje-Hercegovinë e kritikojnë këtë vendim të Hagës, minimizojnë apo madje mohojnë krimet e luftës apo shkeljet e mëdha të së drejtës së njeriut, që çuan në krimet më të rënda pas Luftës së Dytë Botërore në Europë.

MOHIMI I PËRHERSHËM

Presidenti i sotëm i shtetit të Bosnje-Hercegovinës, Milorad Dodik, përfaqësues i Republikës Srpska dhe përfaqësues i "popullit konstitutues" serb, cili në vitin 2008 tha "ka pasur gjenocid në Srebrenicë", e mohon këtë sot, dhe pretendon, se ai nuk ka ndodhur kurrë. Me këtë gënjeshtër Dodik e ngarkon veten me faj të rëndë. Edhe në Gjermani ka pasur një situatë të njëjtë me ndjekjen e krimeve të Holokaustit në proceset për krime lufte ne Nuremberg: vërtet që autorët u dënuan me vdekje apo me burgime të gjata, por megjithatë ka pasur qytetarë apo politikanë, që e mohonin vrasjen në kampet e përqëndrimit. Si reagim ndaj kësaj, Bundestagu institucioni më i lartë i Republikës Federale miratoi një ligj, që e penalizon mohimin e Holokaustit. Pse nuk bëhet kjo edhe në Bosnje-Hercegovinë? Nëse ka politikanë që e pengojnë me votën e tyre këtë në parlament, atëherë është detyrë e përfaqësuesit të lartë, që vëzhgon procesin e paqes në Bosnje-Hercegvoinë të nxjerrë një ligj që e mbron shtetin ligjor.

ÇETNIKËT NË DRIN

Një tjetër ngjarje këtë muaj të bën sërish të menduar. Në gjysmën e parë të muajit mars pati një shfaqje të pabesueshme të çetnikëve në Vishegradin boshnjak në Drin. Disa qindra çetnikë erdhën të veshur në uniforma të zeza dhe këlthisnin këngët e tyre të vjetra "do të ketë ferr sërish dhe një Drin të përgjakur", këtu po vijnë çetnikët nga malet". Në vitin 1943 pikërisht në këtë rajon, çetnikët filluan krimet e tyre më të rënda bashkë me Wehrmachtin gjerman, nazistët. Kryekomandanti, Drazha Mihailoviq i drejtonte këto banda terrori dhe vrau mijëra vetë. Në vitin 1946 ai u dënua në Beograd nga një gjykatë me vdekje. Ky provokim në mars të vitit 2019 i kushtohej nderimit të tij. E siç shkroi me të drejtë gazeta gjerman, "taz": "50 vite më vonë, në vitin 1993 ngjarjet u përsëritën, ekstremistë serbë mësynë qytetet Foça, Vishegrad dhe vranë mijëra boshnjakë, i çuan gratë në kampe përdhunimi, në një hotel 3 km larg Vishegradit dhe i hodhën burrat e tyre të lidhur në Drin".

3000 vetë gjetën vdekjen. Që të himnizosh këto ngjarje si festime fitoresh, kjo tejkalon përfytyrimin e çdo demokrati. E përfytyroni dot sikur në Gjermani disa qindra të afërm të ish-SS-ve të mblidheshin me uniformat e tyre e të këndonin këngë për Hitlerin dhe të përkujtonin kreun e SS-ve, Heinrich Himmler? E papërfytyrueshme! Siç merret vesh prokuroria boshnjake ka filluar hetimet. Por ato duhet të çojnë shpejt në një rezultat, e të fillohen proceudrat përkatëse gjyqësore. Besoj, se Bosnje-Hercegovina, nëse do ta mbrojë demokracinë e saj, duhet të miratojë shpejt ligjet që mungojnë në parlament. Jo vetëm mohimi i gjenocidit në Srebrenicë duhet të futet si vepër penale, por edhe anëtarësia ose bashkëpunimi i dukshëm me shoqata fashiste. E nëse miratimi i ligjeve të tilla dështon nga vetoja e njërit "popujve konstitutes", atëherë duhet të veprojë Përfaqësuesi i Lartë". Asgjë nuk është më e rëndësishme në Bosnje-Hercegovinë se mbijetesa e demokracisë.

Historiani i madh dhe politologu Karl Popper në librin e tij të shkruar pas Luftës së Dytë Botërore në emigracion. "Shoqëria e hapur dhe armiqtë e saj" nënvizon, se "demokracia është një fushë beteje e paçmuar për çdo reformë të arsyeshme, sepse i lejon reformat pa përdorimin e dhunës. Por nëse ruajtja e demokracisë nuk bëhet si rregulli kryesor i parë i çdo beteje në këtë fushë, atëherë tendencat e fshehura antidemokratike që gjithmonë ekzistojnë, mund të çojnë deri në shkatërrimin e demokracisë. Aty ku mungon vetëdija për parime të tilla, aty duhet të luftohet për zhvillimin e saj: politika e kundërt mund të jetë katastrofike: ajo mund të bëjë që të humbasë lufta më e rëndësishme, lufta për vetë demokracinë. *(DW)*

(Prof. Dr. Christian Schwarz-Schilling ka qenë ministër gjerman për Postën dhe Telekomunikacionin. Në shenjë proteste kundër qëndrimit të qeverisë gjermane në luftën e Bosnjes ai dha dorëheqjen. Nga vitit 2006-2007 ai shërbeu si Përfaqësues i Lartë në Bosnje-Hercegovinë dhe i ngarkuar i BE për Bosnje-Hercegovinën)

MEDIACitate

HISTORIANI SERB: VEÇ ÇKA I KENI PRISHUR MË SHUMË RAPORTET ME KOSOVËN



Profesori i Universitetit të Beogradit dhe themeluesi i organizatës se qendrës politike "Zëri", Nikola Samarxhiq ka vlerësuar se pushteti dhe opozita po shfrytëzojnë 20 vjetorin e intervenimit të NATO-së që të "dërgojnë porosi armiqësore botës perëndimore dhe ftesa Rusisë që për fat, Serbinë as nuk e bombardoi as nuk e mbrojti".
"Nga kërcënojnë me populizëm, klero-nacionalizëm, Rusinë dhe Kinën. Jemi para një humnere prej të cilës, më të mirën prej botëve do na kthejnë tjerët me çmimin që është larg të kuptuarit e tashëm të seriozitetit që elitat dhe shoqëria refuzojnë ta pranojnë ", ka thënë Samarxhiq për "Jutarnj list", të Zagrebit. Në analizën për gjendjen në Serbia k ka theksuar se presidenti i Serbisë Vuçiq, në raport ndaj" me opozitën që mund të llogaris në partneritet me perëndimin", një të tretën "e ka thith, tjetrën e ka blerë" dhe "një të tretën e ka margjinalizua".
"Kështu e radikalizuar dhe sheshelizuar ka mbetur e vetmja opozita. Në Vuçiqin janë nisur mendimtarët e njëjtë politik pa ide dhe oferta për alternative reale, ndërsa personalisht pa talent, karizëm dhe forcë, jo vetë, të na bindin dhe të aktivizojnë edhe bindin edhe të tjerët dhe të bindin vetveten" tha ai. Sipas tij koalicioni anti-Vuçiq, "nuk ka lider të barabartë me ata që patën sukses të lënë vulë me 5 tetor 2000 dhe ndryshimet pozitive që patën ndodhur".
"Nuk ka asnjë që hapur publikisht të thotë se na duhet një Kosovë e pavarur me të cilën do hiqen kufijtë në vend që të gërmojmë. Se me Malin e Zi na ndan masa e dashurisë së ndërsjellë. Se edhe Kroacisë edhe Serbisë i duhet Bosnja e plotë. Se pa Kroacinë as Serbia as Bosnja nuk mund të mbijetojnë. Institucionet e fuqishme financiare, liria evropiane. Infrastruktura e rregulluar. Arsimi funksional", ka thënë Samarxhiq.

Protesta e qytetarëve dhe opozitës në Serbi "gjithnjë më të ashpra edhe masovike ", para së gjithave fal reagimit të Vuçiqit dhe "shërbëtorëve të tij " se me meritën e opozitës dhe shtoi se Serbia "nuk është tepër demokratike, por nuk duron pushtet personal të gjatë të askujt". "Disa protestues kërkojnë nga Vuçiqi më shumë Kosovë, me atë edhe më shumë sheshel, me gjatë edhe më shumë Rusi, më pak Evropë. Evropën se kuptojnë. Dobësitë evropiane nuk i konsiderojnë përparësi demokratike, liri dhe procedura", ka thënë Samarxhiq. Lidhur me raportet në regjionin e Ballkanit, historian beogradas shprehet se presidenti I Serbisë " ashpërsoi raportet me Kosovën, ndërkohë që opozita e akuzon për tradhti", se" ndërpreu (me presidentin e Malit të Zi Milo) Gjukanoviq dhe përsëri filloi copëtimin e Bosnjës, me kulminacioni në tentimet e pasuksesshme të grusht shtetit në Podgoricë dhe Shkup".
"Raportet me Kroacinë vuajnë edhe për shkak të retorikës së tij dhe urrejtjes personale që thekson se është personale. Nga dy anët e kufirit bëhen kolona kilometra të gjata të maunave. Kroacia në Serbi ka investuar thuajse një miliardë euro dhe është dy herë më e pasur se Serbia. Kroacia është stacioni i parë dhe rruga e vetme strategjike drejtë civilizimit evropian", ka thënë Nikola Samarxhiq në tekstin për "Jutarnji list" të Zagrebit.

(Jutarni List, 31 mars)

NËSE NUK E KENI DITUR...

PAS 42 VJETËSH NË BURG, DY BURRA NË FLORIDA LIROHEN SI TË PAFAJSHËM



Clifford Williams Jr ishte 34 vjeçar dhe nipi i tij, Hubert Nathan Myers, ishte 18 vjeç në maj të vitit 1976. Ata ishin në një festë në Jacksonville, Florida, kur dy gra u qëlluan në një apartament aty pranë, njëra prej tyre vdiq. Clifford dhe Hubert u arrestuan shpejt dhe u dënuan me burgim të përjetshëm. Të enjten, shteti i la të lirë. William dhe Myer ndanë një përqafim të gjatë përpara se të bashkoheshin me anëtarët e familjes të mbledhur në sallën e gjyqit. Myers e puthi tokën jashtë. “Jam nervoz sepse ndihem sikur jam ende i mbyllur”, tha ai. Gruaja që i mbijetoi të shtënave i tha policisë së Williams dhe Myers zbrazen armët e tyre nga shtrati ku po flinte me gruan e vrarë. Por dëshmitë treguan se të shtënat erdhën nga jashtë dhe nga arma e njëjtë. Megjithatë, Williams dhe Myers u dënuan për vrasje dhe vrasje në tentativë pas një gjyqi dy-ditor. Avokatët e tyre nuk paraqitën dëshmi. Të dy gjithmonë e kanë mbrojtur pafajësinë e tyre, gjatë gjithë gjyqit, por 42 vitet e ardhshme i kaluan pas hekurave.
Gjërat filluan të ndryshonin kur ata kërkuan njësinë e shqyrtimit të integritetit të dënimit, të cilën avokati i shtetit e krijoi në vitin 2017.

BUJAR OSMANI TAKIM ME GAZETARËT

NË PRITJE TË RAPORTIT POZITIV

"Është dita e fundit para raportit të Komisionit Evropian që do të publikohet pas dy muajve rreth datës 29 maj", tha Osmani

Shkup, 31 mars - Presim ta marrim njërin nga raportet më të mira të Komisionit Evropian nga të tjerat deri tani dhe të marrim rekomandim të pastër kristal, ndërsa vendet-anëtare duhet ta miratojnë. Në kushte kur ideja evropiane çdoherë e më shumë është sulmuar, rrezikuar dhe kontestuar, Republika e Maqedonisë së Veriut ka bërë ringjallje të parimeve të saj bazë, thjeshtë ai është një ishull i Ballkanit i cili e ringjall dhe meriton më shumë se kurrë dhe nga kush do që fillon ky proces. Argumentet e Francës se Evropa duhet të pari të thellohet para se të zgjerohet, ne e sqarojmë me faktin se ne nuk kërkojmë nesër të inkuadrohemi në BE, ne konsiderojmë se derisa Ballkani Perëndimor përgatitet për anëtarësim në BE ka kohë për t'u thelluar. Këtë dje e theksoi zëvendëskryetari i obliguar për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, në takim me gazetarët, ndërsa shtoi se është dita e fundit para raportit të Komisionit Evropian që do të publikohet pas dy muajve rreth datës 29 maj. Por, potencoi duke e marrë parasysh se nesër hyjmë në fushatën parazgjedhore, ndërsa para se të përfundojë ajo do të fillojë fushata zgjedhore për Parlamentin Evropian, deri më 29 maj edhe në vendet-anëtare të BE-së do të kemi një gjendje të jashtëzakonshme në të cilën fokusi do të jetë në zgjedhjet, ndërsa jo në procesin eurointegrues. Sipas tij, ajo nuk do të thotë se në këto dy muaj ne nuk do të vazhdojmë me dinamikë dhe tempo të njëjtë, që të arrihen standardet dhe kriteret që i kemi vendosur.

Ai tha se i mirë është vendimi të mos shpallet raporti në prill, sepse konsiderojnë se me shpalljen e përmbajtjes së tij në atmosferë parazgjedhore mund të shkaktohet presion i madh, duke e marrë parasysh se në disa vende anëtare nuk është shumë i popullarizuar zgjerimi i BE-së, zgjerimi me Ballkanin Perëndimor.

"Nëse raporti hipotetik bëhet më 29 maj, vendimi i Këshillit të ministrave është më 19 qershor, që do të thotë gjithsej 20 ditë, ndërsa të gjithë 28 vendet atë raport të BE-së duhet ta miratojnë dhe ta ndërmarrin qëndrimin politik nëse do ta mbështesin. Presim të marrim njërin nga raportet më të mira nga të tjerat deri tani dhe do të marrim rekomandim të pastër kristal, ndërsa vendet anëtare duhet ta miratojnë. Në vendet tjera anëtare procedura është më e shkurtër përveç në Gjermani dhe Holandë, ku parlamentet e tyre duhet ta sjellin vendimin, ndërsa deri atëherë përfaqësuesit e qeverive në Këshill nuk mund të mbajnë qëndrim. Nëse një vend anëtar nuk ka qëndrim, sepse vendimi është konsensual të gjithë duhet të thonë "po" për fillim të negociatave që të ketë vendim", potencon Osmani.

Theksoi se qëndrimi i tyre është se cilido qoftë anulim i qershorit mund të kuptohet si porosi e keqe këtu brenda, të krijojë zhgënjime të brendshme, t'i dekurajojë vendet e rajonit, ta ndjekin rrugën tonë, megjithatë ta komplikojë situatën. Edhe po të mos ketë vendim në një vend-anëtar për arsye teknike, sqaroi, nuk do të ketë aspak vendim në qershor. Potencoi se së bashku me ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, më 10 prill do të shkojnë në Bundestag, që të sqarojnë se sa e rëndësishme për shtetin është të ketë vendim. "E ringjallëm idenë evropiane se vetëm me bashkëpunim mes fqinjëve do të arrihet paqe e përmbajtur. Ne atë e bëmë me Marrëveshjen me Bullgarinë dhe me Greqinë dhe jemi vendi i vetëm në rajon, i cili nuk ka asnjë çështje të hapur me të gjithë pesë fqinjët. Ne sot mund të kemi seanca ndërqeveritare me cilëndo nga pesë fqinjët tanë dhe në agjendë nuk do të ketë asnjë çështje e cila do të ishte zgjidhje e problemit. Të martën vjen kryeministri grek, Aleksis Cipras pothuajse me tërë Qeverinë e tij dhe mund të thuhet se ajo është seancë ndërqeveritare mes Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe në agjendë nuk ka asnjë çështje të hapur, por ka vetëm nënshkrim të marrëveshjeve. Unë do ta nënshkruajë memorandumin për hapje të vendkalimit të dytë kufitar me Greqinë në Kavadar dhe memorandumin për bashkëpunim në suaza të integrimeve evropiane", theksoi Osmani.

Publicitet

Dy padi për grumbullim të donacioneve të rrejshme

Shkup, 31 mars - Sektori për krim kompjuterik dhe mjekësi ligjore digjitale pranë MPB-së te PTHP-ja kompetente dorëzoi padi penale kundër M.SH. (53) dhe A.SH(49) për shkak të ekzistimit të dyshimit bazë për vepër penale të bërë "mashtrim kompjuterik" sipas nenit 251-b nga K3 të RMV-së.

Siç kumtojnë nga MPB, të paraqiturit me qëllim që të fitojnë interes pronësor kundërligjor kanë formuar Fondacionin "Dopir" dhe kanë krijuar ueb faqe https://bidihumansega.mk/ e cila në mënyrë aktive ka punuar në mbledhjen e mjeteve për ndihmë të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe sëmundjeve të rralla. Nga ana e Sektorit për krim kompjuterik dhe mjekësi ligjore digjitale, është konfirmuar se regjistrues në ueb faqen https://bidihumansega.mk/ është personi M.SH. i cili njëherit është edhe kryetar i Fondacionit.

Në suaza të hetimit të zbatuar, siç citohet në kumtesë, Sektori për krim kompjuterik dhe mjekësi ligjore digjitale ka kryer shumë kontrolle, mes tjerash edhe rreth asaj nëse personat, përkatësisht shfrytëzuesit e ueb faqes për të cilët mblidhen donacionet, evidentojnë në sistemin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe megjithatë është konstatuar pjesa më e madhe e shfrytëzuesve nuk ekzistojnë, përkatësisht janë krijuar profile të rrejshme, fiktive përmes të cilave ueb faqet kanë mbledhur donacione dhe mjete në para. Megjithatë është konfirmuar se përfundimisht me datën 27.03.2019 përmes ueb faqes https://bidihumansega.mk/ janë mbledhur 3.531.199 denarë.

Pas analizave të bëra të llogarive bankare, siç informojnë nga MPB, është konstatuat se nga mjetet e mbledhura, të paraqiturit i kanë tërhequr mjetet në para për nevoja personale.

"Në datën 27 të këtij muaji, ndërsa sipas urdhrit gjyqësor të siguruar paraprak për bastisje, të dhënë nga Gjykata Themelore Shkupi I – Shkup, është bastisur në hapësirat afariste në një banesë në Shkup, me ç'rast janë gjetur një numër i madh i dëshmive të cilat tregojnë se personat M.SH dhe A.SH. me vetëdije kanë kryer futje të të dhënave të pavërteta dhe fotografive nga fëmijët të cilët ishin rast për mbledhje të parave në bazë të donacioneve dhe me atë kanë mashtruar një numër të madh të qytetarëve dhe personave juridik të cilët kanë dhuruar mjete në para", citojnë në kumtesë.

ZGJEDHJET PRESIDENCIALE

KANDIDATËT I JAPIN "BESËN" NJËRI-TJETRIT

Kandidatët për zgjedhjet presidenciale kanë nënshkruar Kodin për zgjedhje korrekte dhe demokratike. Ata thonë se do të bëjnë një garë ndryshe nga garat e deritanishme zgjedhore, me qëllim që të mos pengohet procesi euro-integrues i vendit

Koha — Destan JONUZI

Shkup, 31 mars - Tre kandidatët në garën për president të Maqedonisë së Veriut, Blerim Reka, Stevo Pendarovski dhe Gordana Siljanovska-Davkova, kanë nënshkruar Kodin për zgjedhje korrekte dhe demokratike. Dhënia e "besës" për zgjedhje korrekte dhe demokratike është edhe obligim i cili buron nga neni 8-të i Kodi Zgjedhor. Që tre kandidatët u zotuan se do të respektojnë Kodin e nënshkruar dhe se me veprimet e tyre, do të ndikojnë që në vend të zhvillohen zgjedhje të lira, korrekte dhe demokratike, me qëllim siç thanë ata, "të mos pengohet rrugëtimi euroatlantik i vendit dhe marrja e datës për fillimin e bisedimeve me Bashkimin Evropian (BE)".

Blerim Reka, kandidat i pavarur për president, i cili ka mbështetjen edhe të dy partive opozitare shqiptare - Aleancës për Shqiptarët (ASH) dhe Lëvizjes BESA, shpreson në një garë ndryshe zgjedhore nga garat e mëparshme zgjedhore. "Shpresoj se do të jetë një garë fer, ligjore dhe e rregullt. Fundja, nuk është edhe aq me rëndësi se kush fiton, me rëndësi është që Republika e Maqedonisë së Veriut të fiton dhe të fitojë datën për fillimin e bisedimeve për anëtarësim me BE-në. Shpresoj që ne do të bëjmë një garë pak më ndryshe, ndoshta do të shënojmë edhe një faqe të re në historinë e garave elektorale se si do të duhet të ishte një garë zgjedhore. Kodin do ta respektojmë", deklaroi Reka. Ndërkaq, Gordana Siljanovska-Davkova, kandidate e VMRO-DPMNE-së dhe partive të bllokut opozitar, theksoi se të drejtat etike janë shumë të rëndësishme, ndoshta edhe më të rëndësishme se e drejta dhe vet drejtësia.

"Me respekt për pjesëmarrësit në garën zgjedhore, nuk i llogarisë si armiq. Për ne, gratë, ndoshta është edhe femërore ta respektojmë etikën si parim. Kësaj gare do ti qasem me argumente jo me lojëra bizantine. Qytetarët le ta thonë fjalën e tyre të fundit", deklaroi Siljanovska-Davkova. Nga ana tjetër, kandidati i partive në pushtet LSDM-BDI dhe 30 partive tjera, Stevo Pendarovski, tha se Kodi për zgjedhje korrekte dhe demokratike nuk është vetëm obligim për kandidatët, por edhe partitë të cilat i mbështetin dhe për qytetarët. "Këtë që e nënshkruam edhe praktikisht do ta respektojmë. Ndërsa kjo do të thotë obligim edhe për ato parti politike dhe qytetarë të cilët na mbështesin. Shpresoj në zgjedhje të lira, fer dhe demokratike, që mos ti dëmtojmë proceset eurointegruese të vendit. Edhe fushata zgjedhore dhe dita e votimit le të kalojnë në një atmosferë festive", deklaroi Pendarovski.

Fushata për zgjedhjet presidencial fillon prej sot (e hënë), 1 prill dhe përfundon më 19 prill në mesnatë. Rrethi i parë i votimit për zgjedhjet presidenciale do të mbahet më 21 prill, ndërsa i dyti më 5 maj.

REKA FILLON FUSHATËN NGA SHKUPI

Nga Sheshi "Skënderbeu" në Shkup, kandidati i pavarur për president Blerim Reka do të fillojë fushatën për zgjedhjet presidenciale të 21 prillit. Në fillimin e fushatës së Blerim Rekës, para të pranishmëve do të drejtohen edhe kreu i Aleancës për Shqiptarët (ASH), Ziadin Sela dhe Lëvizjes BESA, Bilall Kasami. Këto dy parti opozitare, menjëherë pas shpalljes së kandidaturës për zgjedhjet presidenciale të z.Reka, dolën në mbështetje të tij.

NËSE NUK KA CENSUS NË RAUNDIN E DYTË, MENJËHERË SHPALLEN ZGJEDHJE TË REJA

Nëse nuk ka dalje në raundin e dytë prej 40 për qind, nuk plotësohet kushti për zgjedhje të suksesshme. Në këtë rast menjëherë shpallen zgjedhje të reja, thotë kryetari i KSHZ-së, Oliver Derkoski. "Nëse nuk ka dalje në raundin e dytë prej 40 për qind, nuk plotësohet kushti për zgjedhje të suksesshme. Në këtë rast menjëherë shpallen zgjedhje të reja, gjegjësisht kryetari i Kuvendit duhet të shpallë zgjedhje të reja. Në këto zgjedhje mund të marrin pjesë edhe kandidatët të cilët tani kanë marrë pjesë nëse mbështeten prej mbështetësve të tyre siç është rasti tani nga një grup votuesish ose të paktën 30 deputetë ose mund të jenë kandidatë të tjerë. Do të thotë nuk ka faktor kufizues në këtë kuptim, megjithatë duhet menjëherë të shpallen dhe të mbahen zgjedhje", thotë Derkoski në intervistën javore të Radios Evropa e Lirë. Në të shton se Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në periudhën e kaluar i ndërmori të gjitha masat organizuese të nevojshme për organizimin dhe zbatimin e këtyre zgjedhjeve presidenciale në shtetin tonë dhe pa dallim nëse ato janë apo nuk janë kusht për marrjen e datë për negociata me BE-në, siç thotë, ne edhe ashtu si organ shtetëror i zbatojmë të gjitha masat e nevojshme që të organizohen zgjedhje të pastra kristal. Në pyetjen nëse është real numri prej 1,8 milionë votues në shtet i cili i ka dy milionë banorë, Derkovski sqaron se Kodi Zgjedhor thotë se qytetari ka të drejtë vote kur t'i mbushë 18 vjeç dhe që ka shtetësi të shtetit tonë.

Mickoski të përgjigjet nëse ka takuar Gruevskin

Shkup, 31 mars - LSDM edhe dje ka pyetur VMRO-DOPMNE-në nëse është kthyer lideri i tyre Hristijan Mickoski nga udhëtimi tranzitor përmes Budapestit dhe të përgjigjet nëse është takuar apo jo me Gruesvkin. "VMRO-DPMNE-ja pranoi se Hristijan Mickoski një ditë para fillimit të fushatës zgjedhore ka qenë në një udhëtim tranzitor përmes Budapestit. Në rast se është kthyer Mickoski duhet të përgjigjet se vallë është takuar apo jo me mentorin e tij, kriminelin e dënuat dhe të ikurin nga drejtësia Nikola Gruevski", thuhet në njoftimin e LSDM-së. Nga partia e Zaevit gjithashtu pyesin nëse para fillimit të fushatës zgjedhore, Mickoski nga Gruevskik ka kërkuar këshilla për kandidaten e tyre për president Gordana Siljanovska, Davkova. "A ka marrë ose jo Mickoski udhëzime për veprim destruktiv", pyesin nga LSDM-ja.

ZJARRET SHKRETOJNË MALET

MAQEDONIA E VERIUT NË FLAKË

Vënien e qëllimshme e zjarreve e vështirëson punën e institucioneve përkatëse për shuarje e tyre. Adnan Xhaferovski, drejtori i DMK-së, thotë se asnjë shtet nuk ka mundësi ti kundërvihet flakëve të zjarrit nëse ato me vetëdije shkaktohen nga faktori njeri. Qeveria ndërkohë ka sjellë vendim për ndalesë për qarkullimi në malet dhe fushat e vendit

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 31 mars - Zjarret në Maqedoninë e Veriut assesi të shuhen. Përderisa shërbimet pranë Drejtorisë për Menaxhim me Kriza (DMK) e lokalizojnë një zjarr, banorët kryesisht ato të viseve malore, denoncojnë për raste të reja të zjarreve. Gjatë vikendit, ekipe të DMK-së dhe Njësive të zjarrfikëseve të Qytetit të Shkupit kanë intervenuar në rajonin e fshatit Lubeten, gjegjësisht rreth vendit të quajtur "Bashinec". Për shkak të terrenit të pakapërcyeshëm është dashur intervenimi i aeroplanëve për shuarje të zjarreve.

Drejtori i DMK-së, Adnan Xhaferovski, për gazetën KOHA thekson se edhe gjatë ditës së diel janë regjistruar vatra të reja të zjarreve, siç është rasti në rajonin e Berovës dhe atë të Tetovës, respektivisht rreth fshatit Zhelinë. "Përkundër lokalizimit dhe mbajtjes nën kontroll të disa vatrave të zjarrit, prezenca e erës ndikon që zjarret të shpërndahen. Ekipet tona janë në vënë në funksion të plotë. Është angazhuar dhe njësia e aeroplanëve. Po japim maksimumin që këto zjarre të shuhen. Ditëve të kaluara, MPB ngriti tetë kallëzime penale kundër personave të dyshuar për vënien e qëllimshme të zjarreve", thotë drejtori Xhaferovski.

I pyetur se nëse DMK disponon me kapacitete të mjaftueshme për shuarjen e zjarreve, drejtori Xhaferovski thekson se asnjë shtet nuk mundet ti qëndroj përballë vatrave të zjarreve nëse ato bëhen qëllimisht. Duke e pasur parasysh këtë situatë, Qeveria së fundmi solli vendim për ndalesë qarkullimi nëpër male dhe fusha. Kohëzgjatja e kësaj ndalese, e cila fillon nga ora 00:00 deri në ora 24:00, siç kanë njoftuar nga Qeveria, do të zgjasë deri në shfuqizimin e saj.

"Mirëpo, kjo ndalesë nuk vlen për të punësuarit në Ndërmarrjen Publike 'Malet kombëtare' dhe subjektet të cilët menaxhojnë me rajonet e mbrojtura nga të gjitha kategoritë (Parqet kombëtare, Park-Malet, malet e specializuar e kështu me radhë). Ndërkohë, nëse personat fizik nuk e respektojnë këtë ndalesë dhe lëvizin nëpër vendet e theksuara, në bazë të nenit 106 nga Ligjit për malet, do të gjobiten nga 1500 deri 2000 euro. Njëkohësisht, të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut njoftohen se ndalesë ka edhe për ndezjen e shkurreve, bërllokut dhe bimëve tjera në male", thuhet në vendimin e Qeverisë.

Përpos zjarreve në male dhe fusha, gjatë kësaj periudhe janë djegur sipërfaqe të konsiderueshme të kallameve në rajonin e Strugës dhe Prespës. Njëherësh, flakët e zjarreve i kanë përfshirë edhe vendet turistike në këtë pjesë të Maqedonisë së Veriut. Ekologjistët vlerësojnë se djegia e kallameve paraqet vdekjeve për botën bimore në rajoni e përmendur. Sipas tyre, kallamet janë filtri më i mirë për pastrimin e ujit dhe shumimin e botës së egër.

Ndryshe, në rajonin e Ohrit dhe Prespës, është konstatuar se jetojnë zogj të rrallë. Nëse llogaritet në nivel kombëtare, siç raportojnë banorët vendas, në atë pjesë jetojnë rreth 66 për qind e zogjve të rrallë. Megjithatë, intervenimi i shpejtë i banorëve lokal dhe njësive të zjarrfikëseve ka ndikuar që kjo pjesë vendit mos të përshihet nga zjarret.

KONTROLLE TË PËRFORCUARA

Qytetarët të kenë kujdes dhe të paraqesin zjarre, Inspektorati me kontrolle të përforcuara Qeveria e Maqedonisë së Veriut më ashpër e dënon djegien e kallamishteve ose zjarrin në hapësirë të hapur që shkaktojnë zjarre, ndërsa njëherësh dërgon apel se institucionet rregullisht i ndjekin të gjitha lokacionet në vend me qëllim që të parandalojnë zjarre të shkaktuara. Në kumtesë potencojnë se personat të cilët do t'i zëmë se si ndezin zjarr në hapësirë të hapur dhe të cilët shkaktojnë zjarre për shkak të djegies së kallamishteve, do të nënshtrohen në sanksione ligjore. Ndërkohë, nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme në vitin 2019, për zjarre të shkaktuara janë dorëzuar tetë padi penale për tetë vepra penale "shkaktim të rrezikut të përgjithshëm" kundër tetë autorëve. Inspektorati shtetëror për bujqësi dhe inspektorati shtetëror për pylltari dhe gjueti kryen kontrolle të përhershme në terren me qëllim të parandalimit të zjarreve të shkaktuara nga djegia e kallamishteve. "Njëkohësisht, i përkujtojmë qytetarët, përderisa vërejnë vende të dyshimta të caktuara në të cilat ka zjarr ose tym menjëherë t'i lajmërojnë shërbimet kompetente në institucionin më të afërt dhe të paraqiten në numrin e telefonit 195, si numër për thirrje urgjente të Qendrës për menaxhim me krizat. I inkurajojnë të gjithë qytetarët të paraqesin persona të cilët djegin kallamishte dhe zjarr në vend të hapur në stacionet më të afërta policore ose në numrin e telefonit 192", thuhet në komunikatën e Qeverisë.

APEL I POLICISË SË TETOVËS

"MOS U JEPNI MOTOÇIKLETA FËMIJËVE"

Motoristët po ashtu rikujtohen edhe për obligimin ligjor që të regjistrojnë motorët e tyre dhe me vete gjithmonë të kenë pajisje mbrojtëse. Sipas policisë, dënimi për mosrespektim të këtyre rregullave sillet prej 300 deri në 500 euro, varësisht nga karakteri i kundërvajtjes

Tetovë, 31 mars - Me përmirësimin e kushteve klimatike, në rrugët e Tetovës, por edhe në rajonin më të gjerë, është shtuar dukshëm frekuentimi i motoristëve sidomos në orët e pasdites dhe gjatë natës. Shumica e motoristëve janë të rinj, të mitur dhe vozisin të ashtuquajtur "skuter", kurse në rrugë nuk mungojnë as motorët më të mëdhenj. Dukuria e daljes me motor në rrugët e Tetovës ka bërë që gjatë vitit të kaluar të ketë shumë aksidente ku kanë qenë të përfshirë motoristët.

Së këndejmi, Policia rrugore në Tetovë, gjatë këtij muaji ka ndërmarrë një sërë aktivitete preventive për zbulimin dhe eliminimin e mangësive në funksion të përmirësimit të sigurisë së përgjithshme në rrugë. "Me përmirësimin e kushteve klimatike, kohëve e fundit numri i motoçiklistëve është shtuar dukshëm dhe ne si stacion për siguri në komunikacionin rrugor, gjithnjë i kemi në konsideratë këta pjesëmarrës. Që nga fillimi i muajit mars, ne i kemi intensifikuar kontrollet në rrugët e Tetovës dhe janë marrë masa ndaj të gjithëve atyre që nuk i respektojnë rregullat dhe ligjet në këtë drejtim. Prandaj, edhe kemi lëshuar një numër të konsiderueshëm të kundërvajtjeve në Gjykatën e Tetovës dhe janë konfiskuar katër motoçikleta për mos pasje të dokumenteve adekuate", deklaroi Besir Qamili, zëvendëskomandant i Stacionit për Siguri në Komunikacionin rrugor në Tetovë.

Sipas policisë, ajo që është dukuri e zakonshme në këtë periudhë sa i përket drejtuesve të motoçiklistëve është se ka gjithnjë vozitës të rinj, prandaj apelojnë që prindërit të kenë më shumë kujdes. "Do të kisha apeluar deri tek prindërit të jenë më aktiv në këtë aspekt, që të mos lejojnë fëmijët e tyre ti drejtojnë këta motoçikleta nëse nuk kanë leje, nuk kanë pajisje të nevojshme, por edhe nëse nume kanë moshën e duhur", apelon Qamili. Gjatë viteve të kaluara, në Tetovë bilanci është tragjik sa i përket aksidenteve me motoçikleta, ndërsa numri sillet nga tre deri katër viktima gjatë një viti ku kanë mbetur viktimë motoristët.

Ndonëse çdo vit ka projekte për preventivë, megjithatë situata në terren është krejtësisht e kundërt, pasi çdo ditë regjistrohen aksidente me motoçikleta në rrugët e Tetovës dhe rrethinës.

Policia, apelon deri tek motoristët që të jenë të kujdesshëm, tërësisht të respektojnë rregullat e komunikacionit, të mos vozisin shpejt, pa leje adekuate dhe nën ndikim të alkoolit. Motoristët po ashtu rikujtohen edhe për obligimin ligjor që të regjistrojnë motorët e tyre dhe me vete gjithmonë të kenë pajisje mbrojtëse. Sipas policisë, dënimi për mosrespektim të këtyre rregullave sillet prej 300 deri në 500 euro, varësisht nga karakteri i kundërvajtjes. *(U.H)*

TRAJTIMI I USHQIMIT TË HEDHUR

LIGJI QË DO T'I BËJ NJERËZIT MË PAK TË URITUR

Qeveria duhet të punojë në drejtim të miratimit të një ligji ku i detyron restorantet apo hotele si dhe lokalet tjera që përgatisin gjella ushqimore apo prodhime të ushqimit, të mos i hedhin në kosha të bërllokut. Nëse vetëm gjysma e ushqimeve nga 10 tonë që hidhen në vit menaxhohen si duhet, atëherë mbi 50 mijë familje do të siguronin më së paku dy vakte ushqime në ditë

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 31 mars - Anëtarët e komisionit të përhershëm anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarëve miratuan konkluzionet e mbledhjes s gjashtë të komisionit të mbajtur me 19 korrik 2018. Pothuajse të gjithë anëtarët dhe deputetë të partive në pozitë dhe opozitë mbështeten iniciativën e Komisionit anketues që së shpejti Qeveria do të miratojë ligj me të cilin ndalohet të hidhet çdo lloj ushqimi i tepër.

"Është më se evidente se janë me sasi alarmante ushqimet që teprojnë pas ngrënies nga ana e klientëve apo firmave të prodhimeve ushqimore që ju skadon afati, hidhen nga pronarët e restoranteve, hoteleve si dhe marketeve. Të dhënat zyrtare statistikore dhe organizatave jo qeveritare që merren me këto praktika, tregojnë se mbi 400 mijë qytetarë jetojnë nën pragun e varfërisë apo nuk janë në gjendje të hanë një porcion ushqim në ditë e le më te kenë 3 porcione ushqimi në ditë", tha Fadil Zendeli kryetar i Komisionit të përhershëm anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

Pikërisht me miratimin e konkluzioneve të mbledhjes së gjashtë të këtij komisioni të mbajtur me 19 korrik 2019, thotë Zendeli, anëtarët e komisionit ngritën iniciativë për krijimin e grupit interparlamentar brenda këtij komisioni. Qeveria dhe institucionet tjera që merren me këtë fushë obligohen të krijojnë një infrastrukture që ushqimet e tepërta nga restorantet, hotelet apo super marketet të grumbullon në një qendër që do të formohet nga qeveria e cila do t'i plotësojë të gjitha kushtet teknike për ruajtjen e ushqimeve të tepërta dhe me hapjen e një lidhje telefonike falas ku pronarët do të kërkojnë në këtë qendër se kanë tepricë të ushqimeve. Ekipet duhet të shkojnë dhe ta marrin ushqimin dhe ta sjellin në qendër për grumbullimin e ushqimeve tepricë me të vetmin qëllim që ky ushqim mos të hidhet në kosh të bërllokut.

"Qeveria duhet të punojë në drejtim të miratimit të një ligji ku i detyron restorantet apo hotele si dhe lokalet tjera që përgatisin gjella ushqimore apo prodhime të ushqimit, të mos i hedhin në kosha të bërllokut. Nëse një ligj i këtillë do të miratohej nga Qeveria, do të ishte një e mirë e natyrshme që njeriun të mund të ushqehet me tre vakte në ditë me ushqimin që në të shumtën e rasteve është pothuajse pak ose aspak i prekur nga klienti, e jo të hidhet në bërllok. Mos të lejojmë në të ardhmen ata që e kanë të tepërt ushqimin që ta hedhin, dhe ky ushqim i tepër të ju jepet atyre që nuk e kanë", tha Fadil Zendeli, kryetar i Komisionit anketues të përhershëm për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

NË VIT HIDHEN 10 TONË USHQIM

Miratimi i një ligji, sipas deputetes së BDI-së Mirsada Emini Hasani që është edhe anëtare e Komisionit anketues ka për qëllim të ndaloj restorantet, hotelet apo dyqanet tjera që brenda një viti të hedhin afro dhjetë tonë ushqim në deponitë me të cilin do t'iu mundësohej që së paku 13 mijë njerëzve të fitojnë tre shujta në ditë.

"Në favor të miratimit të një ligji të tillë flasin edhe faktet se në Maqedoninë e Veriut 445 mijë qytetarë nuk kanë mundësi të sigurojnë më shumë se një shujtë në ditë si rrjedhojë e varfërisë, e në anën tjetër shteti ka një dëm prej së paku dhjetë milion euro nga hedhja e ushqimit. Është për të ardhur keq sidomos në sezonin veror për çdo ditë ke nga një dasmë të organizuar. Paramendoni se sa ushqim i freskët i përgatitur gati pas përfundimit të dasmës hidhet në bërllok. Vetëm me ushqim që hidhet për këta katër muaj, me siguri se mbi 50 mijë familje do të siguronin ushqim të mjaftueshëm për tre vakte në ditë", thotë deputetja Mirsada Emini Hasani.

EKIPE MOBILE PËR GRUMBULLIM TË USHQIMIT

Maja Moraçanin, anëtare e Komisionit, kërkon nga Qeveria jo vetëm më ligj të ndalohet të hidhet çdo lloj ushqimi i tepërt, por në anën tjetër të ju lehtëson restoranteve, hoteleve apo dyqaneve që shesin prodhime ushqimore duke dërguar ekipe mobile dhe t'i grumbullojnë këto ushqime .

"Nëse në të ardhmen shteti me të vërtetë angazhohet që ushqimet tepricë të mos hidhen në kosha të bërllokut por të njëjtat të përfundojnë në tryezën e familjeve të varfër, atëherë shumë njerëz të varfër do ti konsumonin këto ushqimet që janë shumë më të pastra dhe të sigurta se ushqimet që i mbledhin në koshin e plehrave e që në të shumtën rasteve janë me afat të skaduar. Nëse vetëm gjysma e ushqimeve nga 10 tonë që hidhen në vit menaxhohen si duhet, atëherë mbi 50 mijë familje do të siguronin më së paku dy vakte ushqime në ditë", thotë deputetja Maja Moraçanin.

SINDIKATA E KLINIKAVE I REAGON MINISTRIT

KUNDËR PARTNERITETIT PRIVATO-PUBLIK NË SHËNDETËSI

Shkup, 31 mars - Sindikata e Qendrave Klinike ka kundërshtuar propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Venko Filipçe, për rajonalizim të spitaleve me partneritet privato-publik. "Derisa Ministria e Shëndetësisë mundohet për rajonalizim dhe mbyllje të spitaleve. Sindikata e Qendrës Klinike është e mendimit se për atë çështje duhet të konsultohen qytetarët. Për shkak të mospajtimeve të banorëve të komunës, në të kaluarën nuk u realizua plani i Ministrisë së Shëndetësisë për mbylljen e spitalit në Kriva Pallankë. Nëse planifikohet spitalet të jepen në pronësi të pronarëve privat, si model i partneritetit privat-publik për Sindikatën e qendrës klinike mbetet e paqartë se si ato do t'i plotësojnë kapacitetet e spitaleve dhe prej ku do të sigurojnë personel shëndetësor", potencojnë nga Sindikata.

Ata pyesin nëse planifikohet personel shëndetësor të plotësohet në llogari të Klinikës Universitare në përbërje të Qendrës klinike dhe të njëjtat të mbesin jo mjaft konkurrente të spitaleve të tilla "publike" private. "Duam të theksojmë se qëllimi i shëndetit publik nuk është realizimi i fitimit, por sigurimi i paqes sociale. Pasuria dhe siguria e shëndetit tonë publik është e drejta e zgjedhjes së mjekëve për të gjithë personat e siguruar, derisa e njëjta është privilegj i një numri të vogël të qytetarëve në shëndetësinë private. Njëkohësisht, shëndetësia publike shikuar në tërësi, ende e ofron shërbimin profesional më cilësor në shtet", citojnë nga Sindikata. Sindikata e Qendrave Klinike, shtohet në reagim, konsideron se partneriteti privat-publik, si marrëveshje afatgjate me obligimet e ndërmarra dhe pronarët qartë të definuar është i dëmshëm për shtetin, të punësuarit në institucionet shëndetësore publike, ndërsa sigurt më

së shumti për pacientët dhe qytetarët. Për shkak të fillimit të fushatës zgjedhore, sipas përcaktimit, nga Sindikata e qendrës klinike informojnë se do ta ndërpresin komunikimin me opinionin dhe mediumet deri në përfundimin e procesit zgjedhor. *(D.K)*

QEVERIA EDHE EKSPERTËT ME QËNDRIME TË KUNDËRTA

EKONOMIA, JO SIKURSE THOTË QEVERIA

Arritja e Marrëveshjes së Prespës për zgjidhjen e kontestit me Greqinë është arritje e madhe dhe këtë askush nuk mund ta mohojë, por nuk është aspak reale të pretendosh se kemi mirëqenie të lartë, se kemi zhvillim ekonomik, apo se gjithçka ka nisur të lulëzojë, thotë profesori universitar Bashkim Selmani

GORAN RAFJALLOVSKI

Ekonomia e Maqedonisë nuk ka të ardhme të mirë, pavarësisht paralajmërimeve të mëdha nga anëtarësimi në NATO dhe pritjes për hapjen e bisedimeve për anëtarësim në BE. Patjetër duhet të ketë strategji kombëtare, të cilën do ta votojnë të gjitha partitë në Kuvend dhe e cila në të ardhmen do të jetë udhërrëfyes i programeve të tyre dhe realizimeve gjatë mandatit

Shkup, 31 mars - Maqedonia e Veriut është në rrugë të mbarë të zhvillimit ekonomik e social, të ngritjes së standardit dhe mirëqenies së qytetarëve, si dhe të konsolidimit e forcimit të institucioneve, thonë nga Qeveria duke dhënë vlerësime pozitive për punën e bërë, por me të cilat nuk pajtohen njohësit e rrethanave ekonomike dhe politike në vend. Kryeministri Zoran Zaev në takim me qytetarët vazhdon të thotë se Maqedonia e Veriut si asnjëherë më parë, ndihet e sigurt dhe se institucionet tashmë po japin rezultate konkrete.

"Unë dëshiroj t'ju bind se do të jemi shembull i shkëlqyer në ekonomi ashtu siç jemi shembull edhe në diplomaci para gjithë botës. Ne, në këto dy vite të qeverisjes, kemi shënuar rezultate mahnitëse. Kemi siguruar paqe të përhershme me anëtarësimin në NATO, jemi në rrugë të marrjes së datës për nisjen e bisedimeve për anëtarësim në BE... Unë jam i bindur se do të arrijmë edhe pagën e premtuar prej 500 eurosh. Për më pak se gjashtë muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes me Greqinë për emrin, kemi arritur të tërheqim mbi 600 milionë euro investime të huaja, apo katër herë më shumë se në vitin 2017. Papunësia në vend ka arritur nivelin më të ulët, nën 20 për qind. Janë hapur më shumë se 26 mijë vende të reja të punës...", ka deklaruar Zaev.

Arritja e Marrëveshjes së Prespës për zgjidhjen e kontestit me Greqinë është arritje e madhe dhe këtë askush nuk mund ta mohojë, por nuk është aspak reale të pretendosh se kemi mirëqenie të lartë, se kemi zhvillim ekonomik, apo se gjithçka ka nisur të lulëzojë, thotë Bashkim Selmani, profesor në Fakultetin Juridik në Universitetin "Fon" të Shkupit. Bazuar në disa anketime të bëra, ai thotë se eksodi që ka përfshirë vendin, flet më së miri për gjendjen në vend, pasi popullata që po largohet në shtetet evropiane këtë e bën për shkak të mungesës së perspektivës në Maqedoninë e Veriut. Selmani thotë se ligjet që po i miratojnë institucionet janë të mira, por që nuk po zbatohen në praktikë.

"Miratimi i ligjeve është vetëm formal pasi ato nuk zbatohen në praktikë. Asnjë prej tyre nuk ka nisur të praktikohet që të ndryshojë pozitën e funksionimit të shtetit të drejtës, por edhe përmirësimin e gjendjes së rëndë ekonomike. Sikur të kishim një standard më të lartë apo gjendje të mirë ekonomike, nuk do të kishim zbrazjen e Maqedonisë apo ikjen e popullatës. Nëse analizojmë çështjen e punësimeve, këtu nuk kemi krizë vetëm me të papunët, por edhe me ata që janë të punësuar janë në krizë pasi çdo i treti nga ta është futur në kredi për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike", thotë ai. Ndërkohë, Goran Rafjallovski, afarist, thotë se shteti duhet të ndërtojë një strategji të qartë për zhvillimin e ekonomisë pasi gjendja momentale nuk është e favorshme pavarësisht pretendimeve të Qeverisë se me anëtarësimin e vendit në NATO, gjërat do të do të ndryshojnë.

"Ekonomia e Maqedonisë nuk ka të ardhme të mirë, pavarësisht paralajmërimeve të mëdha nga anëtarësimi në NATO dhe pritjes për hapjen e bisedimeve për anëtarësim në BE. Patjetër duhet të ketë strategji kombëtare, të cilën do ta votojnë të gjitha partitë në Kuvend dhe e cila në të ardhmen do të jetë udhërrëfyes i programeve të tyre dhe realizimeve gjatë mandatit", thotë Rafajllovski. Se rezultate në ekonomi nuk ka, flet edhe një raport i Odës Ekonomike Gjermane në Maqedoninë e Veriut, sipas të cilit efektet ekonomike të Qeverisë janë thuajse zero. Por, nga Qeveria janë arsyetuar duke thënë se shifra është nxjerr nga vlerësimet e afaristëve gjermanë, shumë prej të cilëve, sipas ekzekutivit, sërish janë shprehur të gatshëm të vazhdojnë bashkëpunimin me bizneset vendore. *(REL)*

RRITEN ÇMIMET E PRODHIMEVE INDUSTRIALE

Çmimet shitëse të prodhuesve të prodhimeve industriale në tregun vendor në shkurt të këtij viti janë më të larta për 0,7 për qind në nivel mujor dhe janë më të ulëta për 0.1 për qind në nivel vjetor. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, në shkurt të vitit 2019, në krahasim me janarin e vitit 2019, çmimet shitëse të prodhuesve të prodhimeve industriale në tregun vendor janë më të larta në grupet e prodhimeve jo të qëndrueshme për konsum të gjerë për 1.2 për qind, prodhimet intermediare, përveç energjisë për 0.4 për qind dhe Energji për 0.1 për qind. Në shkurt të vitit 2019, në krahasim me shkurtin e vitit 2018, çmimet shitëse të prodhuesve të prodhimeve industriale në tregun vendor janë më të ulëta në grupet e energjisë për 5.3 për qind dhe prodhimet kapitale për 1.1 për qind.

THIRRJA PUBLIKE NGA PROGRAMI IPA II

RRETH 2 MILIONË EURO PËR PROJEKTE NDËRKUFITARE ME KOSOVËN

Shkup, 30 mars - Komunat, organizatat qytetare, shkollat, universitetet, shoqatat e biznesit dhe subjekte të tjera jofitimprurëse nga Maqedonia e Veriut në partneritet me subjekte të tjera nga Kosova mund të aplikojnë në thirrjen publike për projekte për bashkëpunim ndërkufitar të financuar nga programi IPA II, për të cilat janë paraparë rreth dy milionë euro. Nxitja e turizmit, trashëgimisë kulturore dhe natyrore, ruajtja e mjedisit jetësor, promovimi i përshtatjes dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, si dhe parandalimi dhe menaxhimi me rreziqe janë sferat në të cilat duhet të fokusohen këto projekte. Thirrja publike është publikuar dje, ndërsa do të zgjasë deri më 20 maj. Çdo aplikues mund të aplikojë me projekt në vlerë prej 150 mijë euro deri në 500 mijë euro.

Siç informoi ministri i Vetëqeverisjes Lokale, Suhejl Fazliu, mjetet për bashkëfinancim në shumë prej 15 për qind për projektet të cilat implementohen në vend do të sigurohen nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale. Me thirrjen nga ana jonë janë rajonet ndërkufitare në rajonin planor të Pollogut, Shkupit dhe ai Verilindor. "I inkurajoj të gjithë të interesuarit të paraqiten dhe të shfrytëzojnë mundësinë të bëjnë diçka më tepër për veten e tyre, për komunën, për regjionin ndërkufitar dhe për shtetin. Projektet për bashkëpunim ndërkufitarë janë mundësi e shkëlqyeshme të punojmë bashkërisht në zgjidhjen e çështjeve regjionale, të shkëmbejmë informacione, të njihemi më mirë dhe të vendosim lidhje bashkëpunimi të cilat mund të zgjerohen edhe në fusha tjera. Qëllimi ynë është që në periudhën e dytë programore, të arrijmë shkallë të lartë të realizueshmërisë në mbi 90 për qind të mjeteve financiare që janë në dispozicion nga Bashkimi Evropian", tha ministri i Vetëqeverisjes Lokale Suhejl Fazliu. Programi për bashkëpunim ndërkufitarë ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës 2014-2020 filloi të implementohet në janar të vitit 2016 ndërsa në disponim ka buxhet prej 8.4 milionë euro për projekte të përbashkëta. Deri tani, përmes këtij programi, janë financuar nëntë projekte me vlerë prej 2.5 milionë euro për përfituesit e granteve nga të dy anët e kufirit që janë në fazën e implementimit. Si shembuj Fazliu i theksoi rinovimin e tregut në Kumanovë, ndërtimin e shtigjeve të këmbësorëve në Kriva Pallankë dhe shtigjeve të këmbësorëve në Malin Sharr me shenja përkatëse turistike, infoqendrën turistike smart në Tetovë

si edhe qendrën për trajnimin e grave dhe të rinjve në Kumanovë. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës është paraqitur interesimi për financimin e projekteve të ndryshme në rajonin e Prespës prej të dyja anëve të kufirit.

Komunat të tregojnë shpenzimin e parave të popullit

Shkup, 31 mars - Apel deri te kryetarët e komunave në vend ta ndjekin politikën e Qeverisë dhe t'i publikojnë në mënyrë transparente shpenzimet në komunat e tyre, tha ministri i Vetëqeverisjes Lokale, Suhejl Fazliu. Në mënyrën të cilën i shpenzojnë paratë e popullit, shtoi ai, prioritet duhet të jetë përgjegjësia ndaj qytetarëve, sepse ata sërish do të përballen me to në zgjedhje, ndërsa edhe tani gjatë zgjedhjeve presidenciale, nëse nuk punojnë si duhet, do të ndikojnë negativisht ndaj kandidatit presidencial, pas së cilit janë ndalur. "Apeloj deri te të gjithë kryetarët e komunave ta ndjekin hapin e Qeverisë, i cili përmes veglës elektronike i publikon shpenzimet e të gjitha ministrave, atë ta bëjnë edhe ata. Nuk kemi mekanizma t'i detyrojmë kryetarët e komunave ta bëjnë atë, sepse kemi shoqëri të decentralizuar, por u sugjeroj në frymën e transparencës t'i ndjekin këto hapa, të cilat do t'i afrojnë me qytetarët", tha Fazliu. Në lidhje me atë nëse komunat i kanë përfunduar obligimet e tyre rreth shlyerjes së borxheve dhe të dorëzojnë dokumente për atë deri te Ministria e Financave, Fazliu theksoi se tërë ai proces ndiqet nga Ministria, i cili është propozues i ligjit. Theksoi se ai në vizita formale dhe joformale të komunave ka konkluduar se disa nga ato i kanë përfunduar obligimet e tyre, ndërsa disa janë në fazën e përfundimit. Në pyetjen nëse Qeveria ka mekanizëm t'i kontrollojë kryetarët e komunave dhe si ata i shpenzojnë paratë e popullit, Fazliu përmendi se së pari ata duhet të kenë përgjegjësi ndaj qytetarëve të cilët i kanë zgjedhur.
"Hapi i parë duhet të jetë përgjegjësia ndaj qytetarëve. Ato kryetarë të komunave të cilët shpenzojnë në luks duhet të mendojnë se ndoshta në zgjedhjet e ardhshme duhet sërish të dalin para votuesve, në zgjedhjet e ardhshme presidenciale mund ta dëmtojnë subjektin politik, të cilin e paraqesin në atë komunë. Gjithashtu, ka edhe institucione kompetente, të cilat duhet t'i shqyrtojnë informatat e tilla, të ngritin procedura. Në suaza të ligjit për ndihmë të komunave me mjete konkrete për mbulim të borxheve kishte edhe ndryshimi i Ligjit për financim të komunave", tha Fazliu.

MBIPOPULLIMI NË KOMUNËN URBANE SHQIPTARE TË SHKUPIT

ÇAIRI, "STAMBOLLI" I MAQEDONISË SË VERIUT

Çairi aktualisht ka dendësinë më të madhe të popullatës jo vetëm në Maqedoninë e Veriut dhe Ballkan, por edhe në Evropë. Në një kilometër katrorë jetojnë 18.401 banorë. Po të krahasohet me Butelin, Gazi Babën dhe Gjorçe Petrovin, që kanë nga 650 banorë në një kilometër katror, Çairi ka 30 herë më shumë banorë në një kilometër katrorë, apo tre herë më shumë se sa Komuna Qendër që ka 6039 banorë një kilometër katrorë

Koha Destan JONUZI

Shkup, 31 mars - Vetëm zgjerimi i kufijve dhe kujdesi më i madh me planin urbanistik mund të shpëtojë Komunën e Çairit nga mbipopullimi i tepruar, thonë banorët, duke folur për dendësinë e madhe të popullatës në komunën e tyre. Çairi aktualisht ka dendësinë më të madhe të popullatës jo vetëm në Maqedoninë e Veriut dhe Ballkan, por edhe në Evropë. Në një kilometër katrorë jetojnë 18.401 banorë. Po të krahasohet me komunat tjera të Shkupit, Çairi ka numër shumë më të madh të banorëve që banojnë në një sipërfaqe prej 3.52 kilometra katrorë.

Nga ana tjetër, sipas të dhënave zyrtare, Komuna e Butelit, Gazi Babës dhe Gjorçe Petrovit kanë nga 650 banorë në një kilometër katror, kurse Çairi ka 30 herë më shumë banorë në një kilometër katrorë, apo tre herë më shumë se sa Komuna Qendër që ka 6039 banorë një kilometër katrorë. Gjithashtu, edhe Komuna e Aerodromit - që llogaritet si komuna më madhe në Shkup me territor, ka gjashtë herë më pak banorë në një kilometër katror, edhe atë 3296 banorë. Ndërsa, komunat tjera si Karposhi dhe Kisella Voda kanë nga 1672 banorë në një kilometër katrorë, që është tetë herë më pak se Komuna e Çairit.

Komuna që ka më pak banorë në një kilometër katrorë është ajo e Sarajit dhe atë me 155 banorë në një kilometër. Krahasuar me komunat e tjera në Maqedoni, Komuna e Çairit mbetet shumë më larg sa i përket mbipopullim. Për dallim nga Çairi, në Komunën e Berovës në një kilometër katrorë jetojnë 24 banorë, në Dibër në një kilometër katrorë jetojnë 134 banorë, në Gostivar 134 banorë në një kilometër katrorë dhe Ohër 142 banorë në një kilometër katrorë.

Sipas analizave të projektuara, rritja e popullsisë më së shumti mund të jetë për shkak të lëvizjes prej fshatit në qytet. Kjo, gjithashtu ka shkaktuar një katastrofë të madhe me ndërtimin e shumë shtëpive, banesave, dhe shumë ndërtesave pa leje, të cilat si pasojë kanë lënë rrugë shumë të ngushta, trafik të madh ku nuk ka vend as për parkingje. Kjo e ka bërë Çairin, komunën më të dendur në Evropë. "Faktori kryesor i mbipopullimit të komunës është ndërtimi i pakontrolluar dhe i shfrenuar i ndërtesave banesore. Rritja e numrit të banorëve do të ishte për të lakmuar sikur proporcionalisht të zhvilloheshin edhe kushtet e jetesës në komunën tonë", thotë për gazetën KOHA, Shaban Ibrahimi, banor i Çairit.

"Komuna jonë është e betonizuar, nuk respektohen as zonat e gjelbra të cilat janë shkatërruar tërësisht", thotë një banorë tjetër i Çairit, i cili shprehet skeptik se mund të gjendet një zgjidhje për këtë problem. Ai thotë se në vend se të urbanizohet, Çairi gjithnjë e më shumë po bëhet një "fshat" i madh. Urbanisti Ivan Arsov thekson se për këtë problem duhet një strategji mirë e analizuar që Çairi në vend të jetë i mbingarkuar me ndërtime të dobëta, të ketë më shumë hapësira publike.

"Duhet strategji. Të shihen mundësitë. A do të jetë ajo zvogëlimi i numrit të banorëve me transferim nga një zonë në një zonë tjetër... Më pas ka shumë ndërtime të reja me kualitet të ulët në Komunën e Çairit. Duhet të aplikohen disa metodologji urbanistike, siç është komisariati urban, të hapet hapësira e cila është e mbingarkuar me ndërtime me strukturë të dobët dhe të sigurohen më shumë hapësira me karakter publik. Kjo mund të sigurohet nga zonat e reja të ndërtimit, banesat individuale etj, por megjithatë duhet të vihet një kufi ku mund të shihet se sa banorë mund të jetojnë në një metër katror, që të kenë jetë të shëndetshme dhe hapësirë kualitative. Kjo gjithsesi duhet të realizohet nëpërmjet planit urbanistik, por paraprakisht duhet të kemi një strategji se si duhet të zgjidhet ky problem dhe se si do ti qaset problemit. Duhet të gjendet një mënyrë", thotë për KOHA, urbanisti Ivan Arsov.

Sipas tij, së pari duhet një hulumtim terreni ndaj qytetarëve, të shkohet në terren dhe të shihet se si është gjendja, cilat janë mundësitë e ndonjë hapësire të caktuar. "Në këtë projekt duhet të participojnë të gjitha palët. Sipas meje, komuna duhet që këtë politikë ta ndjekë", nënvizon Arsov. Por, kreu i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, thotë se po punohet në gjetjen e një zgjidhje të këtij problemi të madh për komunën dhe banorët e Çairit.

"Komuna e Çairit duke qenë e vetëdijshme për problematikën e mbipopullimit të territorit të saj dhe dendësisë më të madhe të popullsisë në Evropë, ka filluar të hartojë projekte vetjake dhe në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit për zgjerimin e rrugëve aktuale, zmadhimin e kapaciteteve për parkim, krijimin e korsive për biçikleta dhe subvencione për blerjen e të njëjtave, si masa për krijimin e një proporcioni adekuat infrastrukturor me numrin e popullsisë. Po ashtu,në të ardhmen e afërt nuk përjashtohet mundësia për propozimin e intervenimeve në Ligjin për ndarje territoriale dhe Planin Detal Urbanistik", thotë Ganiu.

Përndryshe, Komuna e Çairit është e formuar në vitin 1976 me Ligjin për formimin e komunave në kuadër të qytetit të Shkupit. Me Ligjin e ri për ndarje të re territoriale, kufijtë e Komunës së Çairit u

VISAR GANIU

Komuna e Çairit duke qenë e vetëdijshme për problematikën e mbipopullimit të territorit të saj dhe dendësisë më të madhe të popullsisë në Evropë, ka filluar të hartojë projekte vetjake dhe në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit për zgjerimin e rrugëve aktuale, zmadhimin e kapaciteteve për parkim, krijimin e korsive për biçikleta dhe subvencione për blerjen e të njëjtave, si masa për krijimin e një proporcioni adekuat infrastrukturor me numrin e popullsisë

zvogëluan në masë të madhe gjë që paraqet hendikep të madh në zhvillimin e mëtejshëm të komunës. Ndërsa, me ndarjen e re territoriale, Qytetin e Shkupit e përbëjnë 10 komuna në mesin e të cilave është edhe Çairi. Numri i përgjithshëm i popullsisë në Komunën e Çairit, sipas regjistrimit të vitit 2002, është 64.773 banorë apo 3.2 % të popullatës së përgjithshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Prej vitit 2002 nuk ka pasur asnjë regjistrim të banorëve dhe numrat mund të kenë ndryshuar shumë. Sipas disa parashikimeve, numri i banorëve mund të arrijë në 100 mijë.

(Me këtë shkrim, gazeta KOHA i bashkëngjitet fushatës nga interesi publik për ambientin jetësor më të mirë "Mos injoro! Reago!")

PUNIMET NË VENDNUMËRO, PREMTIMET VAZHDOJNË

BULEVARDI QË PO BLLOKON TETOVËN

Nga fundi i muajit qershor të vitit të kaluar filluan punimet e fazës së parë për hapjen e bulevardit të shumëpërfolur "Bllagoja Toska" në Tetovë. Por ende punët kanë ngelur në pjesën fillestare me vetëm rrënimin e dy objekteve të pabanueshme dhe nuk është vijuar me punët

Koha — Urim HASIPI

Tetovë, 31 mars - Qytetarët janë të lodhur me premtimet e vazhdueshme për fillimin e punëve për hapjen e bulevardit "Bllagoja Toska" në Tetovë. Ata shprehen të zhgënjyer me premtimet e njëpasnjëshme ndër vite se ky bulevard shpejtë do të fillojë të ndërtohet.

Sipas banorëve, tashmë në këtë pjesë ka shumë pluhur, ka shumë baltë, krijohet kaos me parkimin e veturave dhe kjo situatë tashmë po përsëritet vite me radhë. "Nuk e kanë ndërmend me e rregullu, çdo ditë kalojmë këtu, ka pluhur, ka makina të parkuara, është vërtetë gjendje e mjerueshme. Apelojmë si banorë të lagjes të ndërtohet ky bulevard dhe të lirohet kjo pjesë e qytetit nga ngufatja", thonë disa banorë të kësaj lagje. Ata janë të revoltuar se pse nuk fillojnë punët dhe stërzgjatet fillimi i një nga projekteve të cilësuara si më kapitale në qytetin e Tetovës. Kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, ndërkohë ka theksuar edhe njëherë se problem mbetet eksproprijimi i shtëpive, të cilët duhet të rrënohen. Sipas saj, janë katër objekte që kanë mbetur problematike. "Me çështjet e eksproprijimit nuk kemi patur shumë fat. Jemi në përfundim edhe me katër objekte me eksproprijimin që besojmë që shpejt do të intervenojmë edhe atje. A do të jetë ajo e mjaftueshme për të filluar edhe punimet e plota, do të mbetet që të shihet", tha Arifi, pa dhënë ndonjë afat konkret për fillimin e punëve.

Nga fundi i muajit qershor të vitit të kaluar filluan punimet e fazës së parë për hapjen e bulevardit të shumëpërfolur "Bllagoja Toska" në Tetovë. Por ende punët kanë ngelur në pjesën fillestare me vetëm rrënimin e dy objekteve të pabanueshme dhe nuk është vijuar me punët.

Gjatë muajve të verës - korrik, gusht e në muajt në vijim të 2018, nuk janë zhvilluar punime, ndërsa i njëjti vend shfrytëzohet për parking. Në fazën e dytë gjatë procesit të eksproprijimit do të rrënohen 19 objekte në këtë bulevard. Bulevardi "Bllagoja Toska" fillon nga unaza në bulevardin e "Ilinden" dhe përfundon te stadiumi i qyteti. Hapja e këtij bulevardi përpos kostos së madhe, do të duhet të rrënojë dhe disa shtëpi dhe njëkohësisht të zgjidh disa çështje pronësore juridike. Edhe pse kjo rrugë gjendet pothuajse në zemër të Tetovës dhe afër Spitalit Klinik në Tetovë, në këtë pjesë nuk është bërë as një investim infrastrukturore edhe përkundër frekuentimi të madhe të qytetarëve dhe shumë premtimeve.

Hapja e bulevardit "Bllagoja Toska" do të lehtësonte qarkullimin e automjeteve dhe njerëzve në pjesën qendrore të qytetit. Arsyetimi i autoriteteve të Komunës së Tetovës për mosrealizimin e këtij projekti ka qenë ndërtimet pa leje që janë në procedurë legalizimi. Nga Sektori për tokë ndërtimore dhe komunikacion pranë Komunës gjatë vitit të kaluar ishin shprehur se në këtë mandat hapja e këtij bulevardi do të jetë prioritet. Nga atje shpresojnë se këtë vit do të fillohet intenzivisht të punohet. Sipas informacioneve, procedura e shpronësimit vijon të mbetet problem serioz që të fillojnë punët.

Nga Komuna disa herë gjatë miratimeve të Buxhetit vjetor ndër vite kanë paraparë mjete për këtë bulevard, por gjithnjë punët nuk kanë filluar.

Pikërisht mos fillimi i punëve, shpeshherë është përcjellë edhe me kritika nga këshilltarët e opozitës në Këshillin e Komunës së Tetovës, të cilët kanë kërkuar përgjegjësi dhe përgjigje se pse nuk fillon ndërtimi i bulevardit.

Pranvera sjell alergji

Shkup, 31 mars - Bashkë me pranverën, vijnë edhe alergjitë .Sipas pneumologëve, personat që ndikohen nga poleni përfshijnë probleme të frymëmarrjes, syve dhe të lëkurës. Simptomat dhe reagimet e shkaktuara nga alergjitë mund të rezultojë edhe në çrregullime të gjumit dhe si të tilla do të çojnë në degradimin e cilësisë së jetës. Rreth 30 % e qytetarëve të rruzullit tokësor kanë ndjeshmëri ndaj polenit, thonë pulmologët, kurse kjo alergji mund të manifestohet në çfarëdo moshe. Simptomat më të shpeshta të alergjisë së rrugëve të frymëmarrjes manifestohen përmes teshtitjes, sekrecioneve të hundës, lotimit të syve, kollitjes dhe djersitjes.
Prandaj një këshillë për prindërit është që sa herë që fëmija kollitet për një kohë të gjatë, ose është vazhdimisht i vrenjtur, dhe vërehen këto simptoma, është e nevojshme të vizitohet te mjeku, sepse aludohet për një alergji. Personat e prekur nga alergjitë e pranverës, sa vjen e rritet numri. Dr.Afrim Aliu thotë se fëmijët e vegjël janë më të prekur nga alergjitë, sidomos në pranverë. Sipas tij me kalimin e kohës organizmi adaptohet dhe nuk nxit reaksione të vrullshme, ndërkohë që ai rekomandon terapi adekuate dhe largim nga ambientet alergjike.
Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Shoqata Botërore e Astmës, kanë shpallur shekullin XXI si shekullin e epidemive dhe sëmundjeve alergjike, që stimulohet nga ndotja e lartë e ajrit, veçanërisht nga përqendrimi i lartë i acideve radikale siç është azoti, squfuri, grimcat e ozonit, benzoatet dhe të tjera të ngjashme, të cilat shkaktojnë një plagë të madhe në mukozën respiratore. *(D.K)*

DITË E HAPURA TË UEJL-së

UEJL DO TË PRANOJË 1 100 STUDENTË NË STUDIMET DERIDIPLOMIKE

Tetovë, 31 mars - Universiteti i Europës Juglindore në Tetovë përmes aktivitetit të ditës së hapur përpara maturantëve të shkollave të ndryshme nga disa qytete të Maqedonisë së Veriut, por edhe nga rajoni, ka prezantuar ofertën akademike për vitin akademik 2019/2020, stafin e profesorëve, kushtet studimore dhe infrastrukturën e Universitetit, ku maturantët kanë pasur mundësi që të njihen me programet studimore si dhe me tërë infrastrukturën përcjellëse që e posedon universiteti për studime të standardizuara.

Rektori Abdylmenaf Bexheti ka shpalosur edhe risitë për këtë vit akademik që janë disa programe të reja studimore në fakultetin ekonomisë dhe biznesit si dhe disa fakultete të tjera dhe theksoi se për këtë vit akademik Universiteti i Europës Juglindore planifikon që të pranojë rreth 1100 studentë në studimet deridiplomike, pasdiplomike dhe ato të doktoraturës.

"Sigurisht se edhe sivjet kemi risi, që janë tre programe studimore, si risi e veçantë, dhe atë njëri është në fakultetin e biznesit dhe ekonomisë, me drejtim financa dhe bankë, pra me specifikim në banka. Është programi i dytë në të njëjtin fakultet, i ndërmarrësis, që në njëfarë mënyre është në bashkëpunim edhe me kompanitë, apo sistem i integruar, dual i mësimdhënies që do jetë teorik por edhe praktik, pra 70 për qind praktikë, 30 për qind teori, dhe njëkohësisht ky është program që do ketë komponente komplet në gjuhën angleze, dhe i financuar tërësisht nga kompani që garanton edhe perspektivën edhe punësim në të. Veç kësaj kem edhe program në fakultetin juridik, të ashtu quajtur informatika juridike", tha Bexheti.

Edhe maturantët që kishin ardhur enkas për t'u njohur më për së afërmi me ofertën akademike dhe kushtet e Universiteti te Europës Juglindore thanë se përshtypjet e tyre për këtë Universitet janë të mira dhe se në të ardhmen do të shqyrtojnë mundësinë për të studiuar pikërisht në Universitetin e Europës Juglindore. Dita e Hapur është një aktivitet që tanimë është shndërruar në traditë në Universitetet tona ku për çdo vit Universitetet shpalosin ofertat akademike për nxënësit të cilët më për së afërmi njihen me Universitetin dhe më pas e kanë më të lehtë të vendosin se çfarë dhe ku të studiojnë. *(U.H)*

Faleminderit ambasador!

Nga
Belul BEQAJ

Mediat e prira për infotainment i kanë dhënë më shumë publicitet rrëzimit të ambasadorit të Zvicrës në Kosovë, Jean-Hubert Lebet, teksa ka dalë për të folur për përurimin e ujësjellësit në disa fshatra të Komunës së Skenderajt, sesa mesazhit dashamirës të cilin e kanë trajtuar si të "ashpër". S'do mend se lidershipi politik i Kosovës reflekton vullnetin politik të shtetasve të Kosovës. Por, ndikimi i miqve ndërkombëtarë në mbështetjen njëzetvjeçare të këtij lidershipi është shumë i rëndësishëm, të mos them përcaktues.

Mjerisht, pikërisht për këtë, gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur rotacion të pushteteve dhe politikëbërjes. Vazhdimësia e pushteteve me pjesëmarrje herë pas here të disa subjekteve të reja apo të vjetra politike të pragmatizmit politik ka krijuar rrethin vicioz. Prandaj , jemi të sfiduar katërcipërisht. Veçmas nga krimi dhe korrupsioni. Humbja e shpresës se do të bëhet më mirë.

Ambasadori zviceran në një vend të duhur, para audiencës së duhur, me një vonesë të konsiderueshme, përmes një donacioni ekzistencial, dha një mesazh të duhur. Pra, në Skenderaj ambasadori për dallim nga ambasadorët miklues ndaj lidershipit politik të Kosovës, fillimisht ekuivokë, ka përmendur numrin e madh të veteranëve (rreth 50.000, vërejtja ime) "duke thënë që nuk duhet paguar veteranët e rrejshëm e pastaj të tjerët të investojnë në projekte qenësore për qytetarët. Vlera e këtij projekti kushton vetëm 2.5 për qind e buxhetit të veteranëve për vitin 2019, që një shumë e konsiderueshme shpenzohet për veteranët e rremë.

Së dyti, ai ka folur edhe për shërbyesit civilë në Kosovë (80.000 vërejtja ime) duke theksuar se nuk është normale që Kosova ka tri herë më shumë shërbyes civilë sesa vendet fqinje. Tri herë më shumë! Nuk është normale që qytetarët e Kosovës detyrohen të emigrojnë për t'i ushqyer familjet e tyre... pasi që në Zvicër ka më shumë se 100.000 kosovarë (vërejtja ime)!

Arsyet pse ambasadori ka përmendur këto dy kategori ishin shumë domethënëse. Për faktin se as veteranët e vërtetë nuk e kontestojnë numrin serik të veteranëve të rrejshëm. Së dyti, administrata e Kosovës është e stërmbushur me shërbyes civilë, të cilët më shumë i

pengojnë njëri-tjetrit sesa që e bëjnë administratën efikase dhe azhure në administrim! Pra, ambasadori ka përmendur dy aksioma anakronike që nuk kanë nevojë të dëshmohen, ngase janë vetë - dëshmi. Ajo që duhet kuptuar si detyrim edhe nga kryeparlamentari që reagoi emocionalisht, është fakti se këto dy kategori janë produkt i kësaj politike, e cila dëshiron të mbijetojë përmes tyre. Meqë potencialisht vetëm këto dy kategoritë jomerituese (klientelizimi është kaptinë e veçantë) mundësojnë vazhdimin e këtij pushteti, meqë ngërthejnë në vete rreth 200.000-300.000 votues potencialë,pra, gati sa gjysma e atyre që dalin në zgjedhje (rreth 50%), duke marrë parasysh faktin se trupi zgjedhor numëron rreth 1.600.000 votues. Kryeparlamentari e di se vërejtja e ambasadorit nuk ishte drejtuar specifikisht për Skenderajn, por

> **Sa më shumë që po mbrohen veteranët e rrejshëm, aq më shumë po zbehet besimi te veteranët e vërtetë**

për fenomenet që po ia vazhdojnë jetëgjatësinë e këtij lidershipi dhe politikëbërjeje. Ndërsa moskundërshtimi i listës së veteranëve të rrejshëm dhe administratës së fryrë tregon se lufta për liri dhe shtetndërtim nuk ishte e vërtetë. Sa më shumë që po mbrohen veteranët e rrejshëm, aq më shumë po zbehet besimi te veteranët e vërtetë. Nëse mbrohen vlerat e rrejshme, ne nuk bëhemi më të mirë, e as që e bëjmë shtetin dhe shoqërinë më të mirë.

Prandaj, faleminderit ambasador Hubert për fisnikërinë ndaj qytetarëve dhe shtetin e Kosovës! Faleminderit për gatishmërinë për t'i inkurajuar qytetarët e denjë duke i qortuar politikanët mospërfillës me shembullin tuaj personal.

Në fillim të fjalimit tuaj u rrëzuat duke u bërë buzagaz për mediet e infotaimentit, gjatë zbritjes nga foltorja përçuat, në shkaka, edhe një mesazh për liderët meritorë dhe mediat profesionale, duke thënë "po tentoj të zbres pa u rrëzuar". Mjerisht, shumë liderë politikë dhe media të lidhura me ta nuk po kuptojnë se janë rrëzuar duke tentuar për t'i mbrojtur liderët dhe politikën që na solli në këtë gjendje.

(koha.net)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
E përditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel, 31 mars 2019 | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Mësuesi që të mëson dhe të edukon, të bën më të fortë

Nga
Xheladin MURATI

Mësuesi që të mëson dhe të edukon, të bën më të forte? Sa është e rëndësishme kjo? dhe Sa ka të vërtetë në këtë? Po, sigurisht që është e rëndësishme dhe ka të vërtetë në këtë. Po ta njohësh më mirë nxënësin, mund të kontribuosh ta bësh atë të fortë. Me këtë rast, punosh sipas qëllimeve të projektuara dhe bësh punë kuptimplote. Sa më tepër ta njohësh nxënësin, ti afrohesh atij, ai jo që vetëm do të respektojë por edhe do të ndihmojë që ti ndihmosh atij. Tek e fundit njohuritë e sakta për nxënësin të hapin horizonte të mjaftueshme të zhytesh në shpirtin dhe botën e tij. Vetëm kur trajtohet nxënësi si person real të cilit mund ti afrohet mësuesi, ai arrin sukses.

PREMISAT. Për të trajtuar temën në fjalë kam këto premisa: 1. Dashuria e mësuesit ndaj nxënësit ndihmon të fokusoheni në shpirtin e nxënësit dhe ta përgatitni atë për ardhmëri. 2. Mësuesi duhet të kuptoje se nëse kërkon të arrije më shumë, duhet dhe të jep më tepër. 3. Mësuesit nuk ankohen, por në heshtje bëjnë punë dhe 4. Mësuesi duhet të kujdeset për nxënësin sikur kujdeset për veten.

QASJET DHE ASPEKTET. Çka nënkupton ta njohësh nxënësin? Mendoj se kjo do të thotë të formosh një kartë të qëndrueshme për personalitetin e tij. Sigurisht këtu vlen të theksoj të kesh dijeni për pëlqimet dhe jo pëlqimet e tij, të njohësh cilësitë e personalitetit të tij, gjërat që ka bërë ose tenton që ti bëj. Pikërisht duke i mësuar gjërat elementare të personalitetit të tij, ato të tërheqin që të merresh me to, të kërkosh rrugë e metoda, të punosh në drejtim të zhvillimit të tyre.

Është e natyrshme që mësuesit të jenë veçanërisht të afërt me nxënësit e tyre. Megjithatë duhet bërë kujdes që parimet e vendosura nga pedagogjia për raportet mësues-nxënës të mos shkelen. Këtu dy parime janë themelore që e rregullojnë marrëdhënien: parimi komplementar dhe ai subordinar.

Sa më shumë i dallojmë cilësitë e nxënësit, aq më mirë e njohim dhe si rezultat puna pedagogjike në edukimin e tij thellohet. Njëherit sa më shumë nxënësit afrohen me mësuesin, e njohin atë aq më mirë krijohet miqësia midis tyre. Cilat janë cilësitë më të theksuara që e bëjnë përafrimin midis mësuesit e nxënësit? Mund të përmendim disa sish, por mendoj se pesë nga këto janë më të rëndësishmet:

Për të vlerësuar punën e mësuesit, gjërat e shumta që ai ka bërë e që bën sjellin dobi sot e nesër, madje edhe në të ardhmen. Në fakt, planet dhe ëndrrat e mësuesit domosdo duhet të kenë arsye personale dhe profesionale, përndryshe nuk arrin qëllimet e edukimit

1. Fuqia - rezultatet e tregojnë fuqinë krijuese dhe edukative, mësuesi e përdorë fuqinë e tij për të mirën e nxënësve, por ajo është fuqi normale;

2. Mençuria - shprehet në këshillat që jep mësuesi meqë ai është mik i nxënësve dhe është i dashur për to;

3. Drejtësia - mësuesi është i aftë të dallojë të vërtetën dhe të gjykojë drejtë ashtu siç duhet me nxënësit, ti shmang padrejtësitë dhe veprimet e dëmshme, mos të jetë i anshëm;

4. Dashuria - veprimet e drejta janë faktor që tregojnë se ai është i dashur për nxënësit, mençuria dhe drejtësia e tregojnë dashurinë e tij ndaj nxënësve dhe

5. Frymëzimi - në udhëkryqet e nxënësve ato ti motivoj, ti udhëzojë dhe ti ndihmoje. Nëse duhet ta ndjejnë privilegjin se janë të kuptueshëm dhe se mësuesi iu qaset me kuptim e frymëzim.

Pa këto cilësi vështirë është që mësuesi të edukoj dhe arsimoj. Këto pesë veti e vënë në dukje faktin se mësuesi është gjithmonë i aftë të shpërndajë magji, të ngrohë shpirtin e të ndezë një dritë gëzimi e shprese te nxënësit. Qëndrimi i mirë mësues-nxënës është gjysma e suksesit. Mësuesi me fuqinë e tij të madhe, në radhë të parë intelektuale dhe edukative bën që nxënësit të orientohen drejtë mirësisë. Për më tepër mësuesi e përdorë fuqinë e tij për të mirën e nxënësit si individ në rritje dhe formim. Me fuqinë e tij mësuesi u jep fuqi nxënësve që të përballojnë me sukses sfidat e mësimit, vështirësitë dhe të qëndrojnë përballë pengesave që paraqiten në zhvillimin e tyre.

Ka plot arsye të rëndësishme pse mësuesi duhet ta njohe mire nxënësin e të krijoj raporte miqësore me të. Të gjithë mësuesit e dine se çfarë do të thotë kujdesi ndaj nxënësit, por ajo çfarë e veçon mësuesin është organizimi i edukimit proaktiv dhe mësimdhënies interaktive ku nxënësi është subjekt në proces. Kjo është rëndësia që i jep kujdesit ndaj nxënësit. Të gjithë hapat që duhet ndjekur para se të fillon punë me nxënës janë: të flas me to, ti dëgjojë ato, ta drejtoj dhe orientoj veprimin e tyre dhe ta ndjek zhvillimin e tyre. Mbase të jesh mësues/edukator është të arrish atë që jo të gjithë munden.

Fillimisht që ta njohësh nxënësin duhet të krijosh, mësuesi duhet ta prezantoj personalitetin e tij. Të krijosh bindjen se nxënësit duhet të besojnë te mësuesi, se mësuesi nuk është gjykatës, se mësuesi nuk i ndëshkon nxënësit, se mësuesi nuk është keqbërës, ai nuk është i rreptë, gjithnjë është i fjalës, është i matur, është falës, pavarësisht se çfarë bëjnë nxënësit. Pra mësuesi nuk është larg jetës së nxënësit, ai nuk është personalitet kontradiktor, por personalitet që afron nxënësit rreth qëllimit themelor: nxënësit ti mëson, ti edukoj dhe ato të bëhen njerëz të vyeshëm të shoqërisë e të kombit. Thjesht, nxënësi duhet të zbuloj ç'të mira e presin atë nga puna e mësuesit.

Parimet e pedagogjisë dhe synimet e saj janë se nxënësit duhet të edukohen me dinjitet njerëzor jo vetëm pse ato e meritojnë atë, por edhe sepse me respektin ndaj tij ai mësohet, edukohet dhe rritet më mirë. Në fakt, mësuesi për të arritur qëllimet e edukimit udhëhiqet nga mësimet e pedagogjisë që bazohen në parimet madhore të saj. Titulli apo emri mësues ka rëndësi për vetë mësuesin, por ai rëndësinë e forcon në sytë e nxënësit. Prandaj në vitet e para të shkollimit emri mësues konsiderohet si mbrojtje dhe shpëtim, tek ai shkojnë nxënësit për të kërkuar dituri. Kjo vlen për gjithë popujt. Historia e pedagogjisë na mëson se emri mësues është i përbashkët. Emri unik i mësuesit identifikohet me njeri që hedh dritë diturie. Mësuesi ka aftësi të shkaktoj etje për dituri dhe ta trajtoj nxënësin si personalitet që duhet të thith diturinë. Ai bën çfarëdo që është e nevojshme për ta mësuar dhe edukuar nxënësin dhe për të përmbushur objektivat pedagogjike. Këtë e bën me pozitën, autoritetin dhe fuqinë që ka.

Emri mësues tregon se nxënësit e kanë në zemër. Domethënia e emrit mësues lidhet me faktin se nënkupton se ai interesohet gjithmonë për nxënësin, edukimin dhe zhvillimin e tij të mirëfilltë. Puna e mësuesit është punë e entuziazmuar dhe me ndryshime të herëpashershme, por me të njëjtin përkushtim dhe dashuri ndaj nxënësve dhe suksesin e tyre. Kjo mbase puna e mësuesit nuk është rrugëtim i zbrazët.

PËRFUNDIM. Pavarësisht sfidave të cilat hasen në profesionin e mësuesisë/edukimit i kështilloj ata që janë përcaktuar të aftësohen për mësues/edukator, të provojnë dhe të sfidohen për rolin profesional duke mos u frikësuar nga gabimet që mund të ndodhin. Për të vlerësuar punën e mësuesit, gjërat e shumta që ai ka bërë e që bën sjellin dobi sot e nesër, madje edhe në të ardhmen. Në fakt, planet dhe ëndrrat e mësuesit domosdo duhet të kenë arsye personale dhe profesionale, përndryshe nuk arrin qëllimet e edukimit.

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

Koha Sport
Koha, e hënë, 1 prill 2019

BERISHA RIKTHEHET NË KAMPIONATIN NORVEGJEZ

Sulmuesi nga Kosova, Veton Berisha është rikthyer në kampionatin norvegjez. Pas katër viteve të kaluara në Gjermani dhe Austri, Berisha ka nënshkruar për ekipin norvegjez në ditën e fundit të afatit kalimtar në shtetin skandinav. Aventura te Rapidi i Vjenës nuk shkoi mirë, pasi lojtari nuk ishte në formacionin bazë të gjigantit austriak. Kjo ka bërë që vëllai i vogël i Valon Berishës të marrë vendimin për tu rikthyer në shtetin skandinav. 24-vjeçari ka nënshkruar kontratë tri vjeçare me nën kampionët e Norvegjisë, Brann ku do të ketë mundësi më të mira të aktivizimit. Kujtojmë që Berisha është pjesë e Kombëtares së Norvegjisë, por që në muajt e fundit nuk ka pasur ftesë për të. Me Rapidin e Vjenës, Vetoni ka luajtur 58 ndeshje në të gjitha garat duke shënuar nëntë gola dhe duke bërë tre asistime.

LIGA E DYTË - JAVA E18

"Struga Trim Lum" gjen fitoren

Shkup, 31 mars - Lideri i tabelës në Ligën e Dytë-Perëndim, Struga Trim Lum ka gjetur fitoren e parë në sezonin pranveror, duku fituar 2:0 në terrenin e Genç Kalemler. Për ekipin strugan golat u shënuan nga Florent Osmani në minutën e 20 dhe atë të 85. Pas kësaj fitore Struga Trim Lum ruan vendin e parë në tabelë me 34 pikë të tubuara. Në takimet tjera, Teteksi ka pësuar humbjen e parë në sezonin pranveror, ku u mundën nga Skopje me rezultatin 3:1. Në derbin shqiptar ekipi i Gostivarit ka arritur të mposhtë Labunishtin në fushën e vetë me rezultatin minimal 1:0. Golin për skuadrën e Gostivarit e shënoi Ilber Alili në minutën e 75 të përballjes. Ndërkaq, ekipi i Korabit ka barazuar pa gola me Pelisterin. Po ashtu gjatë ditës së shtunë janë luajtur edhe takimet e Ligës së Dytë-Lindje, ku ekipi i Tikveshit me rezultatin e thellë 3:0 ka mposhtur liderin e tabelës Borecin. Ekipi i Bregallnicës ka fituar 2:1 ndaj ekipit të Kamenica Sasa. Ndryshe me rezultatin e barabartë 0:0 kanë përfunduar tre takimet Detonit Xhunior - Partizan Obrshani, Kit Go – Kozhuv dhe Vardar Negotinë – Plaçkovica. Me zhvillimin e ndeshjeve të javës së 18 në Ligën e Dytë Perëndim dhe Lindje, ka përfunduar pjesa e rregullt e sezonit. Ndërsa nga java tjetër do të nis rethi të tretë, apo ndryshe i njohur si sistemi i Bergerit. *(F.N)*

"Çdo futbollistë shqiptarë ëndërron të luaj për Shqipërinë, edhe un besoj se me ndihmën e zotit, por edhe me përkrahjen e klubit një ditë do t'ia dal të luaj për Kombëtaren Shqiptare", ka deklaruar Asani

ASANI: SHPRESOJ TË LUAJ PËR SHQIPËRINË

Sulmuesi shkupjan Jasir Asani që aktivizohet te Partizanit i Tiranës ishte njeriu i ndeshjes në ndeshjen e ndaj Kukësit, që u mbyll në barazim 1-1 të shtunën në "Loro Boriçi". Asani në këtë përballje fitoi penalltinë dhe e shndërroi në gol përballë, ndërsa u bë protagonist edhe me festimin, duke drejtuar një gisht nga tribuna qendrore e stadiumit. Shkupjani po ashtu ka theksuar se një ditë dëshiron të jetë pjesë e kombëtares së Shqipërisë. Për të diskutuar për formën e tij të mirë, rrugën e Partizanit drejt titullit, por edhe "sekretet" e të kuqve, Asani ishte i ftuar nëpërmjet një lidhjeje direkte me emisionin "Zona Gol" në Supersport.

Cili ishte emocioni i parë që keni ndjerë, kur u afruat te Partizani?

Kur erdha këtu, skuadra ishte në vendin e 5-6 dhe që në fillim mendova se duhet të luftojmë për vendin e parë, për titullin kampion. Jemi si një familje dhe presidenti na jep shumë besim, për të përballuar mirë çdo ndeshje dhe për të marrë më të mirën.

E keni nisur karrierën me Vardarin. Ishe ti që kërkove Partizanin, apo "të kuqtë" të kërkuan me ngulm ty?

Kur isha te Vardari, kisha ofertë nga Partizani, por edhe skuadra të tjera, megjithatë pas bisedave me familjen, vendosa të vij këtu. Partizani është një skuadër mjaft e mirë, që ka tifozë në të gjithë Shqipërinë, ndaj doja të vija këtu.

Cila është diferenca mes Partizanit të këtij viti dhe atij të sezonit të kaluar?

Cilësinë e kishim edhe sezonin e kaluar, por këtë vit ne jemi të gjithë si një familje dhe çdo gjë e bëjmë bashkë. Besoj se ky është edhe ndryshimi nga viti i kaluar.

Kush mendoni se është skuadra më e mirë, Kukësi apo Partizani?

Atë e tregon renditja në fakt. Mund të them se pas ndeshjes në Shkodër, ne ishim të mërzitur, sepse kishim mundësinë të fitonim. Unë personalisht kisha mundësi të shënoja edhe golin e dytë, ndaj u mërzita.

Partizani ka një marrëdhënie mjaft të mirë me futbollistët shqiptarë nga Maqedonia...

Maqedonia ka nxjerrë gjithmonë lojtarë të mirë dhe të talentuar, ndaj besoj se edhe te Partizani e dinë këtë. Te Laçi është Najdenov, një nga më të mirët, por edhe Cuculi te Kukësi.

Me Cuculin keni luajtur edhe në Maqedoni, në sfidën Vardar-Shkëndija...

Po, kam luajtur dhe kam dalë gjithmonë fitues.

Te Vardari ke luajtur me futbollistë të mëdhenj, por që nuk ishin shqiptarë...

Ka pasur emra të shumtë si Ibriçiç, të cilët më kanë ndihmuar shumë.

Duket se ju ka ndihmuar shumë kjo eksperiencë te Vardari?

Patjetër. Te Partizani erdha që në fillim me qëllimin për të bërë mirë dhe për të ndihmuar skuadrën të synojë titullin kampion.

Si ishte të ishe shqiptar te Vardari?

Isha i vetmi shqiptar, por kam ndenjur shumë vite atje dhe të gjithë më kanë trajtuar mirë, ndaj i respektoj gjithmonë.

Bashkë me Bardhin dhe Malën, duket se keni krijuar një treshe simpatike edhe jashtë fushe...

Siç e thashë, ne jemi si një familje. Edhe presidenti, por i gjithë klubi, na nxisin të krijojmë një harmoni shumë të mirë si në fushë, ashtu edhe jashtë saj.

Sa përqind të rëndësisë ka stafi teknik në një sukses?

Stafi teknik ka qenë pranë nesh gjatë gjithë kohës dhe të paktën neve në sulm na ka dhënë shumë liri dhe na ka qëndruar pranë si në momentet e mira, ashtu edhe në ato të vështira.

Ndaj Kukësit shkuat për një pikë?

Ne shkojmë në çdo ndeshje për 3 pikë. Mendoj se ne jemi ekipi më i mirë në Superiore dhe Kukësi pati fat në pjesën e dytë, ndaj nuk morëm dot fitoren, por në çdo takim do të kërkojmë maksimumin.

Fakti që shënoni të gjithë, mendoni se është një arsye më shumë për të rritur harmoninë?

Te Partizani nuk ka xhelozi dhe nuk shikojmë kush shënon. Ne kemi interesat e skuadrës primare dhe mendojmë të bëjmë më të mirën për fanellën.

A keni pasur ofertë nga kombëtarja maqedonase?

Kam pasur ofertë, por nuk kam pranuar sepse çdo shqiptar ëndërron të luajë për Shqipërinë.

E mendoni të afërt ditën kur të luani për Shqipërinë?

Shpresoj se po. Me ndihmën e zotit, por edhe me përkrahjen e klubit, unë besoj se një ditë do t'ia dal të luaj për Kombëtaren Shqiptare.

FUTSAL

Shkupi siguron titullin kampion

Shkup, 31 mars - Gjatë ditës së shtunë skuadra e Shkupit ka arritur që të siguron titullin e dytë në Ligën e Parë të Maqedonisë në futsall. Ekipi nga Çairi ka arritur që të merr fitore në terren mysafire duke e mundur rivalin kryesor për titullin, Velesin me rezultatin 4:3. Deri në përfundim të kampionatit kanë mbetur të zhvillohen edhe katër takime, mirëpo Futsal Shkupi tani pas fitores ka 12 pikë më shumë se ekipi i Velesit, ndaj së cilës skuadër është kundërshtarë më i mirë edhe në përballjet direkte. Kështu që Futsall Shkupit me plotë meritë ka festuar fitoren e 22 nga gjithsej 23 përballje këtë edicion në Ligën e Parë të Futsalit. Golat për skuadrën e Shkupit u shënuan nga Rexhep Sulejmani dhe Berat Ramadani të cilët tundën rrjetën e kundërshtari nga dy herë. Pjesa e parë u mbyll me rezultatin 1:3 në favor të Futsal Shkupit, që në këtë mënyrë paralajmëroi fitoren e madhe të këtij takimi, që ishte e 5 në ndeshjet e "plej-of" nga po aq ndeshje të zhvilluara. Pas 23 javëve të zhvilluara ekipi i Futsal Shkupi ka tubuar 66 pikë, duke lënë pas vetes Velesin me 54 pikë. (F.N)

ZIDANE: MË PËLQEN SHUMË POGBA

"Më pëlqen shumë Pogba, kjo nuk është diçka e re. E njoh personalisht, ai është lojtar ndryshe nga të tjerët, kontribuon shumë. Të paktë janë ata që kontribuojnë sikur Pogba. Ai e di si të sulmojë, si të mbrojë. E di çfarë duhet të bëjë në fushë", ka deklaruar Zidane

Zinedine Zidane e ka pranuar se i pëlqen mesfushori i Manchester United, Paul Pogba. Në konferencë për media, Zidane u vërshua me pyetje për lojtarët që lidhen me një kalim të mundshëm në "Santiago Bernabeu". Në mesin e shumë emrave që u përmenden, ishte edhe ai i Paul Pogbas, për të cilin, Zidane haptazi ka shprehur dëshirën për ta pasur në skuadër. "Më pëlqen shumë Pogba, kjo nuk është diçka e re. E njoh personalisht, ai është lojtar ndryshe nga të tjerët, kontribuon shumë. Të paktë janë ata që kontribuojnë sikur Pogba. Ai e di si të sulmojë, si të mbrojë. E di çfarë duhet të bëjë në fushë. Ai nuk është pjesë e skuadrës sime, ai luan për Unitedin dhe atë që ai ka thënë për Madridin dhe dëshirën e tij për të ardhur nëse një ditë ka mundësi kur ai të largohet nga United. Pas përvojës në United, përse të mos vijë në Real Madrid?", shtoi Zizu. Zinedine Zidane, në njëfarë mënyre, e ka pranuar se me çfarëdo çmimi që blihet Kylian Mbappe, mund të jetë çmim real duke parë tregun e sotëm. Mbappe, 20-vjeçar, raportohet se është objektivi numër një i Real Madridi për sezonin 2019/20, edhe pse do të jetë e vështirë për t'ia rrëmbyer Paris Saint Germainit. Sipas mediave spanjolle, nëse Reali e do Mbappen, duhet të derdhë deri në 280 milionë euro në arkat e klubit francez, shifër që për tregun e sotëm në botën futbollit – duket se është normale edhe për Zidanen. "A vlen Mbappe 280 milionë euro? Nuk mund të themi se nuk vlen 100 milionë, 150 apo 300... kjo është ajo që klubet po bëjnë tani", u përgjigj Zidane. "Kur unë arrita në Madrid për 72 milionë u tha se ishte çmenduri. Shikoni tani ku jemi. E di se çfarë lojtari është (Mbappe), por nuk është i imi. Nuk do të flas për respekt ndaj PSG-së, klubit tonë dhe lojtarëve të mi", shtoi mes tjerash Zizu. Zinedine Zidane ka thënë se e ardhmja e Gareth Bale në Real Madrid do të vendosët në përfundim të këtij sezoni. Zidane nuk ka ofruar asnjë garanci se Bale do të mbetet në Madrid, por theksoi se me gjasë ai do ta luajë rol kyç në dhjetë ndeshjet e fundit të klubit këtë sezon. "Gareth është pjesëtar i rëndësishëm i skuadrës", tha Zidane. "Ne e dimë çfarë ka bërë ai këtu, madje edhe në finale të Ligës së Kampionëve. Askush nuk mund t'ia marrë atë që e ka bërë ai. Ne e dimë që ai mund t'i sjellë shumë skuadrës dhe do të llogarisim në të. Do t'i luajmë këto 10 ndeshje dhe më pas shohim", theksoi francezi.

Zanetti zbulon nëse Mourinho do të kthehet te zikaltërtit

Zëvendëspresidenti i Interit, Javier Zanetti, ka thënë se thashethemet për kthimin e Jose Mourinhos në stolin zikaltër janë mungesë respekti ndaj trajnerit aktual Luciano Spallettit. Zanetti ishte në Londër të shtunën për një ndeshje bamirësie në stadiumin e ri të Tottenhamit, ku Inter Forever i mposhti Spurs Legends 5:4. Prezent ishte edhe fituesi i tripletës me Interit, Mourinho, i cili mezi pret t'i rikthehet punës së trajnerit nga sezoni e ardhshëm, pasi u shkarkua në dhjetor nga Manchester Unitedi. "Ne gjithmonë e shohim Mourinhon me dashuri të madhe, sepse kemi përjetuar momente të paharrueshme me të", tha Zanetti për Sky Sport Italia. "Ai erdhi për të na përshëndetur dhe ishim të kënaqur. Dua të nënvizoj se ai nuk ishte trajner i Inter Forever, sepse ai ishte Francesco Toldo, pra Mourinho ishte thjesht vizitor", shtoi ai. I pyetur nëse Mourinho do të kthehej në Inter, Zanettit nuk i pëlqeu aspak pyetja. "Ky është mos respekt ndaj Luciano Spallettit, i cili është duke u përgatitur për një ndeshje shumë të rëndësishme kundër Lazios", theksoi ish-kapiteni zikaltër.

Interi synon transferimin e Sidibes

Interi nuk do ta blejë mbrojtësin kroat Sime Vrsaljko nga Atletico Madridi. Mbrojtësi kroat është i huazuar te zikaltërtit nga klubi spanjoll, por problemet me lëndimet kanë bërë që Interi të marrë vendim mos ta blejë atë. Neroazzurët tani kanë objektiv për krahun e djathtë të mbrojtjes francezin Djibril Sidibe. 26-vjeçari ka paralajmëruar largimin nga Monaco pasi dëshiron një skuadër më të madhe në karrierë. Sidibe është nën kontratë me Monacon deri në qershor të vitit 2022, por që mund të largohet për 25 milionë euro. Për lojtarin interesim ka shfaqur edhe Atletico Madrid, Arsenal dhe Tottenham Hotspur.

Leonardo: Gattuso ka mbështetjen tonë

Drejtori i Milanit, Leonardo ka thënë se asnjëherë nuk e kanë menduar shkarkimin e Gennaro Gattuso, duke këmbëngulur se dy muaj janë të gjatë për përcaktimin e kampionatit dhe se e ardhja e tij nuk është prioritet. Braziliani Leonardo foli për media pas humbjes 1:0 të Milanit ndaj Sampdorias, e cila është humbja e dytë radhazi në Serie A. "Duhet të piqemi dhe të merremi me këtë moment të vështirë, ta tejkalojmë atë dhe ta arrijmë synimin tonë; kualifikimin në Ligën e Kampionëve", tha Leonardo për Sky Sport Italia. Gattuso i bëri disa komente gjatë konferencës për media pas lojës, duke habitur shumë persona kur tha se do ta thoshte atë që e mendon pas dy muajve, kur të mbaron sezoni. "Gattuso ka kontratë me Milanin, të cilën ne kurrë nuk e diskutojmë. Gjithmonë kemi qenë të qartë. E ardhmja e tij nuk është prioritet dhe u befasova kur gazetarët e pyeten për të", këmbënguli Leonardo./

Juventusi po përgatit sulmuesin e së ardhmes

Mund të konsiderohet edhe çështje fati por njeriu i momentit në shtëpinë e Juventusit pa dyshim është Moise Kean. Është vetëm 19 vjeç dhe, gradualisht, po tregon një potencial të jashtëzakonshëm. Shënoi në ndeshjen debutuese me fanellën e Kombëtares së Italisë, gjithashtu edhe me bardhezinjtë. Ndoshta është herët, por me atë që po tregon Kean meriton fanellën e titullarit. Allegri kërkon që të mbajë me këmbë në tokë sulmuesin, por numrat flasin në favor të tij. Tre gola në Serinë A, i fundit ndaj Empolit, dhe për të gjetur rrugën e rrjetës i mjaftuan vetëm 2 minuta e 30 sekonda. Fakti që Juventusi kryeson kampionatin me një distancë prej 18 pikësh nga Napoli i vendit të dytë e favorizon lojtarin, pasi minutat në dispozicion pritet të jenë të shumta për të, edhe pse titullarë fiks, duket pak e vështirë. Kean deri tani nuk ka patur asgjë kundër vendimeve të Allegrit, duke i mirëpritur ato dhe duke i cilësuar si të duhurat. Asnjë kërkesë nga ana e sulmuesit dhe siguristh që drejtuesit e "Zonjës së Vjetër" do ta mendojnë seriozisht për t'u mbështetur tek Kean në të ardhmen. I fortë fizikisht, teknik por edhe i përgjegjshëm. Elementët bazë për t'u shndërruar në një lojtarë kyç për ekipin. Sa i përket rinovimit të kontratës, situata duket e favorshme, madje firma është thjesht çështje formale.

GNABRY, PASARDHËSI NATYRAL I LEWANDOWSKIT DHE KLOSES

Te Bayerni po shqetësohen për të gjetur një pasardhës të polakut Robert Lewandowski, derisa te Gjermania ende janë në kërkim të një lojtari që do të zëvendësonte Miroslav Klosen. Mirëpo, duket se përgjigja për të dyja ekipet është Serge Gnabry

Bayern Muencheni dhe Përfaqësuesja e Gjermanisë, janë të bashkuar nga problemi i njëjtë: si të zëvendësohet një sulmues që shënon pothuajse në çdo ndeshje? Te Bayerni po shqetësohen për të gjetur një pasardhës të polakut Robert Lewandowski, derisa te Gjermania ende janë në kërkim të një lojtari që do të zëvendësonte Miroslav Klosen. Mirëpo, duket se përgjigja për të dyja ekipet është Serge Gnabry. Te Gjermania ka pasur shumë lojtarë që kanë ardhur dhe kanë shkuar me shpresën se do ta zëvendësonin Klosen, por duket se trashëgimia e tij ka një vlerë shumë të madhe. Ish-sulmuesi i Werder Bremenit dhe Bayernit ka pasur një karrierë të jashtëzakonshme te Gjermania, duke vendosur rekord me 71 gola të shënuar. Ai gjithashtu ka ndihmuar Gjermaninë të fitojë edhe titullin e botës në vitin 2014 përpara se të tërhiqej nga futbolli aktiv. Klose ka luajtur për Gjermaninë prej vitit 2001 deri në vitin 2014, duke regjistruar 137 ndeshje. Klose te Gjermania e nisi në mënyrë modeste, duke shënuar dy gola në gjashtë ndeshjet e para. Ndërsa, Gnabry ka befasuar të gjithë te Gjermania, pasi në gjashtë ndeshjet e para, ka realizuar gjashtë herë.

"Nuk kam pritur një start të tillë. Mund të them se edhe vetë jam i befasuar me këtë start fantastik", shprehet Gnabry 23-vjeçar. Timo Werner për një kohë të gjatë është konsideruar si pasardhës natyral i Kloses te Gjermania, por numri nëntë i ekipit RB Leipzig është kapërcyer në nivelin ndërkombëtar nga Gnabry. Ky i fundit i ka dhënë një arsye të fortë përzgjedhësit Joachim Loew që të ketë besim tek ai se është njeriu i duhur për të shënuar gola dhe për të qenë titullar. Në të vërtetë, Gnabry e Werner te Gjermania po luftojnë për të njëjtën pozitë. Por, për dallim prej Wernerit, Gnabry mund të luajë si qendërsulmues dhe sulmues i krahut.



Solskjaer rikthen në United Zahan

Me fanellën e Manchester United ka luajtur vetëm 2 ndeshje, kur ishte ende 18 vjeç, por tani mund ta veshë sërish fanellën e "djajve". Ky është sulmuesi nga Bregu i Fildishtë, Wilfried Zaha, që luan në Premier League me ekipin e Crystal Palace. Sipas të përditshmes britanike "Daily Mail", sulmuesi 26-vjeçar është sërish në radarët e Manchester United. Mësohet se United ka një klauzolë në kontratën me të cilën ka shitur lojtarin në vitin 2015 te Palace. United ka të drejtën të riblejë lojtarin me 25% ulje në çmim, çka do ta favorizonte skuadrën e trajnerit Solskjaer. Këtë sezon, Zaha ka realizuar 8 gola dhe 5 asist në 26 ndeshje me Palace në Premier League, duke qenë një nga lojtarët më të mirë. Mësohet se trajneri Ole Gunnar Solskjaer kërkon ta rikthejë në origjinë lojtarin, që mund të luajë si anësor në skemat e tij. Një sulmues që i përshtatet më së miri taktikës së lojës së trajnerit norvegjez, që nis të hedhë hapat e parë për të ndërtuar ekipin e sezonit të ardhshëm.

Sarri: Ky është problemi më i madh për Higuain

Trajneri Maurizio Sarri priste më shumë nga sulmuesi argjentinas Gonzalo Higuain, që erdhi te Chelsea me shumë bujë në merkaton e janarit. Gjithsesi, sipas trajnerit italian lojtari ende nuk po ambientohet me Premier League dhe kjo është pengesa e tij më e madhe. Në 10 ndeshje me "blues", sulmuesi 31-vjeçar ka realizuar vetëm 3 gola. "Higuain më ka thënë se për të është pak e vështirë ambientimi me Premier League.

Këtu ka një lojë të fortë fizike dhe për të nuk është e lehtë të krijojë shumë raste për të shënuar. Këtu gjyqtarët janë shumë ndryshe nga në Itali. Për të ky është një futboll krejt tjetër. Për një sulmues dhe një portier ky realitet është krejt ndryshe", tha Sarri. "Unë e kuptoj që Gonzalo ka nevojë për më shumë kohë, por për fat të keq ne nuk kemi shumë të tillë. Ndaj në dy muajt e fundit ai duhet të jetë në formën e tij më të mirë. E ardhmja e tij? Unë nuk e di. Gjithçka varet nga ai. Nëse arrin të tregojë atë që unë e kam parë të realizojë te Napoli mund të qëndrojë. Për ne është shumë i rëndësishëm", tha Sarri.

Publicitet

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 nga Rregullorja për mënyrën e realizimit të ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lira për nxënësit e shkollave fillore nr. 07-2250/1 të datës 05.06.2014 nga MASH, SHFK "Jashar Bej Shkupi" Çair - Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE
për grumbullim të ofertave

SHFK "Jashar Bej Shkupi" Shkup-Çair rr.124 Dyqangjik pn - Shkup, organizon ekskursione dhe aktivitete tjera të lira për nxënësit e vitit shkollor 2018/2019, sipas Programit për ekskursione për aktivitetet në vijim:

1.1. Ekskursion dyditor për klasën e gjashtë
Ekskursion dyditor
Vendi i realizimit: Shkup - Strugë - Shkup;
Klasa: nga klasa e VI-të;
1.2. Ekskursion treditor për klasën e nëntë
Ekskursion treditor
Vendi i realizimit: Shkup - Strugë - Shkup;
Klasa: nga klasa e IX-të;
1.3. Mësim në natyrë - tre ditë për nxënësit e klasës së V-të
Vendi i realizimit: Shkup - Strugë - Shkup;

Kushtet minimale të cilat duhet ti plotësojë ofertuesi janë:
- të jetë i regjistruar sipas dispozitave pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerjen e veprimtarisë turistike përkatëse;
- të ketë realizuar me sukses së paku 3 ekskursione të nxënësve dhe aktivitete tjera të lira në 3 vitet e fundit;
- t`i plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve sipas Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor dhe Rregullores për kërkesat e veçanta teknike për makinat me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.
- Oferta e ofertuesit i cili nuk i plotëson kushtet minimale do të refuzohet nga ana e Komisionit si e papranueshme.

Dokumentet të cilat duhet t`i parashtrojë ofertuesi:
- Dokument nga Regjistri qendror për veprimtari të regjistruar -DRD formular, licencë për kryerje të veprimtarisë turistike,
- kopje nga marrëveshja dhe vërtetim për së paku tre ekskursione të nxënësve të realizuara me sukses dhe aktivitete tjera të lira në tre vitet e fundit, për çdo ekskursion të realizuar veç e veç,
- deklaratë që i plotëson kushtet për transport të grupeve të fëmijëve, sipas Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor dhe Rregullores për kërkesat e veçanta teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.

Në ditën e lidhjes së marrëveshjes ofertuesi i përzgjedhur parashtron garanci bankare për realizim kualitativ të ekskursionit dhe aktiviteteve tjera të lira në shumë prej 5% nga vlera e përgjithshme e marrëveshjes.

Ftohen ofertuesit e interesuar të parashtrojnë oferta sipas dokumentacionit i cili mund të merret në shkollën deri më 05.04.2019 çdo ditë pune nga ora 8,00 - 14,00 te sekretari i shkollës.
Tel. për kontakt: 3220 677
e-meil: shf_jasharbejshkupi@yahoo.com

SHPALLJE

1. Për pranim të punëtorëve për kohë të caktuar, për kryerjen e punëve urgjente dhe paanulueshme:

1. PRERËS - 4 (katër) realizues për periudhën prej më së shumti 9 muaj
2. NGARKUES – 4 (katër) realizues për periudhën prej më së shumti 9 muaj
3. PAGUES TË BILETAVE TË HYRJES - 6 (gjashtë) realizues për periudhën prej më së shumti 9 muaj

1.1. Kandidatët për pikën 1 dhe 2 duhet t`i plotësojnë kushtet në vijim:
- Për vendin e punës p.1 prerës të posedojnë sharra me motor për prerje të druve për ngrohje;
- Për vendin e punës p.2 furnizues të posedojnë kafshë për ngarkim të druve për ngrohje.

1.2. Kandidatët për pikën 3 duhet t`i plotësojnë kushtet në vijim:
- Të kenë të mbaruar arsimin e mesëm.

Kandidatët e interesuar duhet t`i parashtrojnë dokumentet e poshtëpërmendura NË AFAT PREJ 3 (tre) DITËVE nga publikimi i shpalljes.
Për pikën 1:
- Fletëparaqitje
- Deklaratë për p.1 që posedojnë sharrë me motor, gjegjësisht për p.2 kafshë për ngarkim.
Për pikën 2:
- Fletëparaqitje
- Dëshmi për arsim të mbaruar
Në adresën: IP Parku nacional Galiçica, rruga Velestovski pat pn Ohër
Vërejtje: marrëdhënia e punës lidhet për kohë të caktuar me neto pagesë prej 13.250,00 (trembëdhjetë mijë e dyqindepesëdhjetë denarë).

Drejtor
Vasko Paskali

URGJENTISHT
Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo+Pr+1+Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

NBA

HARDENI I NJË PLANETI TJETËR, "TRIPLE-DOUBLE" I PESTË MË TË PAKTËN 50 PIKË

James Harden arriti të regjistronte "triple-double" e pestë në karrierë me të paktën 50 pikë të shënuara në suksesin 119-108 ndaj Sacramento Kings, që tashmë edhe matematikisht nuk kanë asnjë mundësi për të arritur zonën play off

James Harden nuk mund të jetë kurrsesi një basketbollist normal. "Ylli" i Houston Rockets arriti të regjistronte "triple-double" e pestë në karrierë me të paktën 50 pikë të shënuara në suksesin 119-108 ndaj Sacramento Kings, që tashmë edhe matematikisht nuk kanë asnjë mundësi për të arritur zonën play off. Statistikat e "Mjekroshit" më të famshëm të NBA-së në këtë përballje ishin të frikshme: 50 pikë, 10 asite dhe 11 topa të kontrolluar poshtë koshit. Suksesi i Rockets mori më shumë vlerë edhe nga humbja e Portland Trail Blazers (rrëshqasin në vendin e katërt në Perëndim) 99-90 në parketin e Detroit Pistons, falë paraqitjes mbresëlënëse të Reggie Jackson, që realizoi 28 pikë, pa harruar dhe

22 pikët e plot 19 "rebound" të Andre Drummond, që zhvlerësuan 23 pikët e Damian Lillard. E ndërsa në Konferencën e Perëndimit janë përcaktuar 8 skuadrat që do të marrin pjesë në play off, në Lindje gara vazhdon të jetë e ashpër, pasi ende nuk janë zyrtarizuar emrat e tri skuadrave të fundit që do të vijojnë garën përtej sezonit të rregullt. Suksesit të Detroit Pistons iu kundërpërgjigjën Brooklyn Nets, që iu imponuan 110-96 Boston Cetlics. Spikati në radhët e Nets D'Angelo Russell me 20 pikë e 10 "rebound". Fitore edhe për Miami Heat në parketin e New York Nicks 92-100, falë formës së shfaqur nga Dion Waiters, që e mbylli takimin me 28 pikë. Nga humbja e Celtic nuk përfituan Indiana Pacers, që u dorëzuan 116-121 para publikut të tyre përballë Orlando Magic. Për miqtë plot 7 basketbollistë shënuar numër dyshifror pikësh, por më i miri ishte pa dyshim Aaron Gordon me 23 pikë dhe 10 "rebound". Për Indianën morën vetëm vlerë statistikore 24 pikët e Darren Collison.

Ylli i NBA-së akuzohet për përdhunim

Basketbollisti letonez Kristaps Porzingis, që aktualisht është i dëmtuar por që nga shkurti i këtij vitit ka firmosur me skuadrën e Dallas Mavericks, është akuzuar për dhunë seksuale. Lajmin e ka konfirmuar "New York Post", që saktëson se ngjarja ka ndodhur në shkurt të vitit 2018, kur lojtari 23-vjeçar luante me New York. Viktima është një ishkomshie e lojtarit, e cila fillimisht nuk e ka denoncuar basketbollistin, pasi kishte negociuar që të paguhej 68 mijë dollarë për të mos folur. Avokati i Porzingis tha: "Ne jemi në dijeni të akuzave, por i hedhim poshtë ato". Porzingis nuk luan që prej shkurtit 2018, për shkak të një dëmtimi të rëndë në gju. Sipas mediave amerikane, ngjarja ka ndodhur pak kohë para se lojtari të dëmtohej. Ai ka ftuar komshien e tij për të pirë një gotë në apartamentin e tij nju-jorkez. Sipas akuzës, basketbollisti ka ushtruar dhunë ndaj vajzës, duke e detyruar të kryejnë marrëdhënie seksuale. Vajza, që është moshatare me lojtarin, i është drejtuar policisë për këtë ngjarje dhe ka pranuar se fillimisht ka negociuar që të paguhej për të heshtur. Për momentin, policia e Nju Jorkut nuk ka dhënë asnjë deklaratë, ashtu sikurse edhe skuadra e Dallas Mavericks, me të cilën lojtari ende nuk ka luajtur asnjë ndeshje zyrtare.

Federer në finalen e Majemit, synon të kalojë kuotën 100

Tenisti zviceran Roger Federer dhe ai amerikan John Isner janë dy finalistët e turneut Masters të Majemi, të kualifikuara pas dy ndeshjeve gjysmëfinale të luajtura. Federer mposhti 2-0 (6-2, 6-4) kanadezin Denis Shapovalov, ndeshje e dominuar nga zvicerani, aktualisht numri 5 në botë për meshkuj. Federer e ka fituar 3 herë këtë turne dhe në gjysmëfinale bëri një ndeshje të mirë, pavarësisht moshës 37-vjeçare. Në finale, përballë zviceranit do të jetë kampioni në fuqi, amerikani John Isner, që në gjysmëfinalen tjetër mposhti 2-0 (7-6, 7-6) kanadezin Felix Auger Aliassime. Për femra, ndeshja finale e këtij turneu do të luhet mes çekes Karolina Pliskova, numrit 7 në botë dhe australianes Ashleigh Barty, numri 11 në botë. Pliskova eliminoi në gjysmëfinale ish-numrin 1 në botë, rumunen Simona Halep dhe konsiderohet favorite.

Dana White zyrtarizon rikthimin e Khabib

Pavarësisht spekulimeve dhe deklaratës së Khabib Nurmagomedov se do të rikthehet sërish në kafaz në nëntor, presidenti i UFC-së, Dana White ka një tjetër mendim. Numri 1 i arteve marciale mikse ka bërë me dije sot se rusi do të rikthehet të duelojë dy muaj më herët nga parashikimi, në shtator. Nurmagomedov është i pezulluar nga Komisioni i Sportit në Nevada deri në fillim të qershorit, për incidentin që shkakoi bashkë me Conor McGregor në eventin UFC-229. Rusi është kampioni i botës në peshën e lehtë, titull të cilin e mbrojti pikërisht ndaj rivalit irlandez 6 muaj më parë. "Ai do të rikthehet sërish në kafaz në shtator. Ai është ende i pezulluar, ndërkohë që ka

thënë se nuk do të duelojë gjatë kohës që është Ramazani. Për pasojë, koha më e përshtatshme është shtatori", u shpreh Dana White për mediat amerikane. Nurmagomedov pritet të duelojë me fituesin që do të dalë nga përballja mes Max Holloway dhe Dustin Poirier. Ata do të duelojnë për titullin e përkohshëm dhe më pas fituesi do të duelojë me rusin. Mbetet për t'u parë nëse Nurmagomedov do të rikthehet në shtator apo në nëntor.

Një maratonë mbi liqenin e ngrirë

Akulli nisi të gjëmojë dhe të dridhet për fundi këmbëve. Askush nuk e kishte paralajmëruar Veronique Messinan për këtë. Messina, një terapiste franceze e të folurit që punon në Kamboxha, kishte ardhur në liqenin Baikal, larg në Siberi për të vrapuar maratonën në sipërfaqen e ngrirë. Ajo kishte kaluar mbi akull për një vrapim provë një ditë para garës. "Unë jam e frikësuar nga uji dhe mund të shohësh se po vrapon në ujë", thotë ajo. Ato dridhje nëpër akullin, siç njihet "Simfonia Baikal", ishin një befasi edhe më e keqe për të. "Ishte e tmerrshme", thotë Messina 40-vjeçare. "Akulli po dridhej. Unë po dridhesha. Sa herë që kërciste, vrapoja dy herë më shpejt". Maratonistët shpesh përdorin garat për të eksploruar botën dhe në çdo mars të vitit, Maratona e Akullt në Baikal mbledh një grup të vogël në liqenin e ngrirë, që është vend i Trashëgimisë Botërore i mbrojtur nga UNESCO- ja, si për ekzotizmin, bukurinë dhe paparashikueshmërinë, ashtu edhe për kushtet e vështira. I rrethuar nga malet e largëta të

mbuluara me borë, liqeni gjatë dimrit është fushë e gjerë e bardhë. Mikroklimat prodhojnë stuhi që sabotojnë parashikimet e motit. "Shkenca nuk mund të na ndihmojë ne", thotë Aleksey P. Nikiforov 58-vjeçar, themeluesi i garës, që u mbajt këtë vit më 2 mars.

Hapi i parë heqja e taksës, Kosova e Serbia të mbesin multietnike

Kryesuesi i Komitetit të Parlamentit Europian BE-Serbi , Eduard Kukan, gjatë një takimi me një delegacion të Kuvendit të Serbisë, tha se para anëtarësimit në Bashkimin Europian, Beogradi dhe Prishtina duhet të arrijnë marrëveshje juridikisht detyruese, gjithëpërfshirëse, me të cilën zgjidhen të gjitha problemet ekzistuese dhe se për këtë duhet të kontribuojnë të dy palët.

Hap i parë në këtë drejtim, siç është shprehur ai, duhet të jetë heqja e taksës nga Prishtina ndaj produkteve nga Serbia.

Kukan ka thënë se Serbia dhe Kosova duhet të mbesin multietnike dhe se çfarëdo që të jetë marrëveshja ajo mund të pranohet vetëm nëse për të janë pajtuar të dy palët, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe nëse merr parasysh stabilitetin e përgjithshëm në rajon. Kukan konsideron se një marrëveshje e tillë mund të arrihet, nëse për të ka vullnet politik.

Vuçiç bën rolin e viktimës: Shqiptarët duan të persekutojnë serbët!

Presidenti serb, Aleksandër Vuçiç vazhdon të bëjë viktimën për sa i përket çështjes së Kosovës. Vuçiç deklaroi se me shqiptarët e Kosovës, Serbia ka problem politik dhe komunikimi me ta është mjaft i vështirë. Sipas tij, shteti serb po përballet me njerëz të cilët nuk mund të diskutosh që mendojnë se çdo gjë mund të kryhet në rrugë jashtëligjore. "Ne kemi problem politik me shqiptarët e Kosovës. Ne po merremi me njerëz me të cilët nuk mund të dialogosh dhe të cilët mendojnë se çdo gjë është e mundur të arrihet përmes rrugëve jo ligjore", tha Vuçiç. Madje sipas Vuçiç, shqiptarët në Kosovë mendojnë se mund të arrijnë edhe persekutimin e serbëve. "Ata mendojnë që është e mundur t'i persekutojnë serbët dhe të bëjnë gjithçka është e mundur kundër Serbisë", deklaroi Vuçiç.

SHQIPËRIA, SHTETI I KRIMIT

Në raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit Shqipëria shihet si vend burimor i kanabis, tranzit për kokainën dhe heroinën. Korrupsioni zyrtar e pandëshkueshmëria nxisin trafikun e drogës, thuhet në raport

Në raportin e sapopublikuar të Departamentit Amerikan të Shtetit "Strategjia e Luftës Ndërkombëtare kundër Narkotikëve dhe Pastrimit të Parave" 2018, Shqipëria klasifikohet njëherazi "si një vend burim i kanabisit dhe vend tranzit për kokainën dhe heroinën". Sipas raportit trafiku i këtyre 2 drogave të forta komandohet "nga elementë të krimit të organizuar që transportojnë drogën nga vendet ku prodhohet, në Azi dhe Amerikën e Jugut, në tregjet europiane".

Raporti i Departamentit të Shtetit i cilëson "të rëndësishme" rezultatet në Shqipëri, vitit e kaluar, kundër trafikut të narkotikëve. "Vëllimi i konfiskimeve të drogës dhe numri i arrestimeve në vitin 2018 ishin të rëndësishme, të nxitura nga bashkëpunimi i institucioneve të zbatimit të ligjit me partnerët dhe presioni ndërkombëtar në rritje dhe përpjekjet e Shqipërisë për të hyrë në BE". Raporti përmend zbulimin e dy laboratorëve të përpunimit të heroinës dhe kokainës në Shqipëri. Por lë qartë të kuptohet që rezultatet janë me efektivitet të kufizuar. "Korrupsioni në çdo nivel të qeverisë kufizon efektivitetin e përgjithshëm të tyre. Korrupsioni zyrtar është i përhapur dhe nxit një mjedis, ku trafikantët e drogës janë kryesisht në gjendje të veprojnë pa u ndëshkuar", thekson raporti lidhur me Shqipërinë.

Departamenti Amerikan e Shtetit gjen si shkaktarë të shndërrimit të Shqipërisë në „një vend burim të kanabisit dhe vend tranzit për kokainën dhe heroinën" situatën ekonomike dhe zbatueshmërinë e dobët të ligjit. "Niveli i lartë i papunësisë dhe sundimi i dobët i ligjit kanë krijuar një ambient ideal për grupet e krimit të organizuar, që kontrollojnë drogën në Shqipëri. Eksportimi i kanabis dhe tregtia e drogave të paligjshme në tregjet evropiane është një biznes shumë fitimprurës për trafikantët e drogës", thekson raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit. Në të konstatohet një status-quo lidhur me dënimin dhe burgimin e trafikantëve të drogës në Shqipëri. Shpresën për të prishur këtë status quo, Departamenti Amerikan i Shtetit e sheh tek reforma në Drejtësi. "Vazhdimi i Reformës në Drejtësi nga qeveria shqiptare është jetike për zhdukjen e ndikimit të krimit të organizuar. Shqipëria është duke ecur drejt reformës së drejtësisë për të ndjekur penalisht dhe dënuar kriminelët e trafikimit të drogave edhe si pjesëmarrës në krimin e organizuar. Prokurorët tani kombinojnë akuzat që lidhen me drogën me ato që lidhen me krimin e organizuar", përfundon raporti i Departamentit të Shtetit - 2018 analizën për situatën e trafikut të narkotikëve në Shqipëri.

Raporti i Departamentit të Shtetit 2018, konstaton se "burimet e fondeve të paligjshme në Shqipëri vijnë nga trafiku i narkotikëve, kontrabanda dhe marrëdhëniet e paligjshme të biznesit me bandat e krimit të organizuar". "Shqipëria mbetet vulnerabël ndaj pastrimit të parave për shkak të korrupsionit, rritjes së rrjeteve të krimit të organizuar dhe institucioneve të dobëta ligjore dhe qeveritare" thekson raporti. Në analizën e kushteve, në të cilat ndodh pastrimi i parave raporti vë në dukje se "Shqipëria ka një ekonomi të madhe të bazuar në cash dhe sektorin informal, hyrje të konsiderueshme të parave nga jashtë në formën e remitancave". Veprimtaritë kriminale më të mëdha, që gjenerojnë të ardhura në Shqipëri, konstaton Departamenti Amerikan i Shtetit, përfshijnë trafikimin e drogës, evazionin fiskal dhe kontrabandën pa përjashtuar falsifikimin, armët dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

TË MOSHUARIT SERBË DHE ATA QË S'KANË KRYER SHKOLLIM NUK HEQIN DORË NGA KOSOVA

Dy të tretat e qytetarëve të Serbisë janë kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës, të paktën po t'ju jepej mundësia të votonin për këtë çështje në referendum, edhe pse shumica mendojnë se Kosova është e humbur dhe se Serbia nuk është në gjendje të rivendosë sovranitetin mbi këtë territor. Kështu tregon hulumtimi i fundit i realizuar nga Instituti për Çështje Evropiane ne Serbi, i cili u realizua me 1 mijë e 200 anketues në mars të këtij viti, gjetjet e të cilit u raportuan nga Blic.rs.

Anketimi u realizua lidhur me njohjen e Kosovën, a konsiderojnë se e kanë humbur Kosovën, pjesëmarrjen e qytetarëve në dialogun e brendshëm, demarkacionin dhe referendumin për Kosovës. 47 për qind të popullsisë në Serbi vlerësojnë se Kosova është e humbur përderisa 41 për qind kanë mendim të kundërt. 12 për qind nuk kanë dhënë përgjigje. Në mesin e atyre që mendojnë se Kosova është e humbur janë personat te moshës 30-60 vjeçare, me një nivel të ndërmjetëm dhe të lartë të arsimit nga të gjitha rajonet, përveç në lindje dhe në jug të Serbisë.

Pothuajse gjysma mendojnë se nuk është e mundshme që Serbia të ketë përsëri kontroll të plotë dhe sovranitet në Kosovë. Se një gjë e tille është e mundur besojnë rreth 36% e popullsisë, e mesin e te cilëve ka më shumë burra dhe më pak të anketuar që kanë përfunduar shkollën e mesme. Ndërsa më shumë se gjysma e të anketuarve, 54 për qind, besojnë se qeveria e tanishme në Serbi nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës. E po të mbahej referendumi lidhur me Kosovën nesër, 74.5 për qind e të anketuarve thonë se do të votonin kundër njohjes se pavarësisë – në një masë më të madhe, burra, njerëz me të moshuar se 45 vjeç dhe ata me arsim fillor dhe të mesëm. Për njohjen e pavarësisë së Kosovës shifrat tregojnë se janë 6.2 për qind e popullsisë, 11 për qind do të votonin në referendum, ndërsa 8.3 nuk dinë se si të përgjigjen.

Zuzana Çaputova, presidentja e parë grua e Sllovakisë

Avokatja liberale dhe kritike e Qeverisë, Zuzana Çaputova ka mposhtur kundërkandidatin e saj me një diferencë të gjerë, për t'u bërë presidentja e parë grua e Sllovakisë. Me pothuajse të gjitha votat e numëruara, Çaputova ka fituar 58.4 për qind të votave në raundin e balotazhit. Kundërkandidati i saj, Marosh Sefçoviç, një kandidat i pavarur, por që ka gëzuar mbështetjen e partisë në pushtet, Partia Social-Demokrate, ka fituar 41.6 për qind të votave. Sefçoviq, nënkryetar i Komisionit Evropian dhe ish-anëtar i Partisë Komuniste, pranoi humbjen pak para mesnatës më 30 mars. Ai gjithashtu konsiderohet si pro-evropian, por gjatë fushatës kishte thënë se Sllovakia duhet të mbajë për vete disa kompetenca vendimmarrëse. Çaputova kishte fituar raundin e parë të votimeve, që u mbajtën dy javë më parë, duke arritur të marrë 40 për qind të votave. Sefçoviç, në këtë raund kishte fituar mbi 18 për qind të votave.
Korrupsioni dhe ndryshimi kanë qenë temat kryesore para raundit të balotazhit, i cili është mbajtur një vit pasi gazetari, Jan Kucik, i cili kishte hetuar për rastet e mashtrimit të zyrtarëve të lartë - dhe e fejuara e tij, ishin vrarë në shtëpinë e tij. Pesë persona janë akuzuar për vrasjen e Kuciak dhe të fejuarës së tij, Martina Kusnirova. Vrasja e tyre kishte nxitur protestat më të mëdha në historinë post-komuniste të Sllovakisë. Çaputova ka bërë fushatë që t'i jepet fund, asaj që ajo e ka quajtur "kapje të shtetit".

PO MBARON KOHA PËR TË PENGUAR BREXITIN, MAY NUK DORËZOHET

"Po na mbaron koha për të penguar Brexit-in pa marrëveshje", tha ministri i Jashtëm gjerman, Maas duke shtuar se nuk mund t'i shpjegohet askujt mosarritja e një marrëveshjeje për ndarjen e Britanisë në mënyrë të rregullt nga BE

Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas në lidhje me refuzimin e tretë të marrëveshjes Brexit në Parlamentin britanik tha se "po na mbaron koha për të penguar Brexit-in pa marrëveshje". Maas, në një deklaratë me shkrim, ka vënë në dukje se britanikët deri më 12 prill, duhet të vendosin se si do të vazhdohet në çështjen e Brexitit, përndryshe do të realizohet Brexiti pa marrëveshje.

"Po na mbaron koha për të penguar Brexit-in pa marrëveshje", tha Maas duke shtuar se nuk mund t'i shpjegohet askujt mosarritja e një marrëveshjeje për ndarjen e Britanisë së Madhe në mënyrë të rregullt nga Bashkimi Evropian (BE) dy vjet pas marrjes së vendimit për Brexitin. Duke vënë theksin se Gjermania dhe BE-ja janë të gatshme për "çdo situatë", Maas tha se kanë nxjerrë ligje dhe kanë marrë masa për t'u mbrojtur nga rezultatet e padëshiruara të Brexit-it pa marrëveshje. Ndërkohë, teksa opinioni publik në Britaninë e Madhe pret dorëheqjen e Kryeministres Theresa May pas disfatës së tretë për Brexit, shefja e qeverisë as që e çon ndërmend të dorëzohet. BBC raporton se Kryeministrja britanike do të çojë planin e saj të shkëputjes për herë të katërt në parlament, për të tentuar sërish mbështetjen e deputetëve. Përpara se të japë dorëheqjen siç ka premtuar, Theresa May kërkon të përmbyllë marrëveshjen e arritur e Brukselin.

Mijëra mbështetës të Brexit manifestuan të premten në rrugët e Londrës. Eurodeputeti Nigel Farage, një nga promotorët e shkëputjes nga Unioni, paralajmëroi një tjetër fitore nëse referendumi përsëritet. "Nëse na detyrojnë të luftojmë për një tjetër referendum, do t'i mundim me një rezultat më të thellë se hera e fundit. Nuk më vjen në mend një moment në histori, kur ka pasur një tradhti më të madhe ndaj votës së popullit". Parlamenti mblidhet sërish të hënën, ndërsa afati i ri i caktuar nga Brukseli është 12 prilli. Një ndarje e ashpër pa marrëveshje, tashmë është gjithnjë e më e mundshme. Parlamenti britanik në një votim të zhvilluar dje refuzoi për herë të tretë marrëveshjen për Brexit-in të arritur me BE-në. Marrëveshja u refuzua nga 334 ligjvënës, kundrejt 286 votave në favor të saj. Liderët e BE-së në një samit të zhvilluar javën e kaluar në Bruksel vendosën shtyrjen e Brexitit më 12 prill në rast se Britania nuk do të pranonte marrëveshjen e largimit nga Unioni deri më 29 mars.

Dënim me vdekje për ata që tradhtojnë

Ligje të ashpra në Brunei. Nga 3 Prilli, në vendin e vogël islamik do të hyjë në fuqi ligji për vrasjen me gurë apo rrahje me kamxhik për homoseksualët dhe ata që kryejnë tradhti bashkëshortore. Dënimi më vdekje, shumë i kritikuar në këtë rast nga të gjitha organizatat në mbrojtje të të drejtave të njeriut, hyn kështu në Kodin Penal duke u bazuar mbi Sheriatin. Por duke nisur nga java tjetër do të hyjnë në fuqi edhe ashpërsimet e dënimeve të tjera, si prerja e dorës apo këmbës në rastin e vjedhjes. Që nga viti 2014. Brunei po ndjek një formë më konservatore të Islamit duke futur edhe sistemin ligjor islamik. Duke u bazuar në të do të aplikohen ndëshkime trupore më të rënda sipas direktivës së sulltanit. Gjithashtu në mbretërinë e Brunei alkooli është i jashtëligjshëm dhe ekzistojnë gjoba apo dënime për të gjithë ata që kanë fëmijë jashtë martese, apo edhe për ata besimtarë që nuk luten ditën e premte. Ndërsa homoseksualiteti ishte i jashtëligjshëm që në kohën e dominimit kolonial nga Britania e Madhe që zgjati deri në vitin 1984. Megjithatë ligjet e reja që do hyjnë në fuqi mund të aplikohen vetëm mbi myslimanët, që përbëjnë rreth 2/3 e popullsisë.

TERRORISTI I CHRISTCHURCH ANOHET SE PO TRAJTOHET PADREJTËSISHT NË BURG

Vrasësi i akuzuar për sulmin në Christchurch pretendon se ai është duke u trajtuar padrejtësisht pas grilave dhe ka bërë një ankesë formale për të kërkuar qasje ndaj vizitorëve dhe thirrjeve telefonike.

I akuzuari për sulmin në Christchurch, Brenton Tarrant, ka paraqitur një ankesë formale duke pretenduar se po i mohohen të drejtat e tij themelore pas hekurave. 28 vjeçari Tarrant, i lindur në Australi, është burgosur në Burgun e Aucklandit në Paremoremo, pasi ai është akuzuar se ka vrarë 50 besimtarë myslimanë në dy xhami më 15 mars. Tarrant thuhet se ka paraqitur një ankesë në Departamentin e Korrigjimit për të kontestuar situatën e tij në burg ku atij aktualisht nuk i janë të lejuar vizitorët, thirrjet telefonike, qasje në televizion ose në gazeta, raporton Stuff.

Ai është në izolim dhe vëzhgim të vazhdueshëm. Ai nuk merr të drejtën e zakonshme minimale. Pra, nuk ka telefonata dhe vizita, ka thënë një burim nga burgu. Sipas Aktit të Korrigjimeve të Zelandës së Re, të burgosurit ndër të tjera kanë të drejtë të bëjnë thirrje telefonike, të dërgojnë ose të pranojnë postë, trajtimin mjekësor, shtratin, ushqimin dhe pijen, qasjen tek vizitorët, qasjen në informata dhe arsim.

Ligji gjithashtu thotë se një të burgosuri mund t'i mohohen këto të drejta nëse ka një emergjencë në burg, sigurimi i burgut është kërcënuar, ose nëse shëndeti ose siguria e ndonjë personi kërcënohet.

KU JETOJNË DHE PUNOJNË 1 MILION EMIGRANTËT SHQIPTARË NË EUROPË!

Të dhënat e EUROSTAT që prej vitit 2009 tregojnë tre shtetet me flukse më të larta të azilkërkuesve shqiptare janë Gjermania, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar. Flukset më të larta kanë qenë fillimisht drejt Gjermanisë, ku sipas të dhënave akumulative prej 2009 kanë aplikuar rreth 84 mijë shqiptarë, ose 47% e totalit të aplikimeve në dekadën e fundit

Në vitin 2018 numri i shqiptarëve rezidentë në një nga vendet e Bashkimit Europian ishte 990,372 sipas të dhënave të publikuara nga EUROSTAT. Pjesa më e madhe e tyre janë të përqendruar në shtete fqinje, rreth 90%. Numri i emigrantëve shqiptarë në Itali ishte 440 mijë. Të huajt në Itali përbëjnë 5% të totali të popullsisë italiane. Ndër të huajt atje, 12% e zënë ata me shtetësi shqiptare.

Emigrantët shqiptarë kanë një peshë të konsiderueshme edhe në Greqi, por të dhënat nuk janë përditësuar që prej censusit të 2011-s, ku numëroheshin rreth 480 mijë emigrantë shqiptarë atje. Sipas EUROSTAT, për vitin 2018 numri i emigrantëve në Greqi ishte 604 mijë, ku pjesa më e madhe janë shqiptarë. Më pas, me një diferencë të konsiderueshme nga Greqia dhe Italia, renditet emigrantët në Gjermani, apo rreth 49,224 individë. Vende si Franca, Mbretëria e Bashkuar apo Greqia kanë raportuar numrin emigrantëve me shtetësi jo-BE në total. Pjesa tjetër e emigrantëve jetojnë në Belgjikë (6146), Suedi (2889), Austri (2563), Zvicër (1867), Holandë (1084). Ndërsa në vendet e tjera të Bashkimit Europian jetojnë mbi 5000 individë.



SHQIPËRIA RENDITET PAS VENDEVE TË LUFTËS

Shqipëria është shteti i shtatë në rang botëror për numrin e azilkërkuesve, duke u renditur pas shteteve të luftës. Që nga viti 2013, janë rreth 157 mijë shqiptarë që kanë bërë kërkesë për azil, ku numri më i lartë ishte në 2015-tën, me rreth 69 mijë persona. Shqipëria vijon të listohet në top 10 vendet me numrin më të lartë të aplikantëve për azil në Bashkimin Europian, ku sipas të dhënave 4% e azilkërkuesve ishin me origjinë nga Shqipëria. Megjithatë numri i aplikantëve për herë të parë ka ardhur në rënie. Në 2016-n sipas raportit numri i aplikantëve nga Shqipëria ishte 32985, ndërsa në 2017-n numri i aplikantëve shënoi 26060. Shqiptarët u renditën të shtatë pas vendeve ku konfliktet civile vijojnë. Referuar raportit vjetor që prej 2015-s, Siria, Iraku dhe Afganistani janë tre shtetet kryesore të origjinës së aplikantëve për azil. Afërisht 15% e të gjithë azilkërkuesve ishin me origjinë nga Siria, me Irakun të renditur të dytin dhe Afganistanin të tretin, ku secili përfaqësonte rreth 7% të origjinës së azilkërkuesve në BE. Këto vende ndiqeshin nga Nigeria, Pakistani, Eritrea, Shqipëria, Bangladeshi, Guinea dhe Irani. Nisur nga kriteret e forta për pranimin e kërkesës për azil pjesa më e madhe e azilkërkuesve shqiptar heqin dorë nga procedurat e azilit. Franca, Luksemburgu dhe Norvegjia kanë përqindjen më të lartë.

Emigrantët në raport me popullsinë ndër vendet anëtare të Bashkimit Europian variojnë nga 1% në vende si Kroacia, Bullgaria, Hungari, në 7% në vende si Gjermania. Përqindjen më të lartë e ka qytet-shteti i Lihtenshtejnit, ku rreth 16% e popullsisë ka një tjetër nënshtetësi jo EU. Në total, për periudhën 2009-2018, numri i aplikimeve për herë të parë për azil nga shqiptarët 178,515 aplikime, duke u renditur vendi i parë i Europës për nga numri i lartë i azilantëve, sipas shifrave të EUROSTAT, të përpunuara nga Monitor. Rekordi u arrit në 2015-n, kur kishte rreth 69 mijë aplikime, për të zbritur në rreth 33 mijë në 2016-n, dhe 26 mijë në 2017-n (shiko grafikun). Në raport me popullsinë Shqipëria renditet e para në botë për numrin më të lartë të aplikimeve për azil në BE, duke kaluar edhe popujt që ikin nga vendet me konflikte, shkruan 'monitor'.

Të dhënat e EUROSTAT që prej vitit 2009 tregojnë tre shtetet me flukse më të larta të azilkërkuesve shqiptare janë Gjermania, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar. Flukset më të larta kanë qenë fillimisht drejt Gjermanisë, ku sipas të dhënave akumulative prej 2009 kanë aplikuar rreth 84 mijë shqiptarë, ose 47% e totalit të aplikimeve në dekadën e fundit. Numri më i lartë i aplikimeve ishte në 2015-n, me 54.760 kërkesa për azil.

KUKËSI, QYTETI MË I VARFËR NË EUROPË

Rreth 3500 familje kuksiane emigruan drejt vendeve të BE-së në vitin 2015. Sipas të dhënave nga Drejtoria e Shërbimit Social, 6000 individë mes tyre, ishin të papunë. Pas refuzimit të azilit, vetëm 135 familje të regjistruara në Qendrën e Informimit u rikthyen

Kukësi, i pari qytet në botë i nominuar për Nobelin e Paqes. Sot, mban nga Eurostat rekordin si rajoni më i varfër në Shqipëri dhe Europë. Rrugët janë thuajse bosh, ndërsa kafja pihet me orë të gjata. Në treg shitet e blihet pak. Shpesh edhe me lista. Shpresa për të luftuar papunësinë është emigracioni. Ky është lokali më i populluar i qytetit. Rrinë kryesisht të rinjtë.

Ergysi, punon si kamarier. Nuk i ka mbushur të 20tat, por ka provuar 2 herë të largohet nga Shqipëria. Thotë se Kukësi nuk i ofron asnjë mundësi për të ardhmen. "Të rinjtë në Kukës nuk kanë asnjë mundësi për të ardhmen. Më mendjen time dhe të rinjve kuksianë është largimi që këtu, por tani po punoj si kamarier, të kaloj kohën, thotë ai. Rreth 3500 familje kuksiane emigruan drejt vendeve të BE-së në vitin 2015. Sipas të dhënave nga Drejtoria e Shërbimit Social, 6000 individë mes tyre, ishin të papunë. Pas refuzimit të azilit, vetëm 135 familje të regjistruara në Qendrën e Informimit u rikthyen.

"Faktori kryesor ka qenë ekonomia e tyre shumë e ulët dhe papunësia. Nuk ka qenë dëshira e tyre që të rikthehen. Kemi probleme me riintegrimin e tyre", thotë Jonida Halilaj, këshilluese në Qendrën e Informimit. Sipas INSTAT, të ardhurat për frymë në Kukës janë 314 mijë lekë në vit. Megjithatë këtu nuk llogariten të ardhurat e siguruara nga emigrantët. Shumë prej familjeve jetojnë me remitancat, mes tyre edhe nga ato që në zyrat shtetërore janë të regjistruara në skemën e ndihmës ekonomike. Mbi 40% e popullsisë trajtohet me ndihmë ekonomike. Familja Zelaj është njëra prej tyre. Burimi i të ardhurave për 5 anëtarët e saj është ndihma sociale dhe këto bagëti. Në fshatin Shtiqën tokat bujqësore mbillen kryesisht me grurë. 44-vjeçari Ajet Basha thotë se bujqësia nxjerr "bukën e gojës", por nuk e lehtëson jetesën. "Punoj vetëm për të mbajtur familjen. Nuk investoj dot sepse nuk subvencionohemi nga shteti, nuk kemi treg shitje". Numri i punëkërkuesve në Kukës ka rënë, por mosha e tyre është rritur. Tani më shumë kërkesa për t'u punësuar ka nga 50-vjeçarët, të cilët e kanë më të vështirë emigrimin. Ka lindjet më të larta në shkallë vendi, një paradoks me statusin që mban si qyteti më i varfër. Paradoks me këtë status dhe me 40 për qind të familjeve që marrin ndihmë ekonomike, janë edhe ndërtimet e reja për banesa në fshatra e qytet. Gjithçka duket se është ndërtuar mbi remitancat.

Liqeni dhe minierat, mbeten pasuri kombëtare, por asnjë prej tyre nuk shfrytëzohet, pasi ky qytet prej shumë vitesh sheh nga emigracioni. Dhe me kthimin nga emigracioni, pakkush investon për të jetuar këtu. Të dhënat tregojnë se kuksianët janë po ashtu ndër të parët në hartën e lëvizjeve demografike, me destinacion kryeqytetin.

EVOLUCIONI I UDHËHEQËSVE ME DORË TË FORTË

Megjithëse është e vërtetë se bota është më shumë demokratike se kurrë më parë, ka shenja se progresi mund të ndalet. Demokracitë po priren drejt autoritarizmit në një numër të habitshëm vendesh si Hungaria, Polonia dhe madje edhe Shtetet e Bashkuara. Në këtë pikë, ne vetëm mund të spekulojmë, se pse po ndodh kjo tani

Nga Erika FRANK

Edhe pse mediat kanë vënë alarmin për krizën e demokracisë, e vërteta është se regjimet autoritare, po qeverisin një përqindje më të vogël vendesh sot në botë, sesa në çdo kohë që nga epoka e Luftës së Dytë Botërore. Përqindja e regjimeve autoritare në pushtet, arriti kulmin në fund të viteve 1970, pikërisht në kulmin e Luftës së Ftohtë, me rreth 75 për qind të vendeve të botës. Në vitin 2000, nën 50 për qind e vendeve, u qeverisën nga regjimet autoritare. Ndërkohë në vitin 2017, një numër edhe më i vogël, 38 për qind. Pra, pse të gjithë ata që u bien gjithmonë kambanave të alarmit, flasin për autoritarizëmin në rritje? Edhe pse është bërë disi e rrallë që demokracitë të degradojnë plotësisht në autokraci, në fakt kjo ka ndodhur me vetëm 2 prej tyre në vitin 2016 (Turqi dhe Nikaragua), dhe asnjë në 2017, shumë demokraci sot po lëvizin drejt një sistemi autoritar.

Kjo është diçka shqetësuese, pasi historikisht, kur demokracitë degradojnë, ato zakonisht nuk rikthehen shpejt. Edhe më shqetësues, është fakti që shumë prej vendeve që pësojnë degradim të demokracisë, nuk janë sot ato që ne do të prisnim. Një numër i madh hulumtimesh në shkencat politike, kanë treguar se sa më e pasur të jetë demokracia, aq më rezistente duhet të jetë. Megjithatë, të dhënat e kohëve të fundit, tregojnë se demokracitë që po bien sot, janë shumë më të pasura sesa ato në dekadat e mëparshme. Në vitet 1990, pasuria për frymë e një vendi tipik demokratik, që degradonte në autoritarizëm, ishte rreth 1700 dollarë. Kjo shifër, e rregulluar sipas inflacionit, u rrit në rreth 2.300 dollarë në vitet 2000, dhe rreth 3.300 dollarë më 2010-ën. Kjo prirje, bie ndesh me disa besime të vjetra rreth dinamikës së ndryshimeve politike.

Ajo sugjeron se një pasuria më e madhe e një vendi, nuk mund t'i mbrojë më demokracitë ashtu si dikur, gjë që ndoshta është arsyeja e zhvillimeve të viteve të fundit në Hungari, Poloni dhe vende të tjera. Turqia, ofron një shembull shqetësues të asaj që mund të ndodhë me një vend dikur demokratik. Rexhep Taip Erdogan erdhi në pushtet në vitin 2003, përmes zgjedhjeve parlamentare, që sipas të gjitha të dhënave ishin demokratike. Turqia kishte përjetuar në të shkuarën disa ndërhyrje të ushtrisë, në jetën politike të vendit, por pak studiues do ta kishin vënë atë në listën e vendeve kandidate, për të degraduar në një autokraci, në kohën e ngjitjes në pushtet të Erdoganit. Vendi ishte jo vetëm relativisht i pasur, por kishte ndërkohë një klasë të mesme në rritje, dhe një shoqëri civile aktive. Megjithatë, gjatë kohës së tij në pushtet, Erdogan ka ndërmarrë një sërë veprimesh, që e kanë dobësuar demokracinë turke, duke përfshirë goditjen e intelektualëve kritikë ndaj qeverisë, censuruar mediat dhe izoluar kundërshtarët politikë.

Ironikisht, nëse demokracitë që dikur dukeshin të sigurta kanë rënë, regjimet e sotme autoritare janë bërë më "liberale", të paktën në aspektin e fasadës së tyre. Që nga fundi i Luftës së Ftohtë, shumica e regjimeve autoritare të botës, kanë ruajtur parlamentet, kanë pasur parti të shumta politike, dhe zgjedhje disi konkurruese, që janë mbajtur rregullisht. Të dhënat tregojnë se ata janë të mençur që e bëjnë këtë: Regjimet autoritare me institucionet pseudo-demokratike, qëndrojnë pak më gjatë në pushtet se sa pa to. Autokratët e mençur, kanë mësuar, se një pamje në dukje e pluralizmit politik, ofron shumë avantazhe dhe më pak rreziqe, sesa taktikat tradicionale të kontrollit, siç janë shtypja brutale. Regjimet aktuale autoritare, janë bërë "më të zgjuara" edhe në fusha të tjera, përtej institucioneve politike. Synimi i tyre, është të imitojnë virtytet e demokracisë, si llogaridhënia, kontestimi dhe përfaqësimi, duke përdorur metoda që janë sipërfaqësore, dhe që nuk përmbajnë reforma reale.

Shembujt janë të shumtë, duke përfshirë legalizimin e organizatave joqeveritare, por vetëm të atyre që në fshehtësi promovojnë agjendën e qeverisë, dhe duke përdorur vëzhguesit e zgjedhjeve, por vetëm ata që certifikojnë rezultatin e synuar të qeverisë. Shumë nga regjimet e sotme autoritare, paguajnë madje kompani të marrëdhënieve me publikun, për të shitur imazhin pozitiv të qeverisë së tyre, brenda dhe jashtë vendit. Të gjitha këto lëvizje, u mundësojnë qeverive autoritare të pretendojnë se janë demokratike, duke e bërë më të vështira sulmet, se ato në fakt nuk janë të tilla. Singapori, mund të jetë një nga shembujt më përfaqësues. Regjimi i Partisë së Veprimit të Popullit, ka qeverisur që nga viti 1965. Ai mban rregullisht zgjedhje, dhe madje u lejon anëtarëve të opozitës të fitojnë vende në parlament. Edhe pse zgjedhjet në vend duken konkurruese, regjimi thuhet se angazhohet në strategji delikate, për të siguruar mbajtjen me çdo kush të pushtetit.

Për shembull, ai përdorur paditë për shpifje, si një mënyrë për t'u mbyllur gojën kundërshtarëve politikë. Kur këta humbin gjyqin, detyrohen të paguajnë shuma të mëdha financiare, të cilat përfundimisht i çojnë drejt falimentimit. Në fakt, lëvizja drejt një liberalizmi të rremë, më të madh tek regjimet bashkëkohore autoritare, duket se ka rezultuar efektive për të gjithë. Megjithëse ka më pak regjime autoritare në fuqi, sesa në dekadat e kaluara, ato ekzistueset janë jashtëzakonisht të qëndrueshme. Gjatë Luftës së Ftohtë, regjimi tipik autoritar qeveriste mesatarisht rreth 12 vjet. Ky numër u rrit në 19 vjet në vitet 1990, dhe 22 vjet në vitet 2000; dhe është rritur në 27 vjet më 2010-ën. Kanë ikur kohët kur juntat ushtarake merrnin me forcë pushtetin, vetëm për t'u detyruar të largoheshin disa vjet më vonë. Regjimet e sotme autoritare, kanë mësuar se farsa e një sundimi demokratik, ka përfitime të mëdha për mbijetesën e regjimit. Rrugëdalja nga këto tendenca, duhet të nisë nga ajo, kuptimi ynë mbi atë që është "normale" në peizazhin politik, mund të ketë nevojë të përditësohet.

Megjithëse është e vërtetë se bota është më shumë demokratike se kurrë më parë, ka shenja se progresi mund të ndalet. Demokracitë po priren drejt autoritarizmit në një numër të habitshëm vendesh si Hungaria, Polonia dhe madje edhe Shtetet e Bashkuara. Në këtë pikë, ne vetëm mund të spekulojmë, se pse po ndodh kjo tani. Shkaqet e mundshme, përfshijnë zhgënjimin e qytetarëve nga kriza e emigracionit, rritja e pabarazisë dhe ngadalësimi i rritjes së standardeve të jetesës. Pavarësisht kësaj, tradicionalisht e kemi parë botën e zhvilluar, si imune ndaj këtij lloji fenomeni. Ndërkohë, regjimet e sotme autoritare, po e bëjnë më të vështirë cilësimin e tyre si të tilla. Kjo pasi po imitojnë gjithnjë e më shumë tiparet e demokracisë, në mënyrë që të duken si rregjime liberale, por që aktualisht punojnë për të zgjatur jetëgjatësinë e sistemit të tyre autoritar.

E megjithatë, situatë nuk është e pashpresë. Megjithëse regjimet autoritare me institucionet e tyre pseudo-demokratike janë më jetëgjata, kur ato shemben, kanë më shumë gjasa të kalojnë në demokraci, sesa në një tjetër diktaturë. Përvoja e Malajzisë na ofron arsye për të qenë optimistë. Regjimi dominues, ishte në pushtet që nga viti 1957. Ai evoluonte më taktikat e tij, në të gjitha mënyrat e përshkruara më lart, dhe sipas të gjitha të dhënave, ishte një qeveri shumë e zgjuar. Disa ekspertë patën frikë, se nëse regjimi do të humbiste, nuk do të respektonte rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2018. Megjithatë e bëri këtë, dhe tani Malajzia është një vend demokratik për herë të parë në historinë e tij. *(bota.al)*

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
KOMUNA E BOGOVINËS
nr. **11-628/1**
29.03.2019

Në bazë të nenit 21 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (''Gazeta Zyrtare e RM. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016, 163/2016), Kryetari I komunës së Bogovinës lëshon këtë:

KOMUNIKATË

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik në territorin e Komunës së Bogovinës se shpallet:

Thirrje publike për dorëzimin e iniciativave për përpunimin
E Planeve urbanistike

Thirrja publike shpallet në pajtim me nenin 21 të Ligjit për planifikim urbanistik dhe hapësinor ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016, 163/2016), në tremujorin e pare të vitit 2019.

- Gjatë periudhës prej 30 ditësh, të gjithë personat fizik dhe juridik të interesuar duhet të dorëzojnë iniciativat për përpunimin e Planeve urbanistike sipas nenit 7 të ligjit për planifikim urbanistik dhe hapësinor.

- Objekt i iniciativave mund të jetë miratimi i Planit të ri urbanistik ose ndryshimi dhe plotësimi i Planit urbanistik ekzistues ose dokumentacionit urbanistik-planor me propozim konkret nga parashtruesi i iniciativës.

- Thirrja publike do të zgjas nga 01.04.2019 deri 30.04.2019 respektivisht **30 ditë**, duke llogaritur nga publikimi.

- Thirrja publike do të shpallet në faqen e internetit të komunës së Bogovinës www.komunabogovine.gov.mk, sistemin informativ e-urbanizëm dhe nëpërmjet shpalljes në fletoren zyrtare të komunës dhe në dy gazeta ditore.

- Personat fizik dhe juridik të interesuar, iniciativat e tyre t'i dorëzojnë në formë të shkruar nëpërmjet arkivit në Seksionin për urbanizëm, ose në formë elektronike përmes sistemit informative e-urbanizëm në afatin e caktuar.

-**Për të gjitha iniciativat e mbështetura**, parashtruesit do të informohen me shkrim ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm në afat prej 15 ditësh nga kalimi I afatit të parashtrimit të iniciativës.

-**Mjetet e iniciativave te mbështetura** për përpunimin e dokumentacionit të nevojshëm duhet të sigurohen nga parashtruesit e iniciativave-personat fizik ose juridik.

KOMUNA E BOGOVINËS
Kryetar
Albon Xhemaili d.v.

Në bazë të nenit 17, 18 dhe 19 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve nga shkollat fillore të caktuar nga ana e MASH dhe Programit vjetor për punë të shkollës për vitin shkollor 2018/2019 dhe Programit për ekskursione për klasat III, IV, IX, SHFK "Orce Nikollov" f. Injevë – Radovish, publikon:

S H P A L L J E
Për kërkesë për grumbullim të ofertave për organizim të ekskursioneve për vitin 2019, pa hapje publike

Për nxënësit e klasës së III – një ditë,
Që të realizohet ekskursioni nisja do të bëhet në ora 7:00 prej vendit të caktuar, ku do të nisen drejt Shkupit dhe rrugës do të vizitohet aeroporti Aleksadri i Madh. Pas arritjes në Shkup do të vizitohet lokaliteti Skupi dhe akuedukti romak, pas asaj nxënësit do të vizitojnë Kalanë e Shkupit dhe varrin e Goce Dellçevit, vizitë të shkurtë të Çarshisë së Vjetër të Shkupit dhe me mundësi për drekë në pjesën qendrore të qytetit. Gjatë orëve të pasdites nxënësit do të vizitojnë Kopshtin Zoologjik dhe Luna Parkun dhe se do të nisen drejt kanjonit Matka. Në orët e pasdites pas përfundimit të hulumtimit dhe mësimit të objekteve të parapara nxënësit do të përgatiten për tu kthyer në shtëpi dhe nxënësit do të dërgohen në vendet e tyre të banimit.

Për nxënësit e klasës së VI – dy ditë (1 bujte),
Dita e parë:
Nisja nga vendet e caktuara në orët e mëngjesit rreth orës 7.00 dhe arritje në Manastir, vizitë të Herakleas dhe Shirok Sokak. Nisje për në Resnjë në vizitë të manastirit në Kurbinovë dhe parkut nacional Pelister. Drekë në Resnjë. Nisje për në Krushevë dhe vizitë të shtëpisë përkujtimore të Toshe Proeski dhe vizitë të Makedoniumit. Në orët e mbrëmjes arritje në hotel dhe darkë.

Dita e dytë: Pas ngrënies së mëngjesit, nisja nga Krusheva në drejtim të Gostivarit dhe vizitë të burimit Vrutok. Prej Vrutokut nisje drejt Tetovës për vizitë në manastirin e Leshokut. Nisje drejt Shkupit dhe vizitë të muzeut të Luftës maqedonase. Prej Shkupit nisje drejt Radovishit dhe arritje në orët e mbrëmjes dhe nxënësit do të dërgohen në vendet e tyre të banimit.

Për nxënësit e klasës së IX – tre ditë (2 bujtje),
Dita e parë:
Nisja nga vendet e caktuara në orët e mëngjesit rreth orës 7:00. Me ndalje gjatë rrugës, pushim, shikim nisemi në rrethinën e qytetit të Shkupit: kanjoni Matka, Manastiri "Uspenie na Presvetena Bogorodica" – Matkë, në Shkup vizitë të kompleksit muzeor të luftës maqedonase me drekë pjesën qendrore të Shkupit.
Pastaj nisemi drejt qytetit të Tetovës, vizitojmë Xhaminë e larme, në afërsi të drejtpërdrejtë të Dibrës manastirin Sv. Jovan Bigorski, HEC Shpile dhe kanjonin e Lumit Radika, pas njohjes së të gjitha këtyre bukurive nisemi për bujtje në hotel në Ohër dhe darkë.

Dita e dytë: Ditën e ardhshme, në mëngjes pas ngrënies, nisemi për vizitë të Fortesës së Samoilit, Sv. Pantelemon në Pllaoshnik, Qytetin e vjetër, Teatrin antik, Sv. Jovan Bogosllov – Kaneo, kthim në hotel për drekë, pas drekës nisemi për vizitë në Burimet e Vevçanit, vizitë të muzeut natyror të në Strugë, urën e Lumit Drin ku mbahen Mbrëmjet strugane të poezisë, shëtitje nëpër çarshi dhe në orët e pasdites kthehemi në hotel ku do të organizohet mbrëmje solemne me shoqërim të përbashkët.

Dita e tretë: Ditën e tretë në mëngjes pas ushqimit vazhdohet në vizitë të Shën Naum Ohridski në Ohër dhe prej aty nisemi për në Prilep për vizitë të kishës "Sv. Arhangel Mihail" – Varosh,e me drekë në pjesën qendrore të Prilepit. Pastaj nisemi në drejtim të Kavadarit për vizitë të Stobit dhe Feni, në orët e pasdites nisemi prapë për në Radovish, ku fëmijët do të dërgohen në vendet e banimit.

Ekskursionet e nxënësve duhet të realizohen në periudhë fundi i muajit maj fillimi i muajit qershor 2019.

Kriteri për dhënie të Marrëveshjes për realizim të ekskursioneve është çmimi më i ulët.

Ofertuesit duhet të plotësojnë kushtet minimale në vijim:
- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive të R. Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike;
- Të ketë të realizuar së paku tre ekskursione për nxënës në tre vitet e fundit;
- Të plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike për makinat me të cilat transportohen grupet e fëmijëve;

Ofertat me shkrim (veç e veç për secilin ekskursion) duhet të punohen dhe të dorëzohen në pajtim me kërkesat e theksuara në shpallje, dhe në të njëjtat duhet të shënohet: çmimi individual për nxënës, kushtet për akomodim (emri i hotelit), menyja e ushqimit dhe transporti, sigurim të veçantë për nxënësit, mënyra e pagesës, të dhënat për guidën dhe mjekun, kushte të volitshme për nxënësit që vijnë nga familjet e prekura sociale si dhe dokumente për përmbushjen e kushteve minimale të theksuara më lartë, dhe të njëjtat nuk duhet të përmbajnë zgjidhje alternative, (dokumentet parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuara nga ofertuesi me mbishkrim "të besueshme me origjinalin").
Oferta e ofertuesit që nuk përmbushë kushtet minimale do të refuzohet nga ana e Komisionit si e papranueshme.
Oferta e cila përmban elemente ose shërbime shtesë nuk do të ketë përparësi gjatë vlerësimit të së njëjtës.
Çmimet në ofertat duhet të jenë fikse, gjegjësisht nuk lejohet korrigjim i çmimeve gjatë realizimit ë marrëveshjes.
Për realizim kualitativ të marrëveshjes, ofertuesi i zgjedhur duhet të dorëzojë garanci bankare në shumë prej 5% të vlerës së shërbimit, gjatë lidhjes së marrëveshjes.
Ofertat së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen më së voni 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes, në adresën: SHFK "Orce Nikollov" f. Injevë – Radovish, me shenjë "për shpallje për organizim të ekskursioneve për vitin 2019".
Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.

Komisioni për organizimin e ekskursioneve pranë
SHFK "Orce Nikollov" f. Injevë

REPUBLIKA E MAQEDONISË
Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij" - Shkup
Fakulteti i shkencave informatike dhe inxhinierisë kompjuterike

Në bazë të nenit 176 të Ligjit për arsim të lartë (Gz.Zyrtare e R.Maqedonisë nr.82/18), Dekani i Fakultetit të shkencave informatike dhe inxhinierisë kompjuterike në Shkup, publikon:

K O N K U R S
për zgjedhje në tituj

1. zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha tituj mësimor shkencor në të gjitha fushat mësimore shkencore të sferës mësimore-shkencore informatikë dhe sferës mësimore-shkencore teknika kompjuterike dhe informatika
2. zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha tituj mësimor shkencor në të gjitha fushat mësimore shkencore të sferës mësimore-shkencore informatikë dhe sferës mësimore-shkencore teknika kompjuterike dhe informatika
3. zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha tituj mësimor shkencor në të gjitha fushat mësimore shkencore të sferës mësimore-shkencore informatikë dhe sferës mësimore-shkencore teknika kompjuterike dhe informatika

Kushtet: Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me nenin 166 të Ligjit për arsim të lartë (Gz.Zyrtare e R.Maqedonisë nr.82/18) dhe kushteve të veçantë të cilët janë në fuqi si dhe kushtet e paparë në Rregulloren për kushtet e veçantë dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimor-shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe demonstratorëve të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup (Lajmëtari universitar nr.411 të datës 5.11.2018)
Orari i punës do të përcaktohet sipas orarit të orëve.
Rroga për të gjitha pozitat lëviz në kufijtë prej 31.000,00 deri 55.000,00 denarë.
Ndaj fletëparaqitjes kandidatët duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje sipas konkursit në të cilën do të qëndrojë për cilën pozitë paraqiten, dokument për arsim përkatës të mbaruar (diplomat e huaja të nostrifikohen dhe të bashkëngjiten me ekuivalencën e notave), biografi të shkurtë, certifikatë të shtetësisë, listë të punimeve shkencore dhe profesionale të botuara (nga një kopje të punimeve);
Zgjedhja do të realizohet në afatin e paparë sipas ligjit.
Dokumentet të parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter - fletëparaqitjet të cilat nuk janë të plota nuk do të shqyrtohen.
Fletëparaqitjet parashtrohen më së voni 8 ditë nga publikimi i konkursit në Dekanatin e Fakultetit të shkencave informatike dhe inxhinierisë kompjuterike, rr.Rugjer Boshkoviq 16, Shkup.

Fakulteti për shkenca informatike dhe
inxhinieri kompjuterike

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 18 të Rregullores për mënyrën për realizimin e ekskursioneve për nxënës dhe aktiviteteve tjera të lira për nxënësit e shkollës fillore dhe programeve për realizim të ekskursioneve, SHFK "Kirili dhe Metodij" f. Oraovicë, komuna e Radovishit publikon

S H P A L L J E

Me grumbullimin e ofertave për organizim të ekskursioneve për nxënës për vitin shkollor 2018/2019 edhe atë:

- Për nxënësit e klasës së **III-të** ekskursion njëditor në relacionin **Oraovicë - Shkup - Oraovicë**
- Për nxënësit e klasës së **VI-të** ekskursion dyditor në relacionin **Oraovicë - Radovish - Kavadar** (Stobi) - **Prilep** (vizitë të Qytetit të epërm dhe kullave të Markos) - **Manastir** (Heraklea, parku nacional "Pelister") akomodim në hotel në Manastir fjetje, dita e dytë nisje për Gostivar (vizitë të Vrutokut) - Tetovë (vizitë të Xhamisë së larme) - Shkup (vizitë të Shtëpisë përkujtimore të Nënës Terezë dhe Çarshia e vjetër) - kthim përmes Velesit - Shtip - Radovish.
- Për nxënësit e klasës **IX-të** (klasa e fundit) ekskursion treditor në relacionin - **Oraovicë - Radovish - Tetovë** (shëtitje të shkurtë në qendër dhe vizitë të Xhamisë së larme dhe Kalasë së Tetovës, vizitë të Vrutokut, vizitë dhe shëtitje në manastirin "Shën Jovan Bigorski" dhe "Shën Gjorgi" - Rajçicë dhe bajat Kosovraste) - vizitë dhe shëtitje në **Vevçani** - akomodim në **Ohër me dy fjetje - Strugë** (vizitë të "Shën Naum Ohridski", shëtitje dhe vizitë të Crn Drim "ura e poezisë" dhe muzeu natyror-shkencor, shëtitje nëpër qytetin e vjetër - Teatri antik, Plaoshnik, Samoilova tvrdina dhe kisha "Shën Sofija" Shën Jovan Bogoslov - Kaneo - **Manastir** (vizitë dhe shëtitje) - **Prilep** (shëtitje të shkurtë në qendrën e qytetit) - **Radovish - Oraovicë.**

Ekskursionet organizohen dhe realizohen në pajtim me nenin 14 të Rregullores për mënyrën për realizim të ekskursioneve për nxënës.
Kriteret për ndarje të marrëveshjes për realizim të ekskursioneve është çmimi më i ulët.
Shkolla për ofertuesin më të volitshëm do të zgjedhë ofertuesin i cili plotëson edhe kushtet minimale në vijim:
- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive të RM për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike dhe me transport të licencuar personal.
- Të ketë të realizuar së paku tre ekskursione për nxënës në tre vitet e fundit.
- Të plotësojë kushtet për transport të grupeve të nxënësve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesa të posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor.
Ofertat me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen deri tek komisioni për grumbullimin e ofertave me shenjë "mos hap".

Tel. për kontakt
032 641 005

SHFK "Kirili dhe Metodij" f. Oraovicë
Komisioni për grumbullimin e ofertave
Kryetar

Ajri i ndotur lidhet me paranojën ekstreme

Eksperiencat psikotike - siç janë dëgjimi i zërave apo paranoja ekstreme - janë më të zakonshme tek adoleshentët që jetojnë në qytete me ndotje të lartë krahasuar me zonat rurale, sugjeron një studim i realizuar në Angli dhe Uells. Shkencëtarët thonë se hulumtimet e tyre mund të japin të dhëna të mundshme që tregojnë se përse fëmijët në zonat urbane kanë më shumë gjasa të kenë çrregullime psikotike më vonë. Studimi është publikuar në revistën JAMA Psychiatry. Shkencëtarët nga King's College në Londër analizuan rreth 2000 adoleshentë që jetonin në zonat urbane, gjysmë-urbane dhe rurale. Pothuajse një e treta (623) raportuan se kishin kaluar të paktën një përvojë psikotike ndërmjet moshës 12 dhe 18 vjeç - për shembull duke u ndjerë sikur njerëzit po i përgjonin apo kishin përjetuar halucinacione. Në zonat me nivelet më të larta të gazeve ndotëse (për shembull zonat e brendshme të qytetit pranë rrugëve të zëna), ka pasur 12 adoleshentë që kanë raportuar përvojat psikotike, ndërsa në zonat me nivele më të ulëta të gazrave të oksidit të azotit, ka pasur vetëm shtatë persona që kanë raportuar këto eksperienca. Shkencëtarët thonë se gjetjet janë të qëndrueshme edhe kur janë përfshirë faktorët tjerë që mund të kontribuojnë në episode psikotike, duke përfshirë historitë familjare, ambientin social, alkoolin dhe drogat. Autorja Joanne Newbury, tha se përderisa studimi nuk mund të tregonte se ajri i ndotur ka shkaktuar eksperiancat psikotike, "gjetjet tona sugjerojnë se ndotja e ajrit mund të jetë një faktor kontribues në lidhjen midis jetës së qytetit dhe përvojave psikotike".

A DONI VËRTETË TA MPOSHTNI VARËSINË NGA SHEQERI?

Probleme të ndryshme lindin për shkak të konsumit të tepërt: rritja e kolesterolit, rreziku i prodhimit të gurëve të veshkave, dhimbje koke migrenë, alergji e rritur, probleme të tretjes, por edhe ankth, depresion dhe vështirësi në përqendrim

I barabartë me drogat, sheqeri krijon më shumë varësi sesa mund të krijojë kokaina. Sheqeri është aleati ynë në lidhje me funksionet esenciale vitale të trupit, por marrja e tij me shumicë, mund të krijojë probleme të shumta. Ngrënia e ëmbëlsirave është e kënaqshme dhe truri ndjen kënaqësi, padyshim. Për këtë arsye ai kërkon sërish, por sasia e kërkuar gjithnjë rritet. Probleme të ndryshme lindin për shkak të konsumit të tepërt: rritja e kolesterolit, rreziku i prodhimit të gurëve të veshkave, dhimbje koke migrenë, alergji e rritur, probleme të tretjes, por edhe ankth, depresion dhe vështirësi në përqendrim.

SHËNONI ATË QË HANI. Hapi i parë është mbajtja e një ditari ushqimor për të paktën një javë, në mënyrë që të kuptohet sasia e sheqerit të marrë në të vërtetë. Jo vetëm kaq, ne gjithashtu do të kuptojmë se sa sheqer mund të shmangim së shtuari, gjatë një dite.

MË MIRË NËSE USHQIMI ËSHTË INTEGRAL. Konsumimi i më shumë ushqimeve integrale ndihmon në mbajtjen konstante të nivelit të sheqerit në gjak, gjatë tërë ditës. Nga ana tjetër, konsumi i dobët i këtyre ushqimeve çon në rënie të papritura të glukozës gjatë ditës. Trupi do të kërkojë automatikisht diçka të ëmbël për të kompensuar uljen e sheqerit në gjak, duke na çuar kështu të konsumojmë ushqimin e ëmbël të paradites.

PINI SHUMË UJË. Shpesh, dëshira për ëmbëlsira dhe ushqime me sheqer rrjedh nga dehidratimi, prandaj është e rëndësishme që gjithmonë të hidratoheni mirë. Pini disa gota ujë para se të hani një copë çokollatë. Përveç kësaj, është mirë që të pini një gotë me ujë sapo të zgjoheni në mëngjes, për të kompensuar dehidratimin gjatë natës.

SNACKS PO, POR TË SHËNDETSHME. Kur ju keni nevojë për gjëra të ëmbla, hani një frut ose një fetë bukë. Kjo do të kompensojë dëshirat tuaja, duke mashtruar trurin tuaj në marrjen e asaj që keni kërkuar. Në fakt, ju keni ngrënë diçka me vlerë shumë më të lartë ushqyese, e cila me siguri do t'ju bëjë të ndiheni më mirë dhe do të balancojë sheqernat në afat të gjatë, ndryshe nga ajo që do të ndodhë me biskotat.

PROVONI USHQIME TË FERMENTUARA TË TILLA SI KOS DHE KEFIR, POR EDHE LAKËR TURSHI. Në fakt, ushqimet e këtij lloji, sidomos nëse janë pak acidike, ndihmojnë për të luftuar ndjenjën e urisë. Përveç kësaj, një rregull tjetër i mirë është që të marrin ushqime probiotike ose shtesa të këtij lloji për të ribalancuar florën bakteriale. Kjo do t'ju ndihmojë jo vetëm me dëshirat e sheqerit, por edhe me rregullsinë tuaj të zorrëve.

Marijuana tek adoleshentët nxit depresionin në moshë madhore

Konsumimi i marijuanës tek adoleshent mund të ketë efekte serioze në shëndetin mendor në moshë madhore, sipas një studimi të ri kanadez, i cili ka vërejtur një rritje prej 40% të rreziqeve të depresionit tek të rriturit në mesin e adoleshentëve që kanë përdorur kanabis. Rreziqet e depresionit të rëndë me ide vetëvrasëse, në moshë të rritur, rezultoi gjithashtu 50% më i lartë në mesin e atyre që kishin përdorur marijuanën në adoleshencë, transmeton ATSH raportimin e ANSA-s. "Rreth 7% e rasteve të depresionit në popullatën e rritur, lidhet me përdorimin e kanabisit në adoleshencë", thotë Gabriella Gobbi, psikiatre dhe profesoreshë. Analiza e re bazohet në shqyrtimin e 11 studimeve, që pasuan një total prej 23 317 adoleshentësh deri në moshën madhore. Në përgjithësi, vlerësimet e reja tregojnë se përdorimi i marijuanës para moshës 18 vjeç lidhet me një rritje të probabilitetit të depresionit prej 1,4 herë më të lartë se ata që kurrë nuk kanë pirë kanabis si edhe një rritje të ideve vetëvrasëse prej 1,5 herë më të lartë.

Shenjat që tregojnë se mëlçinë e keni të mbushur me toksina

Mëlçia është organi qendror i metabolizmit dhe gjëndra më e madhe e trupit tonë që lidhet me aparatin tretës. Ajo prodhon substanca për të përthithur vitaminë K, ndihmon në përthithjen e vitaminës A nga beta-karoten; prodhon enzima për të tretur ushqimin, funksionon si detoksikues për të larguar lëndë toksike që janë marrë nga ushqimi apo janë prodhuar në aparatin tretës. Këto dhe shumë funksione të tjera që janë jetësore për të jetuar, por kur mëlçia është e infekatuar me parazitë dhe toksina ajo shfaq 6 shenjat e mëposhtme:

ALERGJI: Një mëlçi që funksionon si duhet lëshon antitrupa që shkatërrojnë alergjenet. Ndërsa kur është e mbushur me toksina, trupi tenton të ruajë alergjenët e mbetur dhe truri më pas dalëngadalë fillon prodhimin e histaminës që provokon simptomat e alergjive si kruarje, dhimbje koke etj.

NDRYSHIM I NGJYRËS SË URINËS DHE FEÇEVE: Ndryshimet e ngjyrës dhe aromës së urinës jo gjithmonë janë të lidhura me infeksionet e traktit urinar, ato mund të tregojnë gjithashtu probleme të keqfunksionimit të mëlçisë. Urina e një njeriu të shëndetshëm është në ngjyrë të verdhë të zbehtë, kurse nëse vuani nga verdhëza ajo ka ngjyrë të errët.

SHTIM NË PESHË NË MËNYRË TË MENJËHERSHME: Kur mëlçia nuk filtron toksinat siç duhet, të gjitha yndyrat që qarkullojnë kthehen mbrapsht në trupin tuaj.

DHIMBJE STOMAKU: Edhe pse inflamacioni i stomakut mund të ndodhë për arsye nga më të ndryshmet shëndetësore, jo rrallëherë mund të shkaktohet nga çrregullimet e funksionimit të mëlçisë.

LODHJE KRONIKE: Herë pas herë toksinat mund të shkaktojnë dhimbje të muskujve dhe lodhje, të cilat rrjedhimisht mund të shkaktojnë ndryshime në humor dhe depresion.

ERË KEQE NGA GOJA: Jeni nga ata njerëz që i kushtoni rëndësi higjienës orale, por prapëseprapë vini re se goja juaj mban erë të keq, atëherë duhet të dini se ky problem mund të shkaktohet nga mos funksionimi siç duhet i mëlçisë. Si rrjedhojë, një dietë e mirë është çelësi kyç për trajtimin e këtij problemi.

"VOLVO" ME STRATEGJI PËR PARA

Sipas të dhënave të Administratës për Siguri në trafik në SHBA, vetëm në këtë vend 30 persona vdesin çdo ditë për shkak të aksidenteve si pasojë e dehjes së shoferëve. Vetëm në vitin 2017, në SHBA vdiqën 10.874 njerëz si pasojë e aksidenteve për shkak të dehjes

Gjiganti suedez, "Volvo", shpreson ta rikthejë reputacionin e vet për sigurinë përmes një strategjie teknologjike. Me teknologjinë më të re kompania po planifikon të parandalojë aksidentet nëpër rrugë. Kompania ka njoftuar në fund të muajit mars se do të instalojë kamera dhe senzorë brenda automobilave të vet në fillim të 2020-s, që do të funksionojnë sikur pajisje monitoruese për nivelin e dehjes apo shpërqendrimit të shoferit, por edhe për të intervenuar në parandalimin e aksidenteve.

Masat e sigurisë, të prezantuara në një konferencë nga "Volvo", kanë nxjerrë në pah planet e publikuara kohë më parë me synim të eliminimit të aksidenteve fatale nëpër rrugë. Zhvillimi i teknologjisë që mund të përkrahë manovra të tilla është përshpejtuar në vitin e fundit, sidomos me rritjen e fokusit kah automobilat autonomë në industri. Kompania ka thënë se sistemi funksionon në atë mënyrë që vazhdimisht monitoron shoferin dhe kur të ketë nevojë do të hyjë në funksion edhe pjesa e intervenimit. Sistemi i intervenimit do të hyjë në funksion nëse shihet qartë përmes kamerave dhe senzorëve se shoferi është i dehur apo është i shpërqendruar, dhe nuk po u përgjigjet sinjaleve paralajmëruese si dhe po rrezikon të shkaktojë aksident me përmasa që mund të jenë fatale.

"Volvo" lidhur me këtë është duke krijuar një autopilot për vozitje pa shofer nëpër autostrada me kompaninë prodhuese të pjesëve të automobilave, "Veoneer", po ashtu nga Suedia. Kjo po bëhet me synimin që të përmbushet caku i caktuar më herët e që automobilat autonomë të zënë një të tretën e shitjeve të të gjithë automobilave të kompanisë deri më 2025. Por drejtori gjeneral i kompanisë, Hakan Samuelsson, ka thënë për "Reuters" se duhen pesë deri në dhjetë vjet para se automobilat e tillë të përhapen në masë. Sipas tij, duhet krijuar një treg të qëndrueshëm për të shitur automobila me veçori shtesë për sigurinë, siç janë monitorimi përmes kamerave përgjatë vozitjes. "Këto teknologji aktive të sigurisë do të vijnë nga viti 2021... senzorë të mençur, kufizues të mençur të shpejtësisë, senzorë të mençur të monitorimit të humbjes së koncentrimit, senzorë të mençur për dehje. Këto do të vijnë", ka thënë ai.

Shefi i departamentit për hulumtime dhe zhvillime në këtë kompani, Henrik Green, ka thënë se kamerat do të instalohen në të gjitha modelet e "Volvos" që do të krijohen në platformën "SPA2" për automobila më të mëdhenj, duke nisur nga modeli "XC90 SUV", në fillim të dekadës së ardhshme, para se t'u shtohet edhe automobilave të vegjël të krijuar në platformën "CMA". "Volvo" ka thënë se intervenimi për të parë nëse shoferi i automobilit është i dehur, i lodhur apo i shpërqendruar duke shikuar në telefon mobil - një nga faktorët më të mëdhenj të aksidenteve - mund të përfshijë kufizimin e shpejtësisë së automobilit, të alarmojë shërbimin asistues të "Volvos", ose të ngadalësojë dhe të parkojë automobilin. "Kur bëhet fjalë për sigurinë, qëllimi ynë është të shmangim aksidentet në vend që të kufizojmë ndikimin nëse një aksident është i pashmangshëm", ka deklaruar Green, që është edhe zëvendëspresident i kompanisë. "Në këtë rast, kamerat do të monitorojnë për sjelljet që mund të çojnë në lëndime serioze apo edhe vdekje".

Sistemi, sipas "Volvos", do të jetë në gjendje të dallojë shumë sjellje potencialisht të rrezikshme. Këtu përfshihet edhe rasti kur shoferi "shfaq mungesë përqendrimi për mbajtje të timonit për një periudhë të gjatë", apo kur sytë e tij mbyllen për periudha të konsiderueshme gjatë vozitjes. Teknologjia do të monitorojë po ashtu edhe "kohën e ngadalshme të reagimit" dhe "lëvizjet ekstreme nëpër shiritat rrugorë". Sipas të dhënave të Administratës për Siguri në trafik në SHBA, vetëm në këtë vend 30 persona vdesin çdo ditë për shkak të aksidenteve si pasojë e dehjes së shoferëve. Vetëm në vitin 2017, në SHBA vdiqën 10.874 njerëz si pasojë e aksidenteve për shkak të dehjes.

Më shumë punë për kontrollin e internetit

Themeluesi i Facebook, Mark Zuckerberg ka pranuar se mediet sociale duhet të përmirësojnë akoma më shumë punën për kontrollin e postimeve nga ana e përdoruesve. Reagimi i Zuckerberg lidhet edhe me transmetimin online në Facebook të sulmit terrorist që ndodhi në dy xhami në Zelandë të Re, pamje të cilat morën miliona shikime para se të fshiheshin nga rrjeti social. Themeluesi i Facebook thotë se qeveritë e shteteve të ndryshme duhet të luajnë një rol më aktiv për kontrollin e internetit dhe përmbajtjes së saj. Në një artikull të Zuckerberg të botuar në "Washington Post", ai

thotë se e gjithë barra nuk duhet të bjerë mbi mediat sociale, por të kontribuojnë disa rregullatorë për të kontrolluar materialet që qarkullojnë në internet. Zuckerberg shtoi se nëse qeveritë dhe rregullatorët luajnë një rol më aktiv për të kontrolluar internetin, "atëherë ne mund të sigurojmë më mirë lirinë e njerëzve për t'u shprehur dhe për sipërmarrësit që të krijojnë gjëra të reja, duke mbrojtur gjithashtu shoqërinë nga gjërat e dëmshme". Sipas tij, katër fushat ku ka nevojë për mbikëqyrje më të rreptë janë "artikujt me përmbajtje të dëmshme", "integriteti i zgjedhjeve", "privatësia" dhe "ruajtja e transferimit të të dhënave". Megjithatë, Zuckerberg pranoi se edhe pse Facebook ka vendosur rregulla të forta, gjithmonë do të ketë gabime dhe vendime për të cilat njerëzit nuk do të jenë dakord.

Dështon Apple, heq dorë nga produkti i shumëpërfolur

Apple ka hequr nga një produkt që ishte parashikuar për të karikuar pajisjet elektronike, si iPhone, iPad vetëm duke i lidhur me wireless, pa nevojën për të qenë të lidhur me kabuj.

Produkti i quajtur AirPower i prezantuar në vitin 2017 nuk do të dalë në shitje, sepse Apple njoftoi se nuk mund ta bënte këtë pajisje të funksiononte në mënyrën e duhur. Inxhinerët besohet se e kanë pasur të pamundur për të bërë këtë pajisje që të mos tejnxehej nga përdorimi, shkruan BBC. "Pas shumë përpjekjesh, kemi dalë në përfundimin se AirPower nuk do të përmbushë standardet tona të larta dhe për këtë arsye kemi anuluar projektin", njoftoi Apple. Kompania nuk ka dhënë arsye të tjera.

Ky produkt ishte paralajmëruar se do të dilte në treg në 2018-ën, por në fund të vitit nisën thashethemet për këtë produkt, ku aludohej pikërisht se inxhinierët nuk po arrinin të mbanin nën kontroll rritjen e temperaturës së baterisë kur kjo pajisje përdorej së tepërmi. Rivalët e Apple, Samsung dhe Huawei, kanë nxjerrë tashmë produkte që mundëson karikimin e pajisjeve të tyre me wireless.

Një lavatriçe që punon në gjithësi

Astronautët nuk do të kenë nevojë më që të mbajnë pa fund qeset me rrobat e pista, pasi kompania ruse "RKK Energia", që ideon dhe prodhon anijet hapësinore "Soyouz" që shkojnë në ISS (Stacioni Ndërkombëtar Hapësinor), njoftoi sot se ka prodhuar një lavatriçe që punon në hapësirë. "Për ekspeditat e ardhshme hënore dhe lëvizje të tjera ndërplanetare, RKK Energia ka filluar zhvillimin e një lavatriëe hapësinore", thekson kompania në një video të publikuar në YouTube, pa dhënë më shumë detaje. Me rezerva të pakta uji, astronautët e Stacionit Hapësinor Ndërkombëtar (ISS) nuk mund të lajnë rrobat e tyre dhe janë të detyruar t'i veshin disa herë gjatë misionit të tyre, që shpesh zgjasin disa muaj. Në përgjithësi, ata i mbajnë tre ose katër ditë para se t'i hedhin me mbeturinat e tjera. mbeturinat nuk lëshohen në hapësirë, por largohen nga ISS-ja drejt Tokës me ardhjen e astronautëve të tjerë. Ato më pas shpërbëhen kur hyjnë në atmosferë, sipas NASA-s.

DASHI 21. mars - 20. prill

Do kaloni momente te veçanta me partnerin tuaj sot dhe ne mbrëmje do rikthehet serish pasioni i dikurshëm. Ne disa momente nuk do ju besohet qe jeni ne realitet. Beqaret do kalojnë vërtet momente te këndshme me miqtë dhe nuk do e mbajnë mendjen tek krijimi i një lidhjeje. Ne planin financiar nuk duhet te bëni gatime te cilat mund t'iu rrënojnë.

DEMI 21. prill - 21. maj

Do jeni me tepër kërkues nga sa duhet sot ju te dashuruarit dhe do mërziteni pak kur partneri te mos ua plotësojë te gjitha dëshirat. Beqaret nuk do jene te qarte për statusin qe dëshirojnë te kenë momentalisht dhe do mbyllen ne vetvete. Ne planin financiar duhet t'i bëni me shume kujdes llogarite sepse gabimi me i vogël mund t'iu kushtoje shume shtrenjte.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Duhet te jeni me tolerante me partnerin gjate kësaj dite sepse vetëm ne këtë mënyrë do mund ta përmirësoni marrëdhënien mes jush. Beqaret do jene shume te zënë me pune dhe nuk do e kenë aspak mendjen për te kërkuar dashurinë. Ne planin financiar do jete Jupiteri ai qe do ju ndihmoje t'i zgjidhni problemet dhe do jeni me te qete kur te shpenzoni.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Nëse jeni ne një lidhje nuk duhet kurrsesi te shihni persona te tjerë sot sepse partneri mund te behet xheloz dhe do lindin debate te forta. Beqaret nuk do kenë fat ne dashuri dhe do vazhdojnë te bëjnë jetën e mëparshme. Për fat te mire miqtë dhe te afërmit nuk do i lënë vetëm. Ne planin financiar mos ndërmerrni rreziqe te mëdha sepse mund te gaboni dhe do keni probleme.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Dite e favorshme ka për te qene kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do ndiheni me se miri me partnerin tuaj dhe mund te bëni edhe plane afatgjata për te ardhmen. Beqaret do kenë një dite intensive dhe te mbushur me takime te njëpasnjëshme. Do kenë mundësi zgjedhjeje, por duhet te jene te vëmendshëm. Buxheti do jete i paqëndrueshëm, kështu qe kujdes me shpenzimet.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Sot do ju ndryshoje shume shpesh humori juve qe jeni ne një lidhje dhe ne disa momente mund te keni edhe debate te vogla ne çift. Beqaret duhet ta lënë veten sa me te lire dhe te bëjnë atë qe do ndiejnë. Mos mendoni aspak për paragjykimet e te tjerëve. Gjendja e financave do përmirësohet ne mënyrë te menjëhershme pas një projekti te madh te përfunduar me sukses.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Dite goxha e mire do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do afroheni me tepër me partnerin dhe do ja kaloni për mrekulli se bashku. Beqaret duhet te jene me realiste dhe nuk duhet te kërkojnë gjera te ekzagjeruara. Vetëm ne këtë mënyrë do e ndryshojnë lidhjen. Gjendja e financave do jete goxha e vështirë. Duhet te merrni masa sa me shpejt.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Dielli dhe Jupiteri do bëhen bashke gjate kësaj dite dhe do ju sjellin vetëm emocione pozitive ju te dashuruarve. Shfrytëzojeni çdo çast deri ne maksimum. Beqaret nuk duhet te mendojnë me te keqen, por duhet ta lënë veten te lire dhe kane për te gjetur princin e kaltër. Ne planin financiar do ju dalin disa probleme te vogla. por qe do zgjidhen shpejt.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Edhe pse rutina do mbizotërojë gjate gjithë kësaj dite për ju te dashuruarit, serish do arrini te ruani ekuilibrin dhe nuk do mërziteni. Beqaret do iu përkushtohen me tepër miqve dhe do e lënë disi pas dore jetën sentimentale. Ne fakt edhe mundësitë për takime nuk do jene te mëdha. Për sa iu përket çështjeve financiare, kjo do jete një nga ditët me te mira te vitit. Shfrytëzojeni!

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Dite shume e trazuar do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do debatoni edhe për gjerat me elementare me partnerin tuaj. Beqaret do ndihen te harruar nga yjet dhe do vuajnë ne vetmi. Ne fakt shume me shpejt nga sa ata mendojnë do ndodhe diçka fantastike. Ne planin financiar nuk do ketë asnjë lloj tronditjeje dhe do i kryeni pa frike te gjitha shpenzimet.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Marrëdhënia juaj ne çift do përforcohet dhe thellohet akoma me shume gjate kësaj dite. Do bëni çdo gjë për njeri-tjetrin dhe kënaqësitë do jene te pafundme. Beqaret duhet ta lënë veten te lire dhe kane për ta gjetur personin i cili do ju përshtatet ne çdo pike. Ne planin financiar duhet te dëgjoni arsyen dhe jo te bëni ato qe mendoni për momentin. Vetëm kështu nuk do keni probleme.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do jeni me te përkëdhelurit e yjeve gjate kësaj dite dhe nuk do ju duket aspak sikur jeni ne realitet. Pasioni do mbizotërojë ne çdo moment. Beqaret pa u lodhur shume do mund ta gjejnë personin për te cilin do ju rrahe zemra fort dhe kënaqësitë do jene te mëdha. Ne planin financiar mundohuni te jeni te arsyeshëm me shpenzimet dhe gjendja nuk ka për te qene e keqe



Mensur Mamuti	AUTORI YNË NË FOTO	VEPËR E AUTORIT NË FOTO	DAKIKA	QYTET NË ALABAMA TË SHBA-VE	SHAHISTI HOLANDEZ, JAN
QELQ (SH.)					
RAJON NË GREQI					
MOSKRYERJE E PUNËS NË KOHË / METAFORA					
B					
BËN HETIMIN E DIÇKAJE / MELIHATE AJETI					

KOHA	PELA ME KRIFË TË BARDHË, JELEBARDHA	KONCERT MUZIKOR I NJË ARTISTI TË VETËM	PJESË E OXHAKUT, ANËCAK	MATJA E DREJTËSISË NË DITËN E GJYKIMIT (ISLAM) / AKT. AM. GREGORI
S				
FILOZOFI FRËNG, DEKART / LLOJ ZOGU, CINXAMI				
M				
SHUAJ				TAILANDEZ / GRUAJA E BABAIT
Ë. T.			KANJOHURI PËR DIKE / KOZMOLOGJA MERSINI-HOUGHTON	
KËRCIMTAR NË BALET				
ATA QË ALARMOJNË				
REOMIR		QYTET NË JAPONI / UNITET NATIONS		
PESHQESH				
MALLKIMI KISHTAR				

SELVETE GIMOLLI								
PRISHTINË / LLOJ MIZASH QË JETOJNË NË DRUNJ								
PYLL / KËNGËTARI ITALIAN, FILIPPO NEVIANI								
MBIEMRI I VJETËR I MUHAMED ALIUT, KASIUS / AMERICIUM								
POETJA E FAMSHME JAPONEZE, LEJDI / INTENSITET								

***Përpara tymit harroj zjarrin
përpara puthjes harroj dashurinë
përpara lules harroj aromën
përpara hingëllimës harroj kalin
përpara emrit harroj njeriun
më vini përpara orën të harroj kohën***

METËR	NJË NGA 12 KONSTELACIONET E ZODIAKUT	POEZIA E AUTORIT NË FOTO (SHIHI VARGJET)
RUTENIUM / AKTORI AMERIKAN, SAMERVILL		
		KOHA

ZGJIDHJET: XHAMAT, EPIRI, VONIM, BATUTA, HETON, MIZANI, SKRAPARI, RENE, SG, MICAK, PR, FIK, TAI, ËT, NJEH, MAL, BALERIN, RU, ALARMUESIT, R, UKI, KLEJ, DHURATA, ISE, ANATEMIMI.

Sudoku

shumë i lehtë

	9			8				
5	4		6	1			9	
2	8	1					5	
	7		8		4			
9								8
			9		5		4	
	5					1	8	3
	2		1	3			6	5
				5			7	

shumë i vështirë

3								4
	6		2	8	7			
9				3			8	6
	1				8	5		
		7	9				4	
7	3			1				5
			8	9	5		3	
2								1

Shumë i lehtë: 697583214, 543612897, 281749356, 175824639, 964371528, 832965741, 456297183, 729138465, 318456972. **Shumë i vështirë:** 382659174, 461287953, 975134286, 613748529, 894523617, 527961348, 739412865, 146895732, 258376491.

16-VJEÇARJA MBLEDH MIJËRA NË BERLIN

Është bërë e zakonshme në disa kryeqytete europiane që të premteve të protestohet për ndryshimet klimatike, gjithçka falë një nxënëseje 16-vjeçare suedeze. Greta Tunberg konsiderohet si e para nxënëse që ka bërë një grevë për ndryshimet klimatike. Ditën e nisjes së klasës së 9, vitin e kaluar më 20 Gusht, ajo nisi një grevë që e vazhdoi deri më 9 Shtator, ditën e zgjedhjeve të përgjithshme në Suedi. Motiv ishin një seri zjarresh të rëna në pyjet suedeze vitin e kaluar, që u përhapën për shkak të ndryshimeve klimatike. Vajza vuan nga sindroma Asperger, një formë e lehtë autizmi. Megjithatë ajo është thirrur gjatë kësaj kohe në Kombet e Bashkuara dhe disa në konferenca ndërkombëtare për klimën.

Ky është politikani më i gjatë në botë

Një këshilltar nga Brooklyn i New York-ut, me emrin Robert Cornegy Jr., u emërua si politikani më i gjatë në botë me gjatësi 208 centimetra. Ai u nderua me këtë çmim këtë javë gjatë një ceremonie të bashkisë, pasi u certifikua zyrtarisht nga Libri i Rekordeve Botërore Guinness më 14 janar.

Cornegy deklaroi se ai aplikoi për këtë titull para dy vjetësh kur një mik i tha me shaka "ti me gjasë je politikanë më i gjatë i të gjitha kohërave". Ai shprehet se të qenit i gjatë i ka sfidat e saj, sidomos kur bëhet fjalë për të blerë këpucë dhe rroba.

Mbajtësi i mëparshëm i këtij titulli ishte një anëtar i parlamentit britanik me emrin Sir Louis Gluckstein, i cili ishte 202 centimetra. Ai vdiq më 1979 dhe u pasua nga një tjetër politikan britanik i cili e kishte gjatësinë prej 198 centimetra.

Gjyshja 55-vjeçare sjell në jetë mbesën e saj

Një nënë i ka ardhur në ndihmë vajzës së saj në pjesën më të vështirë të jetës, atë të bërjes së një fëmije. Tabloidi i njohur britanik, "Daily Mail", raporton se Emma Miles, 55-vjeçare u ofrua që të ishte nënë zëvendësuese (surrogate) për të bijën, e cila i kishte humbur shpresat që të kishte fëmijë të saj, për shkak se kishte lindur pa mitër. Duke qenë se Tracey Smith, 31-vjeç kishte vezore të shëndetshme, embrioni u ngjiz me anë të fekondimit invitro dhe më pas u implantua në mitrën e gjyshes [nënën së saj]. Për të mbajtur fëmijën, 55-vjeçares iu desh të rrëzonte 38 kilogramë si dhe të merrte rregullisht hormone. Pas nëntë muajsh në jetë erdhi Evie Siân Emma Smith, një vajzë që peshonte 3.3 kg.

GRUAJA QË NUK NDJEN ASNJË DHIMBJE

Jo Cameron e kupton se lëkura e saj po digjet vetëm kur e sheh mishin e djegur. Ajo shpesh vendos duart e saj në furrë, por nuk ndjen asnjë dhimbje për ta paralajmëruar atë. Kjo për shkak se ajo është një nga vetëm dy njerëz në botë që njihen të kenë një mutacion të rrallë gjenetik. Kjo nënkupton se ajo nuk ndjen pothuajse asnjë dhimbje, dhe kurrë nuk ndjehet e frikësuar apo e shqetësuar. Këtë gjë ajo e kuptoi në moshën 65 vjeçare, kur mjekët panë se nuk kishte nevojë për medikamente qetësuese pas një operacioni serioz. Cameron kreu ndërhyrje kirurgjike në dorë dhe mjekët e paralajmëruan se do të përballej me dhimbje më pas. Kur ajo nuk ndjeu asgjë, anestezisti i saj, Dr.Devjit Srivastava, e dërgoi atë tek gjenetika e dhimbjeve në University College London (UCL) dhe Oxford University. Pas testeve, ata gjetën mutacione të gjeneve që nënkuptonin se ajo nuk ndjen dhimbje si shumica e njerëzve.

KALENDARI HISTORIK 1 PRILL

527 - Justiniani I emërohet perandor i Perandorisë së Bizantit.

1867 - Ekspozitë ndërkombëtare hapet në Paris.

1867 - Singapori, Penangu dhe Malaka shpallen koloni të Britanisë.

1868 - Hapet Instituti i Hamptonit.

1881 - Trazira kundër hebraike në Jerusalem.

1948 - Ishujt Faroe fitojnë pavarësinë nga Danimarka.

1954 - Formohet Akademia e Forcave ajrore amerikane.

1971 - Britania e Madhe mënjanon të gjitha ndalesat për pronësi të arit.

1974 - Ajatolla Homeini Thërret në themelimin e Republikës Islamike të Iranit.

1977 - Dështon tentimi për themelimin e shtetit islamik në Çad.

1991 - Zyrtarisht shpërbëhet Pakti i Varshavës.

2001 - Martesa mes gjinive të njëjta bëhet legale në Holandë, shteti i parë që lejon një gjë të tillë.

2009 - Kroacia dhe Shqipëria i bashkohen NATO-s.

A E DINI SE...

NJË LAVATRIÇE QË PUNON NË GJITHËSI

Austronautët nuk do të kenë nevojë më që të mbajnë pa fund qeset me rrobat e pista, pasi kompania ruse "RKK Energia", që ideon dhe prodhon anijet hapësinore "Soyouz" që shkojnë në ISS (Stacioni Ndërkombëtar Hapësinor), njoftoi se ka prodhuar një lavatriçe që punon në hapësirë. "Për ekspeditat e ardhshme hënore dhe lëvizje të tjera ndërplanetare, RKK Energia ka filluar zhvillimin e një lavatrice hapësinore", thekson kompania në një video të publikuar në YouTube, pa dhënë më shumë detaje. Me rezerva të pakta uji, austronautët e Stacionit Hapësinor Ndërkombëtar (ISS) nuk mund të lajnë rrobat e tyre dhe janë të detyruar t'i veshin disa herë gjatë misionit të tyre, që shpesh zgjasin disa muaj. Në përgjithësi, ata i mbajnë tre ose katër ditë para se t'i hedhin me mbeturinat e tjera. mbeturinat nuk lëshohen në hapësirë, por largohen nga ISS-ja drejt Tokës me ardhjen e austronautëve të tjerë. Ato më pas shpërbëhen kur hyjnë në atmosferë, sipas NASA-s.

THËNIA E DITËS

Nëse qëndron neutral në një situatë, ti ke vendosur të jesh në anën e shtypësit. **(Desmond Tutu)**